

20040200356

L I G J I PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

KAPITULLI I

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen llojet, kategoritë, identifikimi, mënyra e vënies në mbrojtje dhe instrumentet e tjera të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, regjimi i mbrojtjes dhe shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore, të drejtat dhe obligimet e poseduesve dhe kufizimi i të drejtës së pronësisë të trashëgimisë kulturore me interes publik, organizimi, koordinimi dhe mbikëqyrja, titujt profesional dhe çështje të tjera që janë me rëndësi për unitetin dhe funksionimin e sistemit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Republikën e Maqedonisë.

Trashëgimia kulturore

Neni 2

Trashëgimi kulturore sipas këtij ligji janë të mirat materiale dhe jomateriale të cilat, si shprehje apo dëshmi të krijimtarisë njerëzore në të kaluarën dhe tani apo si vepra të përbashkëta të njeriut dhe natyrës, për shkak të cilësive, përmbajtjeve apo funksioneve të tyre arkeologjike, etnologjike, historike, artistike, arkitektonike, urbanistike, ambientale, teknike, sociologjike dhe vlerave të tjera shkencore dhe kulturore kanë rëndësi kulturore dhe historike, dhe për shkak të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre gjenden nën regjim juridik, sipas këtij ligji apo ligjit tjetër.

Ndarjet themelore të trashëgimisë kulturore

Neni 3

(1) Trashëgimia kulturore sipas nenit 2 të këtij ligji, sipas veçorive të saj, mund të jetë e patundshme, e tundshme dhe shpirtërore.

(2) Trashëgimia kulturore sipas nenit 2 të këtij ligji, sipas rëndësisë së saj, mund të jetë: me rëndësi të veçantë dhe rëndësi tjetër kulturore dhe historike. (në tekstin e mëtejshëm: trashëgimi e rëndësishme kulturore).

(3) Trashëgimia kulturore sipas nenit 2 të këtij ligji, sipas shkallës së rrezikimit të saj, mund të jetë e rrezikuar dhe e parrezikuar (në tekstin e mëtejshëm: trashëgimi kulturore në rrezik).

Qëllimet e mbrojtjes

Neni 4

(1) Qëllimi kryesor i mbrojtjes është:

1. Ruajtja e trashëgimisë kulturore në gjendje burimore;
2. Krijimi i kushteve më të volitshme për ekzistencën e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen e integritetit të të gjitha të dhënave, që ajo i përmban në vete, si dëshmi, burim apo dokument të llojit të vet;
3. Përhapja e njohurive për vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe rolin e saj në identifikimin kulturor;

4. Aftësimi i trashëgimisë kulturore,që sipas rëndësisë dhe dedikimit, të shërbejë për përmbushjen e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, fetare, ekonomike, turistike dhe nevojave të tjera, të qytetarëve dhe shoqërisë.

(2) Qëllimi operativ i mbrojtjes është ndërmarrja e aktiviteteve për pengimin e veprimeve, dukurive dhe ndikimeve, me të cilat bëhet ose mund të ndodhë dëmtimi, shkatërrimi, shpërbërja, zhdukja, degradimi dhe përvetësimi i kundërligjshëm i trashëgimisë kulturore.

(3) Qëllimi i fundit i mbrojtjes është bartja e trashëgimisë kulturore te gjeneratat e ardhshme.

Bazat e mbrojtjes

Neni 5

(1) Trashëgimia kulturore është vlerë themelore e Republikës së Maqedonisë, që mbrohet në çfarëdo rrethanash.

(2) Mbrojtja e trashëgimisë kulturore është me interes publik dhe realizohet në mënyrë të obligueshme në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Trashëgimia kulturore mbrohet sipas vlerave, rëndësisë dhe shkallës së rrezikshmërisë së saj, pa marrë parasysh kohën, vendin dhe mënyrën e krijimit,ose kush e ka krijuar,dhe në pronësinë, apo sundimin e të cilit gjendet,si dhe pa marrë parasysh a është me karakter fetar apo të shenjtë dhe cilit konfesion i takon, apo a është e regjistruar.

(4) Me evidentimin, shpalljen ose me mënyrën tjetër të vënies në mbrojtje, regjistrimin dhe shënimin e trashëgimisë kulturore, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk mund të ndryshohet lloji i pronësisë,e as pronari i saj.

(5) Të mirat, për të cilat me të drejtë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore, mbrohen me vëllimin dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(6) Trashëgimia kulturore e patundshme dhe të mirat e patundshme nga paragrafi 5 i këtij neni mbrohen bashkërisht me ambientin e tyre të drejtëpërdrejtë, me përcaktimin e zonave kontaktuese, sipas këtij ligji.

(7) Trashëgimia kulturore e tundshme mbrohet si e mirë e veçantë, apo si përmbledhje.

(8) Trashëgimia kulturore shfrytëzohet sipas natyrës dhe destinimit të saj, në pajtim me qëllimet e mbrojtjes. Trashëgimia kulturore e patundshme shfrytëzohet për jetën aktive në të dhe si faktor i zhvillimit të qëndrueshëm.

Realizimi i mbrojtjes

Neni 6

(1) Mbrojtja e trashëgimisë kulturore realizohet sidomos me:

1. Kryerjen e veprimtarive nga lëmi i kulturës, që në tërësi ose pjesërisht kanë të bëjnë me mbrojtjen e një lloji të caktuar të trashëgimisë kulturore (në tekstin e mëtejme: veprimtari për mbrojtje);

2. Kryerjen e punëve administrative, profesionale dhe punëve të tjera të mbrojtjes, që janë me rëndësi për realizimin e funksioneve të shtetit dhe të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe personave juridik lidhur me trashëgiminë kulturore;

3. Organizimin e rrjetit të shërbimeve të specializuara dhe trupave të përhershëm këshilldhënës dhe koordinues për mbrojtje, si në nivelin nacional, ashtu edhe në atë lokal;

4. Përcaktimin e strategjisë nacionale për mbrojtje dhe zbatimin efikas të saj;

5. Zhvillimin e vetëdijes, për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe rreziqeve në të cilat është ekspozuar dhe nevojën për mbrojtjen e saj (vetëdije protektorike);

6. Ndërtimin dhe përparimin e sistemit informativ kompatibil për trashëgiminë kulturore dhe lidhshmërinë e tij me sistemet dhe rrjetat e specializuara dhe të përgjithshme, në rrafsh nacional dhe ndërkombëtar;

7. Ndhimën ndërkombëtare, bashkëpunimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nacionale, dhe

8. Stimulimin e organizatave joqeveritare dhe iniciativave private për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore;

(2) Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të patundshme realizohet edhe me përfshirjen e detyrueshme në planet urbanistike dhe hapësinore dhe në planet dhe programet për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, si dhe me trajtimin e saj si faktor i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, veçanërisht në drejtim të zhvillimit të turizmit kulturor, banimit, zejeve të veçanta dhe edukimit.

(3) Mbrojtja e trashëgimisë së tundshme kulturore realizohet edhe me administrimin efikas me rreziqet, të cilëve ajo u është ekspozuar, sidomos sa i përket gërmimeve ilegale, fshehjes, vjedhjeve, përvetësimeve dhe veprimeve të tjera të kundërligjshme, si dhe sa u përket kushteve të ruajtjes, manipulimit, transportimit, eksponimit e tjerë.

(4) Mbrojtja e trashëgimisë kulturore shpirtërore realizohet edhe me përpunimin dhe ruajtjen e shkrimeve për të, si dhe me nxitjen dhe bartjen e saj në mjediset burimore dhe të tjera.

Subjektet e mbrojtjes

Neni 7

(1) Realizimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në radhë të parë është detyrë dhe përgjegjësi e shtetit, si dhe organeve dhe shërbimeve publike të tij.

(2) Njësitë e vetadministrimit lokal dhe organet e shërbimet publike të tyre, janë përgjegjëse për realizimin e mbrojtjes në kuadër të kompetencave të tyre, të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(3) Personat fizik dhe juridik, të caktuar për kryerjen e punëve të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, sipas këtij ligji, janë përgjegjës për realizimin e mbrojtjes në kuadër të autorizimeve të besuara.

(4) Pronarët dhe poseduesit tjerë të trashëgimisë kulturore janë përgjegjës për mirëmbajtjen, ruajtjen, respektimin dhe shfrytëzimin e drejtë të trashëgimisë kulturore dhe kanë të drejta dhe obligime të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(5) Kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe respektimin e saj është detyrë e çdo qytetari.

Punët administrative, veprimtaritë dhe punët e mbrojtjes

Neni 8

(1) *Punët administrative dhe punët e caktuara profesionale të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore i kryejnë Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si organ në përbërje të Ministrisë së Kulturës (në tekstin e mëtejme: Drejtoria)*

(2) Mbrojtjen e lëndës arkivore e bën Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Arkivi).

(3) Punët profesionale në sistemin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në lëmin e kulturës, me përjashtim të punëve nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, realizohen me kryerjen e veprimtarisë për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore (në tekstin e mëtejme: veprimtaria monumentale) dhe veprimtaritë për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore (muzeumore, bibliotekare dhe kinotekiste).

(4) Veprimtaritë e mbrojtjes nga paragrafi 3 i këtij neni, sipas llojit të trashëgimisë kulturore i kryejnë institucionet publike për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (në tekstin e mëtejme: institucionet publike të mbrojtjes), institucione të tjera dhe persona të tjerë juridik, sipas këtij dhe ligjit tjetër.

(5) Punët për mbrojtjen e të mirave fonotekiste dhe trashëgimisë kulturore shpirtërore i kryejnë subjektet, të autorizuar nga ministri i Kulturës.

Zbatimi i rregullave të tjera nga lëmi i kulturës

Neni 9

(1) Në themelimin, punën dhe shuarjen e institucioneve publike për mbrojtjen, udhëheqjen, administrimin, vendosjen, financimin dhe mbikëqyrjen administrative, zbatohen dispozitat e Ligjit për kulturë, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

(2) Me ligj, më për së afërti rregullohet kryerja e veprimtarisë muzeumore, bibliotekare dhe kinotekiste, duke i përfshirë edhe punët në lëmin e punës muzeumore dhe bibliotekare, që nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

E drejta mbi pronësinë e trashëgimisë kulturore

Neni 10

(1) Lëndë e së drejtës në pronësi mund të jetë trashëgimia kulturore, e tundshme dhe e patundshme.

(2) Trashëgimia kulturore nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jetë në pronësi të Republikës së Maqedonisë (pronë shtetërore), të njërive të vetadministrimit lokal dhe të personave të tjerë fizikë dhe juridikë.

(3) Trashëgimia dhe e mira kulturore, për të cilën me të drejtë supozohet se paraqet trashëgimi kulturore që do të gjendet në tokë ose në ujë, pa dallim nëse është nxjerrur apo jo, konsiderohet se është në pronësi shtetërore. Në raste tjera, sa i përket të drejtës së pronësisë, zbatohen rregullat për fitimin e pronësisë për sendet e gjetura.

(4) Trashëgimi kulturore në pronësi shtetërore konsiderohet edhe:

1. Trashëgimia kulturore e tundshme, pronari i së cilës pa mëdyshje do të shpreh vullnet se nuk dëshiron ta mbajë më tutje, respektivisht e braktisë;

2. Trashëgimia kulturore e patundshme, për të cilën e drejta në pronësi do të fshihet në bazë të deklaratës për tërheqje nga pronësia, e dhënë nga pronari në formë të dokumentit, të përshtatshëm për regjistrimin e të drejtës në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive, me ç'rast, e drejta në pronësi të Republikës, do të regjistrohet në bazë të deklaratës së atillë, pas fshirjes së bërë të së drejtës të pronarit të deriathershëm;

3. Trashëgimia kulturore, pronari i së cilës nuk është i njohur, në afat prej dhjetë vitesh, nëse bëhet fjalë për të mirën e patundshme, respektivisht në afat prej tre vitesh, nëse bëhet fjalë për të mirën e tundshme, llogaritur nga dita e marrjes së Vendimit, për caktimin e tutorit të së mirës së atillë.

Kuptimi i disa shprehjeve në këtë ligj (lista e nocioneve)

Neni 11

Disa shprehje që përdoren në këtë ligj, kanë kuptimin si vijon:

1. “Mbrojtja e trashëgimisë kulturore”, sipas këtij ligji është kërkimi, identifikimi, valorizimi, rivalorizimi, kategorizimi, shpallja, regjistrimi dhe shënimi i trashëgimisë kulturore, ruajtja e saj, respektimi, kultivimi dhe mirëmbajtja, konservimi, restaurimi, rikonstruimi, dislokimi dhe rivitalizimi, si dhe preventiva, mbikëqyrja, ristituimi, prezentimi, popullarizimi dhe çdo formë tjetër e ruajtjes direkte ose indirekte e trashëgimisë kulturore, që realizohet me interes publik (në tekstin e mëtejshëm: mbrojtja).

2. “Rëndësi kulturore dhe historike”, është rëndësi e përgjithshme kulturore dhe rëndësi tjetër, nga pikëvështrimi i historisë së përgjithshme ose nacionale, kulturës, artit, shkencës ose teknikës.

3. “Nacional”, përkatësisht “nacionale”, është nocion që përdoret sipas Ligjit të kulturës dhe konventave ndërkombëtare, të rëndësishme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe e shpreh interesin publik, përkatësisht shtetëror në kulturë;

4. “Valorizim” është vlerësim profesional dhe shkencor i vlerave dhe cilësive të të mirave, sipas kritereve të përcaktuara, në funksion të vënies së tyre në mbrojtje dhe vënies në regjimin përkatës të mbrojtjes.

5. “Rivalorizimi” është vlerësim profesional dhe shkencor i vlerave dhe cilësive të trashëgimisë kulturore, në funksion të konfirmimit, zgjerimit, përforcimit ose zvogëlimit të veprimit të mbrojtjes, duke përfshirë edhe përjashtimin ose shuarjen e tij.

6. “Kategorizimi” është përcaktimi i shkallës së rëndësisë të trashëgimisë kulturore, me interes publik, në funksion të rregullimit të regjimit përkatës të mbrojtjes, përcaktimit të prioriteteve të mbrojtjes, përkufizimit të kompetencave dhe zbatimit të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

7. “Mirëmbajtja” është mbajtje e trashëgimisë kulturore në gjendje të tërësisë optimale dhe funksionale, me marrjen me kohë të masave dhe veprimeve operative, që përsëriten në mënyrë programore.

8. “Ruajtja” është mbikëqyrje sistematike e gjendjes të të mirave të mbrojtura, strehimit të tyre, vendosjes, depoimit, ambalazhimit dhe formë tjetër e përkujdesjes, manipulimit të drejtë, sigurimit fizik dhe teknik nga qasje e paftuar ose përdorim i paautorizuar dhe veprime të dëmshme të çfarëdo forme dhe sigurimi nga rreziqet, në të cilat ato janë ose do të mund t’u ekspozohen.

9. “Respektimi” është përmbajtje nga veprimet, të drejtuara kundër të mirave të mbrojtura, duke përfshirë përdorimin e tyre, për qëllime që do të mund t’i ekspozojnë në rrezik nga dëmtimi dhe shkatërrimi, si dhe kujdesje gjatë zgjedhjes dhe aplikimit të mjeteve dhe metodave të mbrojtjes;

10. “Konservimi” është procedurë dhe metodë e ruajtjes të së mirës së mbrojtur në gjendje burimore, respektivisht në gjendje në të cilën është gjetur, pa shtimin e elementeve që janë shkatërruar, ose që mungojnë.

11. “Restaurimi” është procedurë dhe metodë e përtëritjes autentike të së mirës së mbrojtur, pjesërisht të shkatërruar, me shtimin e pjesëve që mungojnë, në formën dhe pamjen që i kanë patur, ose me mënjanimin e pjesëve dhe komponenteve jopërkatëse.

12. “Rikonstruimi” është procedurë dhe metodë për përtëritjen e të mirës së mbrojtur, që në masë më të madhe është shkatërruar, ose pjesët konstruktive ose të tjera të së cilës janë amortizuar.

13. “Rivitalizimi” është procedurë dhe metodë e kthimit të jetës në monumentet dhe ndërtimet e vjetra në kuadër të tërësive monumentale, ose me mbajtjen ose kthimin në funksionin fillestar ose ndonjë funksioni të mëparshëm, ose me dhënien e funksionit të ri i cili bashkëvepron me natyrën dhe rëndësinë e tyre dhe me karakterin e mjedisit ku gjenden.

14. “Mbrojtja integruese” është tërësia e masave për ruajtjen dhe përfshirjen aktive të trashëgimisë kulturore të patundshme në jetën e bashkësisë si faktor të zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror, veçanërisht në lëmin e planifikimit dhe rregullimit të hapësirës, ndërtimit investues, mbrojtjes së ambientit jetësor dhe natyrës e tjerë.

15. “Restituimi” është kthimi i të mirave të tundshme me rëndësi kulturore dhe historike në vendin e origjinës, respektivisht në vendin, të cilit i takojnë ose nga territori i të cilit janë sjellur me dhunë.

16. “Rikuirimi” është marrje me dhunë e të mirave të tundshme me rëndësi kulturore dhe historike, gjatë kohës së konfliktit të armatosur dhe okupimit, për nevojat e ushtrisë.

17. “Antikuiteti” (“vjetërsira”) është lëndë me vlerë artistike, historike, shkencore, kulturore ose vlerë tjetër të ngjashme, së paku njëqind vjet e vjetër ose më pak, nëse është ose bëhet e rrallë, pasi më nuk prodhohet, formohet ose krijohet.

18. “Përmbledhje” (koleksion) është shuma e sendeve të njëllota ose të shumëllota, të cilat, pa dallim nga karakteristikat individuale dhe destinimit të pavarur të të çdo sendi, veç e veç, për shkak të cilësive specifike të lidhshmërisë, si tërësi ka vlerë të njohur kulturore, historike, artistike, shkencore ose vlerë tjetër të ngjashme, funksion ose rëndësi, dhe mund të identifikohet si objekt i pavarur i mbrojtjes.

19. “Koleksionari” është personi i cili në bazë joprofesionale dhe për nevoja personale merret me grumbullimin e lëndëve me rëndësi kulturore, historike, artistike, shkencore ose të ngjashme, duke formuar një apo më tepër tërësi të kuptimshme prej tyre, me status të përmbledhjes.

20. “Posedues” është pronari, bartësi i të drejtës së shfrytëzimit dhe çdo person tjetër fizik dhe juridik, i cili mbi çfarëdo baze juridike, e posedon të mirën e mbrojtur.

21. “E drejta e shfrytëzimit” është e drejtë reale, e nxjerrur nga e drejta në pronësi e Republikës së Maqedonisë, respektivisht njësisë së vetadministrimit lokal, mbi të mirën e mbrojtur, e cila i jepet në posedim personit fizik ose juridik, me atë që bartësi i saj fiton të drejtën e posedimit dhe shfrytëzimit të kësaj të mire, për ta mbrojtur si trashëgimi kulturore, respektivisht për shkak të mbrojtjes juridike nga ndërhyrja e personave të tretë.

22. “Rikognoscimi” është konfirmim i saktësisë së njohurive për trashëgiminë arkeologjike, në bazë të vëzhgimit paraprak të një vendi të caktuar.

23. “E mira e mbrojtur” është e mirë për të cilën bëhet mbrojtja në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

24. “Rajoni i mbrojtur” është rajoni në kuadër të kufijve të përcaktuar të të mirës së mbrojtur dhe zona e tij kontaktuese.

25. “Zona kontaktuese” është hapësira rreth patundshmërisë që ka rëndësi për ruajtjen e kontekstit të saj historik, me regjim të mbrojtjes, i ndryshëm nga regjimi i mbrojtjes së patundshmërisë, që është lëndë e mbrojtjes.

26. “Akti për mbrojtje” është Vendim për mbrojtje të përkohshme, Vendim për shpalljen e trashëgimisë së rëndësishme kulturore, Vendim për shpalljen e trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë, dhe Vendim për përcaktimin e zonës së rezervuar arkeologjike.

KAPITULLI II

LLOJET DHE KATEGORITË E TRASHËGIMISË KULTURORE

Seksioni 1

LLOJET E TRASHËGIMISË KULTURORE

1.1. Trashëgimia e patundshme kulturore

Monumentet

Neni 12

(1) Monumentet janë ndërtime të veçanta, respektivisht vepra të arkitekturës dhe të ndërtimtarisë ose pjesë dhe relikte të tyre, duke përfshirë edhe elemente dhe struktura të karakterit arkeologjik, skulpturor, artistik ose vepra të artit aplikativ dhe kulturës teknike, të lidhura përherë me një ambient të caktuar, mbishkrime, vendbanime shpellash, përmendore varrezash, objekte memoriale dhe shënime lidhur me ngjarje të rëndësishme dhe personalitete të njohura, të mira të tjera të veçanta të patundshme me rëndësi kulturore dhe historike, së bashku me instalimet, elementet dekorative dhe sende të tjera të tundshme, që janë përherë të lidhura me vetë objektin ose përherë shërbejnë për shfrytëzimin e tij.

(2) Monumente konsiderohen edhe ndërtesat, destinimi kryesor dhe efektiv i të cilave është ruajtja ose ekspozimi i trashëgimisë kulturore të tundshme, si dhe strehimoret e veçanta, të caktuara për vendosjen e trashëgimisë kulturore të tundshme, në rastin e konfliktit të armatosur.

Tërësitë monumentale

Neni 13

(1) Tërësitë monumentale janë vendbanime urbane, rurale e të tjera, ose pjesë të tyre dhe relikte, duke përfshirë pajisjen e vendbanimeve, komplekset bujqësore, industriale dhe komplekse të tjera ekonomike dhe grupe objektësh të lidhura ose të izoluar, të cilat me unitetin ose përputhshmërinë e tyre në peizazh, përbëjnë një tërësi të caktuar topografike.

(2) Tërësi monumentale konsiderohen edhe qendrat, në të cilat gjenden numër i rëndësishëm monumentesh dhe trashëgimi kulturore e tundshme, të përcaktuara si objekte të mbrojtura, në rastin e konfliktit të armatosur.

Vise kulturore

Neni 14

Viset kulturore janë pjesë të veçanta të peizazhit, të cilat dallohen si rajone të interakcionit specifik të njeriut dhe natyrës, respektivisht si vise të rregulluara dhe të ndërtuara pjesërisht, vende kulti, vende të lidhura me luftëra ose ngjarje tjera të rëndësishme, ndërtime, nekropole dhe vendzbulime tjera arkeologjike ose vende që dëshmojnë për ekzistencën e njeriut në hapësirë dhe kohë, aktivitetet e tij, mënyrën e jetesës, zakonet, besimet ose traditat e veçanta.

1.2. Trashëgimia e tundshme kulturore

Sendet arkeologjike

Neni 15

(1) Sendet arkeologjike janë të gjithat sendet e tundshme të gjetura, të çfarëdo lloji ose materiali, të nxjerrura nga toka dhe uji, të cilat rrjedhin nga periudhat që janë lëndë pune për arkeologjinë ose shkencat ndihmëse të saj.

(2) Sendet arkeologjike konsiderohen edhe sendet e gjetura, që janë zbuluar si punime të pavarura, ose si relikte pjesësh karakteristike të objekteve të dikurshme, shtrimi i përhershëm i të cilave në regjimin e trashëgimisë kulturore të tundshme bazohet shkencërisht, përveç kur ekzistojnë arsye për rikomponimin e tyre ose kur ruajtja e tyre në vendin ku gjenden (in situ) është me interes publik prioritar. (sarkofagë, monumente epigrafike, shtylla, skulptura e tjerë)

(3) Sendet arkeologjike konsiderohen edhe pjesët, respektivisht elementet, të fituara me ndarje të përhershme (shtresim, nxjerrje, zbritje) nga objekti i zbuluar, kur kjo është bërë si masë mbrojtëse (mozaiqe muresh ose dyshemesh, freska, plastikë arkitektonike sakrale dhe profane, e tjerë)

Sendet etnologjike

Neni 16

(1) Sendet etnologjike janë të mira të tundshme, që dëshmojnë për mënyrën e jetës, aktivitetet, zakonet, ritet, besimet, idetë dhe kreacionet, që janë të domosdoshme që të kuptohen karakteristikat etnike dhe ndryshimet në kulturën materiale dhe shpirtërore të popullit maqedonas dhe të bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

(2) Sende etnologjike konsiderohen edhe pjesët, respektivisht elementet e fituara me ndarje nga objektet që kanë rëndësi etnologjike (musandra, rozeta, zbukurime tavani e tjerë)

Sendet historike

Neni 17

(1) Sendet historike janë të mira të tundshme, të lidhura me ngjarje të rëndësishme historike ose me aktivitete të lëvizjeve kulturore, nacionalçlirimtare, revolucionare dhe të lëvizjeve dhe organizatave të tjera politike, të institucioneve dhe shoqatave arsimore, kulturore, shkencore, fetare, sportive dhe të tjera, të organeve shtetërore ose me punën dhe jetën e personave eminentë, duke përfshirë edhe antikitetet, që nuk u takojnë llojeve të tjera të trashëgimisë kulturore të tundshme, si dhe ekzemplari obligativ i parave shtetërore.

(2) Sende historike konsiderohen edhe pjesët e fituara me shkëputje nga objektet që kanë rëndësi historike, të ndryshme nga ato të nenit 15 paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji.

Sendet artistike

Neni 18

(1) Sendet artistike janë vepra të tundshme artistike nga lëmi i arteve figurative si vijon: piktura dhe vizatime të punuara me dorë mbi çfarëdo baze dhe nga çfarëdo materiali, përveç disenjit industrial dhe prodhimeve industriale të zbukuruara me dorë, vepra origjinale të skulpturës, kompozicione artistike dhe montazhe në çfarëdo material, gravura origjinale, gdhendje bakri, litografi dhe shenja të tjera, posterë dhe fotografi origjinale, si mënyrë e krijimtarisë origjinale, dhe veprat e artit aplikativ, të punuara në çfarëdo materiali.

(2) Sende artistike konsiderohen edhe veprat e skulpturës, pikturës dhe të artit aplikativ, të ndryshme nga ato në nenin 15 paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji, të cilat janë të ndara përgjithmonë nga të mirat e patundshme, nëse kjo është bërë me interes publik dhe në mënyrën që nuk është në kundërshtim me ligjin.

Sendet teknike

Neni 19

Sendet teknike janë prodhimet e kulturës teknike, të lidhura me atapa të rëndësishme të progresit teknik (makina, vegla, instrumente, pajisje, mjete transportuese e tjerë).

Lënda arkivore

Neni 20

(1) Lënda arkivore është materiali i përgjithshëm i zgjedhur, burimor dhe i riprodhuar, me vlerë të përhershme dhe rëndësi për shtetin, shkencën, kulturën dhe për nevoja të tjera.

(2) Lëndë arkivore sipas paragrafit 1 të këtij neni konsiderohen edhe regjistrat, librat e inventarit dhe librat e tjerë publik për trashëgiminë kulturore, si dhe dokumentacioni për trashëgiminë kulturore dhe mbrojtjen e saj.

Të mirat bibliotekare

Neni 21

(1) Të mirat bibliotekare janë dorëshkrimet e vjetra (dorëshkrimet mesjetare dhe sllave ose dorëshkrimet në gjuhë të tjera) që kanë të bëjnë me Maqedoninë, të krijuara deri në fund të shekullit XIX, inkunabulet dhe postinkunabulet, të botuara deri në vitin 1530, botimet e para të

librave të rilindësve dhe botuesve ose shtypshkronjat në Maqedoni, hartat e vjetra dhe atlasët e Maqedonisë deri në vitin 1913, tërësi të veçanta të bibliotekave që rrjedhin nga institucionet arsimore, kulturore, shkencore, fetare dhe të tjera në Maqedoni deri në fund të vitit 1946 ose që janë botuar deri në atë periudhë, që kanë të bëjnë me ngjarje të rëndësishme historike në Maqedoni, libra të rrallë dhe material tjetër i rrallë i bibliotekave, i konfirmuar me ligj, si dhe biblioteka personale dhe familjare, me rëndësi kulturore dhe shkencore.

(2) Të mirat bibliotekare janë edhe ekzemplarët obligativ të publikimeve që dorëzohen në institucionin kompetent të bibliotekës, duke përfshirë materialin notar, filatelik, kartografik dhe material tjetër me status publikimi, si dhe ekzemplarin obligativ të punimeve të mbrojtura të doktoratës dhe magjistraturës, me përjashtim të të mirave nga neni 23 i këtij ligji.

Të mirat kinetike

Neni 22

Të mirat kinetike janë material burimor i veprës kinematografike, respektivisht negativi i fotografisë dhe ton-negativi i filmit, si dhe kopja tonike e filmit artistik, të vizatuar, dokumentar, shkencor-popullarizues dhe film tjetër nga produksioni kinematografik kombëtar dhe i huaj, origjinali dhe kopja e videoshiritit dhe mbajtës të tjerë të fotografive lëvizëse, me ose pa zë, pa dallim nga teknika e xhirimit, së bashku me dokumentacionin filmik (skenari, libri i xhirimit, materialet skenografike dhe kostumografike, afishi filmik e tjerë) si dhe ekzemplari obligativ që dorëzohet në institucionin kompetent të kinotekës.

Të mirat fonotekiste

Neni 23

Të mirat fonotekiste janë material burimor i tingujve të xhiruar, respektivisht shënime origjinale orale, muzikore ose lloj regjistrimesh zërore, ose kopje të tyre, pa dallim nga forma, teknika e regjistrimit të zërit dhe llojit të mediumit, duke përfshirë edhe ekzemplarin obligativ të fonogramit që dorëzohet në institucionin kompetent, në pajtim me ligjin.

1.3. Trashëgimia shpirtërore kulturore

Të mirat folklorike

Neni 24

Të mira folklorike janë zakonet, ritet, gojëdhënat, urtitë popullore, këngët popullore, përrallat, legjendat, fjalët e urta, kashelashet, tangot, vallet, zejet e vjetra dhe të rralla, shkathtësitë tradicionale dhe shprehi të tjera të krijimtarisë popullore jomateriale.

Gjuha

Neni 25

Gjuha është gjuha letrare, respektivisht gjuha e standardizuar dhe alfabeti i saj, si dhe të folmet lokale në gjuhë të njëjtë (dialektet).

Toponimet

Neni 26

Toponimet janë emra të liqeneve, lumenjve, burimeve dhe objekteve të tjera të ujit (hidronime), qyteteve, fshatrave dhe vendbanimeve të tjera (oikonime), rajone natyrore apo administrative (horonime), rrugë (dromonime), objekte të hapësirës bujqësore (agronime), male dhe objekte të tjera të natyrës lidhur me pyjet (dendronime) dhe emërtime të tjerë burimore, lokale dhe zyrtare, që kanë të bëjnë me toponiminë në Republikën e Maqedonisë.

1.4. Përkufizimi i trashëgimisë kulturore

Dispozitat e veçanta

Neni 27

(1) Trashëgimia kulturore e patundshme nga nenet 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, nuk i përfshin koleksionet e vendosura në monumentet, as koleksionet, të cilat ruhen ose janë të ekspozuara në lokalitetet arkeologjike ose në vende tjera në përbërje të tërësive monumentale dhe viseve kulturore.

(2) Trashëgimia kulturore e tundshme nga nenet 15, 16, 17, 18 dhe 19 të këtij ligji nuk i përfshin sendet që janë pjesë përbërëse të monumenteve nga neni 12 paragrafi 1 i këtij ligji.

(3) Në rast të kontestit, a thua ndonjë send i takon trashëgimisë kulturore, të tundshme apo të patundshme, si dhe në rastin kur ka kontest nga aspekti i llojit të trashëgimisë kulturore, së cilës i takon një e mirë e caktuar, për kontestin vendos Drejtoria.

Seksioni 2

KATEGORITË E TRASHËGIMISË KULTURORE

Trashëgimia kulturore me rëndësi të veçantë

Neni 28

(1) Pjesa e trashëgimisë kulturore nga neni 2 i këtij ligji me vlera të jashtëzakonshme dhe vlera e karakteristika të tjera të veçanta, është trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë.

(2) Trashëgimia kulturore me rëndësi të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të jetë me rëndësi të jashtëzakonshme dhe rëndësi të madhe.

(3) Trashëgimi kulturore me rëndësi të jashtëzakonshme sipas paragrafit 2 të këtij neni është çdo e mirë që ka rëndësi më të madhe nacionale dhe vlera univerzale për njerëzimin dhe historinë, kulturën, artin, shkencën e tij ose progresin teknik, respektivisht:

1. që paraqet krijimtari unike artistike, ekzemplar jashtëzakonisht të rrallë ose shembull me karakteristik për një lloj të caktuar të krijimtarisë, për periudhën prej së cilës rrjedhë.

2. që paraqet shembull karakteristik për stilet e artit, arkitekturës, konstrukcioneve, format e vendbanimeve tradicionale ose koncepteve urbanistike.

3. që ka bërë ose bënë ndikim të dukshëm në zhvillimin e kulturës, artit, shkencës, teknikës ose në zhvillimin shoqëror;

4. që është lidhur, ose paraqet dëshmi për ide, besime, ngjarje të rëndësishme ose personalitete të rëndësishme që kanë pasur rëndësi vendimtare në transformimin e shoqërisë.

(4) Trashëgimi kulturore me rëndësi të madhe, sipas paragrafit 2 të këtij neni është çdo e mirë që ka rëndësi të madhe për historinë nacionale, kulturën, artin, shkencën ose progresin teknik, respektivisht:

1. që paraqet dëshmi me interes të gjerë për studimin e dukurive shoqërore;

2. që dallohet me origjinalitetin e saj, reprezentim të llojit të vet, llojllojshmëri përmbajtësore, formë, pamje, funksion, vjetërsi, ruajtje ose dallim tjetër tipik, ndërsa për shkak të përsëritjes (prezencës në numër të madh) nuk bën pjesë në kategorinë e trashëgimisë kulturore, me rëndësi të jashtëzakonshme;

3. ku përfshihen pjesë, respektivisht detaje ose elemente të tjera të vlefshme, me rëndësi të madhe kulturore dhe historike;

4. që lidhet me ngjarje të rëndësishme dhe personalitete të dalluara nga historia dhe kultura nacionale;

(5) Trashëgimia kulturore me rëndësi të veçantë, është e mirë me interes publik për Republikën e Maqedonisë dhe gëzon mbrojtje të veçantë.

Trashëgimia me rëndësi kulturore

Neni 29

(1) Pjesa e trashëgimisë kulturore nga neni 2 i këtij ligji që nuk bën pjesë në kategorinë e trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë, si vlerë e përhershme, paraqet trashëgimi kulturore me rëndësi.

(2) Republika e Maqedonisë garanton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga paragrafi 1 i këtij neni sipas këtij dhe ligjit tjetër.

Seksioni 3

KATEGORITË E VEÇANTA TË TË MIRAVE TË MBROJTURA

Të mirat nën mbrojtje të përkohshme

Neni 30

(1) Të mirat e tundshme dhe të patundshme, për të cilat me bazë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore dhe mbrojtja e të cilave është vendosur në mënyrë të caktuar sipas neneve 38 dhe 39 të këtij ligji, kanë statusin e të mirave të mbrojtura përkohësisht.

(2) Në të mirat nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore nga neni 29 i këtij ligji.

Zona e rezervuar arkeologjike

Neni 31

(1) Zona e rezervuar arkeologjike është rajoni i kufizuar arkeologjik, i cili përmban çfarëdo gjurmë të ekzistimit të njeriut në epokat e kaluara, duke përfshirë edhe vende ku nuk ka mbeturina të dukshme në tokë ose nën ujë, gjurmimi dhe hulumtimi i të cilave, për shkak të mbrojtjes së mbeturinave të atilla materiale, është lënë për gjeneratat e ardhme.

(2) Zonë e rezervuar arkeologjike sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të jetë rajoni i cili përmban një lokalitet më të madh ose më tepër vendzbulime arkeologjike që paraqesin një tërësi të lidhur dhe të caktuar topografike, përbërja arkeologjike e të cilave nuk është identifikuar saktësisht, për t'u vënë në mbrojtje në mënyrë tjetër të rregullt dhe gjurmimi, interpretimi shkencor, prezantimi dhe shfrytëzimi i të cilave qëllimisht rezervohet për gjeneratat e ardhme të arkeologëve, nëse:

1. Nuk është hulumtuar ose pjesa e hulumtuar e saj përfshin më pak se një të tretën e hapësirës punuese;

2. E cila nuk është lëndë e gjurmimeve dhe hulumtimeve të filluara ose të lejuara sistematike;

3. Me rezervimin e saj nuk pengohet zhvillimi i shkencës arkeologjike, as plotësimi i koleksioneve publike arkeologjike;

4. Me rezervimin e saj nuk pengohet realizimi i programeve dhe projekteve të filluara zhvillimore me interes publik, të përcaktuara me planin hapësinor dhe urbanistik;

(3) Në zonën e rezervuar arkeologjike zbatohen dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore me rëndësi të veçantë.

Trashëgimia kulturore në rrezik

Neni 32

(1) Trashëgimia kulturore nga neni 2 i këtij ligji, së cilës i kanoset rreziku nga dëmtimi, shkatërrimi ose prishja më serioze e integritetit të saj, sipas këtij ligji dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, është trashëgimi kulturore në rrezik.

(2) Trashëgimi kulturore e rrezikuar, sipas paragrafit 1 të këtij neni, konsiderohen në radhë të parë të mirat, të cilave u kanoset rreziku i drejtpërdrejtë dhe i konfirmuar (i dëshmuar), për shkak të:

1. Dëmtimit të përsheptuar të materialit, nga i cili janë ndërtuar;
2. Ndryshimeve serioze të strukturës ose dekoracionit;
3. Ndryshimeve serioze të lidhshmërisë arkitektonike dhe urbanistike, të hapësirës urbane ose rurale ose të ambientit natyror;
4. Humbjes së dukshme të autenticitetit historik;
5. Bastardimit serioz të rëndësisë kulturore të tyre;
6. Ndryshimeve serioze për shkaqe të panjohura;
7. Riemërimit të toponimeve.

(3) Trashëgimi kulturore në rrezik, konsiderohen edhe të mirat të, cilat janë ekspozuar në rrezik të madh, nga i cili do të kenë pasoja dëmtuese në karakteristikat e tyre thelbësore, për shkak të:

1. Shpërthimit ose kërcënimit për shpërthimin e konfliktit të armatosur;
2. Fatkeqësive të natyrës, veçanërisht tërmete, vërshimeve, rrëshqitjes së dheut, zjarreve ose ndryshimeve progresive të faktorëve gjeologjik, klimatik dhe faktorëve të tjerë natyror;
3. Braktisjes nga çfarëdo arsye;
4. Mungesës, jopërkatesisë ose zbatimit të pamjaftueshëm të planeve dhe programeve për mbrojtje ose ndryshimin e regjimit të mbrojtjes që nuk korrespondon me statusin juridik-mbrojtës të trashëgimisë kulturore.

(4) Trashëgimia kulturore në rrezik, pa dallim nga lloji dhe kategoria që i takon, ka përparësi për zbatimin e masave mbrojtëse.

KAPITULLI III

INSTRUMENTET E MBROJTJES

Seksioni 1

IDENTIFIKIMI

Klasifikimi

Neni 33

(1) Për shkak të sigurimit të qasjes unike në identifikimin e trashëgimisë kulturore dhe ndërtimit të sistemit informativ për trashëgiminë kulturore, me zbatimin dhe përdorimin cilësor të të dhënave, trashëgimia kulturore klasifikohet sipas Klasifikimit nacional të trashëgimisë kulturore (në tekstin e mëtejme: Klasifikimi nacional), sipas këtij ligji.

(2) Klasifikimi nacional është standard i klasifikimit tipologjik që përdoret për identifikimin e trashëgimisë kulturore për nevoja zyrtare, në grupe, nëngrupe, lloje dhe tipe, me shifra dhe emra zyrtar.

(3) Klasifikimin nacional nga paragrafi 1 i këtij neni e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Klasifikimin e trashëgimisë kulturore sipas Klasifikimit nacional e bën Drejtoria.

Evidenca mbrojtëse

Neni 34

(1) Evidenca mbrojtëse sipas dispozitave të këtij ligji mbahet për:

1. Trashëgiminë kulturore dhe të mirat, për të cilat me bazë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore.

2. Të mirat e tundshme të cilat kanë origjinë nga Republika e Maqedonisë, ndërsa gjenden në vend të huaj, për çfarëdo arsye, dhe pa marrë parasysh kur janë dërguar, nëse janë me interes nga aspekti i ristituimit të tyre në vend (në tekstin e mëtejshëm: trashëgimi kulturore e disperzuar) dhe të mirat e tundshme, të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore të shtetit tjetër, ndërsa gjenden në territorin e Republikës (në tekstin e mëtejshëm: trashëgimi e huaj kulturore).

(2) Për të mirat nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet evidencë bazë, amë dhe qëndrore, si dhe evidenca plotësuese ose të veçanta, të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

(3) Evidencën bazë, sipas llojit të të mirave e mbajnë institucionet publike për mbrojtje, Arkivi dhe personat juridik, të autorizuar nga ministri për kulturë për kryerjen e punëve të mbrojtjes së të mirave të fonotekës dhe trashëgimisë kulturore shpirtërore.

(4) Evidencën amë, sipas llojit të të mirave, në veprimtaritë e mbrojtjes ku kjo është e përcaktuar me këtë ligj, e mbajnë institucionet amë kompetente të mbrojtjes.

(5) Evidencën qëndrore dhe evidencat e veçanta, sipas marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare i mban Drejtoria.

(6) Në evidencat nga paragrafi (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni bëhet revizion. Revizionin e bëjnë subjektet nga paragrafi (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

(7) Ministri i Kulturës e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave mbrojtëse nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe mënyrën e kryerjes së revizioneve të tyre.

Valorizimi dhe rivalorizimi

Neni 35

(1) Lëndë e valorizimit sipas këtij ligji janë të mirat për të cilat miratohet akti për mbrojtje.

(2) Lëndë e rivalorizimit sipas këtij ligji janë të mirat e mbrojtura për të cilat miratohet akti për ndryshimin dhe akti për ndërprerjen e mbrojtjes.

(3) Në rastet nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, përpilohet elaborat për valorizim, respektivisht elaborat për rivalorizim.

(4) Elaboratet nga paragrafi (3) i këtij neni, me përjashtim të rasteve nga neni 37 pika 2, neni 39 dhe neni 42 të këtij ligji, përmbajnë edhe propozimin për kategorizim adekuat të të mirave.

(5) Elaboratet nga paragrafi (3) i këtij neni, sipas llojit të të mirave, i përpilojnë:

1. Institucionet publike kompetente për mbrojtje;

2. Arkivi;

3. Personat juridik, të autorizuar për kryerjen e punëve të mbrojtjes të të mirave të fonotekës dhe trashëgimisë kulturore shpirtërore.

(6) Elaboratet nga paragrafi (3) i këtij neni paraqesin bazë për paraqitjen e propozimit për miratimin e aktit të mbrojtjes, respektivisht aktit të ndryshimit dhe aktit të ndërprerjes së mbrojtjes.

(7) Nëse lëndë e valorizimit ose rivalorizimit është e mirë nga kategoria trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, organi kompetent për paraqitjen e propozimit është i obliguar të sigurojë revizionin e elaboratit nga paragrafi 3 i këtij neni.

(8) Ministri i Kulturës i përcakton kriteret, kushtet dhe mënyrën e kryerjes së valorizimit, kategorizimit dhe rivalorizimit, përmbajtjen e elaborateve dhe mënyrën e sigurimit të revizionit.

Dokumentimi

Neni 36

(1) Dokumentimin e trashëgimisë kulturore dhe të mirave për të cilat me bazë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore (gjendja, ndryshimet, proceset e punës) e kryejnë institucionet kompetente publike të mbrojtjes, Arkivi dhe personat e tjerë juridik dhe fizik, të caktuar me këtë ligj.

(2) Ministri i Kulturës i përcakton llojin, përmbajtjen, standardet, normativët dhe mënyrën e dokumentimit të trashëgimisë kulturore.

Seksioni 2

VENDOSJA E MBROJTJES

2.1. Mbrojtja në bazë të këtij ligji (exh lege)

Trashëgimia kulturore e mbrojtur në bazë të këtij ligji

Neni 37

Trashëgimi kulturore, të mbrojtura në bazë të këtij ligji konsiderohen:

1. Të mirat e patundshme nga neni 12 paragrafi 2 dhe neni 13 paragrafi 2 i këtij ligji, si trashëgimi kulturore me rëndësi;
2. Ekzemplari obligativ i përcaktuar me ligj, pa marrë parasysh llojin e tij, dhe a i është dorëzuar institucionit kompetent apo jo, si trashëgimi kulturore me rëndësi të madhe;
3. Lënda arkivore nga neni 20 i këtij ligji, pa marrë parasysh a është dorëzuar në Arkiv , si trashëgimi kulturore me rëndësi;
4. Trashëgimia kulturore e tundshme me të cilën administrojnë institucionet publike të mbrojtjes (muzeumet, bibliotekat, kinotekat), e regjistruar në librin e inventarit si trashëgimi kulturore me rëndësi.

Të mira të mbrojtura përkohësisht në bazë të këtij ligji

Neni 38

Të mirat e mbrojtura përkohësisht në bazë të këtij ligji konsiderohen:

1. Zbulimet arkeologjike, siç janë:
 - të tundshme, deri në dorëzimin e tyre në institucionin publik kompetent për mbrojtje;
 - të patundshme, deri në marrjen e Vendimit sipas nenit 39 të këtij ligji;
2. Të mirat e tundshme, të siguruara nga institucioni publik kompetent për mbrojtje, deri në regjistrimin e tyre në librin e inventarit;
3. Të mirat për të cilat është ngritur procedura për vendosjen e mbrojtjes, deri në miratimin e aktit për mbrojtje;

2.2. Mbrojtja në bazë të aktit për mbrojtje

Vendim për mbrojtje të përkohshme

Neni 39

(1) Vendimi për mbrojtjen e përkohshme merret për të mirat, për të cilat me bazë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore si vijon:

1. Për të patundshmet, pa marrë parasysh llojin e tyre;
2. Për të tundshmet, që i ruajnë poseduesit, respektivisht që gjenden jashtë institucioneve publike kompetente për këtë lloj të mirash, me përjashtim nga ato të cilat gëzojnë mbrojtje sipas nenit 38 pika 1 alineja 1 të këtij ligji.

(2) Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni merr Drejtoria, në bazë të propozimit të institucionit publik kompetent të mbrojtjes, ndërsa për të mirat e fonotekës në bazë të propozimit të personit të autorizuar juridik nga neni 154 i këtij ligji.

(3) Afati për të cilin caktohet kohëzgjatja e mbrojtjes së përkohshme nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj për të mirën e tundshme, respektivisht dy vjet për vendzbulimet arkeologjike dhe një vjet për të mirën tjetër të patundshme, llogaritur nga dita e marrjes së Vendimit.

(4) Vendimi për mbrojtjen e përkohshme pushon të vlejë me skadimin e afatit të caktuar, respektivisht në ditën e miratimit të aktit për shpalljen e të mirës.

(5) Ankesa kundër Vendimit për mbrojtjen e përkohshme nuk e pengon ekzekutimin e Vendimit.

Vendim për shpalljen e trashëgimisë kulturore me rëndësi

Neni 40

(1) Vendim për shpalljen e trashëgimisë kulturore me rëndësi, merret për të mirat me mbrojtje të përkohshme, për të cilat është marrur Vendim për mbrojtje të përkohshme dhe për të mirat pa mbrojtje të të gjitha llojeve, nëse është përmbushur së paku një nga kriteret e nenit 2, lidhur me nenin 29 të këtij ligji.

(2) Vendim nga paragrafi (1) i këtij neni merr Drejtoria, si vijon:

1. Për të mirat e patundshme dhe të tundshme me propozim të institucionit publik kompetent për mbrojtje;
2. Për të mirat shpirtërore dhe të fonotekës me propozim të personave juridik, të autorizuar për kryerjen e punëve të mbrojtjes së llojit përkatës të të mirave.

(3) Propozimit për shpalljen e të mirave të tundshme dhe të patundshme i bashkangjitet mendimi i poseduesit.

(4) Kur lëndë për shpallje është e mira e patundshme, propozimi nga paragrafi (2) pika 1 e këtij neni dhe skica e aktit për mbrojtje, paraqiten për të dhënë mendim:

1. Organit të administratës shtetërore kompetent për punët e rregullimit të hapësirës dhe organit të administratës shtetërore, kompetent për punët e mbrojtjes së ambientit jetësor, natyrës dhe planifikimit hapësinor.
2. Njësisë së vetadministrimit lokal në rajonin e të cilit gjendet ajo zonë.

(5) Ankesa kundër Vendimit për shpalljen e trashëgimisë kulturore me rëndësi, nuk e pengon ekzekutimin e Vendimit.

*Vendim për shpalljen e trashëgimisë kulturore
me rëndësi të veçantë*

Neni 41

(1) Vendim për shpallje trashëgimi kulturore të rëndësisë së veçantë merret për trashëgiminë kulturore nga neni 37 pikat 3 dhe 4 të këtij Ligji, të mirat përkohësisht të mbrojtura për të cilat është miratuar vendimi për mbrojtje të përkohshme dhe për të mirat e pambrojtura për të cilat ka parashikime reale se paraqesin trashëgimi kulturore, nëse e përmbushin së paku njërin nga kriteret nga neni 28 paragrafi (3) dhe (4) në lidhje me nenin 2 të këtij Ligji.

(2) Vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, e merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë së Kulturës dhe mendimit të Këshillit nacional për trashëgimi kulturore.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, të mirat e veçanta shpirtërore ose të mirat e patundshme që paraqesin tërësi përkujtimore, përkatësisht zonë kulturore, mund të shpallen me ligj.

(4) Në aspekt të marrjes së mendimit paraprak nga poseduesi, vetadministrimi lokal dhe nga organet kompetente të administratës shtetërore, zbatohen dispozitat nga neni 40 paragrafët 3 dhe 4 të këtij Ligji.

(5) Vendimi për shpalljen e trashëgimisë kulturore të rëndësisë së veçantë shpallet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

*Vendim për caktimin e zonës arkeologjike
të rezervuar*

Neni 42

(1) Vendimi për caktimin e zonës arkeologjike të rezervuar merret nëse janë përmbushur kriteret nga neni 31 paragrafi 2 i këtij Ligji.

(2) Vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni e merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Ministrisë së Kulturës dhe me mendimin e:

1. Këshillit nacional për trashëgimi kulturore;
2. Ministrive kompetente për çështjet e mbrojtjes të mjedisit jetësor, natyrës, planifikimit hapësinor dhe urbanistik ;
3. Njësisë të vetadministrimit lokal në rajonin e të cilit gjendet ajo zonë.

(3) Afati brenda të cilit bëhet rezervimi i zonës arkeologjike nuk mund të jetë më i vogël nga afati i vlefshmërisë të Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë.

(4) Vendimi për caktimin e zonës arkeologjike të rezervuar shpallet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Seksioni 3

**SHPALLJA E TRASHËGIMISË KULTURORE
NË RREZIK**

Shpallje urgjente

Neni 43

(1) Për trashëgimi kulturore në rrezik mund të shpallet çdo e mirë e mbrojtur, në qoftë se është përmbushur së paku njëri nga kriteret të nenit 32 paragrafi 2 dhe 3 të këtij Ligji

(2) Vendim për shpallje të trashëgimisë kulturore në rrezik merr Drejtoria, sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesë të institucionit publik kompetent për mbrojtje, përkatësisht personit juridik të autorizuar për kryerje të punëve për mbrojtje të të mirave fonoteke dhe llojin përkatës të trashëgimisë kulturore shpirtërore.

(3) Vendim nga paragrafi (2) i këtij neni për dokumentet e arkivit merr Arkivi.

(4) Me vendimin për shpallje të trashëgimisë kulturore në rrezik përcaktohen, sidomos: masat urgjente për mbrojtje, kufizimet e veçanta, afati në të cilin duhet të ndërmerren masat për mbrojtje dhe mjetet financiare.

(5) Ankesa kundër vendimit për shpalljen e trashëgimisë kulturore në rrezik nuk e pengon ekzekutimin e vendimit.

Seksioni 4

NDRYSHIME DHE NDËRPRERJA E MBROJTJES

Akt për ndryshime dhe ndërprerjen e mbrojtjes

Neni 44

(1) Akt për ndryshime miratohet në qoftë se paraqiten ndryshime relevante në përmbajtjen e aktit për mbrojtje.

(2) Akt për ndërprerjen e mbrojtjes mund të miratohet për:

1. Trashëgimi kulturore të tundshme për të cilën është lejuar eksporti;
2. Trashëgimi kulturore të patundshme dhe të tundshme e cila është shkatërruar përgjithmonë;
3. Trashëgimi kulturore e cila e ka humbur rëndësinë për të cilën është vënë nën mbrojtje.

(3) Aktin për ndryshime dhe ndërprerjen e mbrojtjes e miraton organi që e ka miratuar aktin për mbrojtje, në procedurë të njëjtë.

Seksioni 5

REGJISTRIMI

Regjistri nacional i trashëgimisë kulturore

Neni 45

(1) Për trashëgiminë kulturore mbahet Regjistër nacional i trashëgimisë kulturore (në tekstin e mëtejme: Regjistri).

(2) Regjistri është libër publik i cili përbëhet prej librit kryesor dhe regjistrave plotësues.

(3) Libri kryesor përbëhet prej pjesëve të veçanta për trashëgiminë shpirtërore dhe kulturore të patundshme dhe të tundshme me rëndësi të veçantë.

(4) Regjistra plotësues janë:

1. Regjistri i të mirave nën mbrojtje të përkohshme;
2. Regjistri i trashëgimisë kulturore në rrezik;
3. Regjistri i zonave arkeologjike të rezervuara.

(5) Regjistrin e mban Drejtoria.

(6) Evidentimi dhe shlyerja në Regjistër bëhet në bazë të aktit për mbrojtje, përkatësisht ndryshimit ose ndërprerjes së mbrojtjes, aktit për shpallje të trashëgimisë kulturore në rrezik dhe aktit për regjistrim nga neni 46 i këtij Ligji.

(7) Ministri i Kulturës e përcakton përmbajtjen, mënyrën e mbajtjes, ruajtjen, shfrytëzimin e të dhënave dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me Regjistrin.

Akti për regjistrim

Neni 46

(1) Akti për regjistrim miratohet për:

1. Të mirat, të mbrojtura sipas nenit 37 dhe nenit 38 të këtij Ligji, në bazë të fletëparaqitjes nga institucioni kompetent publik për mbrojtje dhe Arkivin;

2. Ndryshimet vijuese të të dhënave për të mirat e mbrojtura që i nënshtrohen regjistrimit, në pajtim me përmbajtjen e përcaktuar të Regjistrit.

(2) Akt për regjistrim është vendimi për regjistrim, vendimi për regjistrimin e ndryshimeve dhe vendimi për shlyerje nga Regjistri.

(3) Aktin për regjistrim e miraton Drejtoria.

(4) Ekstrakt nga Regjistri detyrimisht i dorëzohet institucionit kompetent publik për mbrojtje, Arkivit, personit juridik të autorizuar për kryerjen e punëve për mbrojtjen e të mirave të fonotekës dhe llojit përkatës të trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe poseduesit, ndërkaq për të mirat e mbrojtura të patundshme edhe në organin kompetent të drejtorisë shtetërore për evidentimin e të drejtës në pronësi.

Seksioni 6

FITIMI I STATUSIT NDËRKOMBËTAR

Nominimi

Neni 47

(1) Trashëgimia kulturore e rëndësishë së veçantë mund të propozohet për fitimin e statusit ndërkombëtarisht të pranuar ose evidentim në regjistrin ndërkombëtar konform marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

(2) Vendimin për nominim sipas paragrafit (1) të këtij neni, e merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Ministrisë së Kulturës dhe mendimit të Këshillit nacional për trashëgimi kulturore.

Seksioni 7

SHËNIMI

Shënimi i detyrueshëm dhe shenjat ndërkombëtare

Neni 48

(1) Të mirat e patundshme të mbrojtura detyrimisht shënohen me shenjë mbrojtëse.

(2) Shënimin sipas paragrafit 1 të këtij neni e bën institucioni publik kompetent për mbrojtje në afat prej 60 ditësh nga miratimi i aktit për mbrojtje.

(3) Trashëgimia kulturore e patundshme dhe transportimi special i trashëgimisë kulturore të tundshme, me pëlqim të Drejtorisë, mund të shënohet edhe me shenjë të caktuar me marrëveshjen ndërkombëtare (në tekstin e mëtejme: shenjë ndërkombëtare).

(4) Ministri i Kulturës e përcakton përmbajtjen e ligjit për mbrojtje dhe mënyrën e shënimit, përdorimin e shenjave ndërkombëtare dhe vendosjen e shenjave tjera.

Seksioni 8

STRATEGJIA NACIONALE PËR MBROJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Strategjia nationale

Neni 49

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Këshillit nacional për trashëgimi kulturore, miraton Strategji nationale për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore (në tekstin e mëtejme: Strategji nationale).

(2) Strategjia nacionale miratohet për periudhë 15 vjeçe dhe përmban baza afatgjate të politikës për mbrojtje dhe shfrytëzim të trashëgimisë kulturore.

(3) Strategjia nacionale harmonizohet me Planin hapësinor të Republikës së Maqedonisë dhe me strategjitë për mbrojtje dhe shfrytëzim të trashëgimisë kulturore të përbashkët në Evropë.

KAPITULLI IV

REGJIMI I MBROJTJES DHE SHFRYTËZIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Seksioni 1

NDALIME TË PËRGJITHSHME

Ndalim për dëmtimin, shkatërrimin, përvetësimin, shmangien, fshehjen dhe uzurpimin e trashëgimisë kulturore

Neni 50

(1) Askush nuk guxon ta dëmtojë e as ta shkatërrojë trashëgiminë kulturore, zonën e rezervuar arkeologjike dhe të mirat nën mbrojtje të përkohshme.

(2) Askush nuk guxon të përvetësojë gërmim ose send tjetër të gjetur i cili paraqet trashëgimi kulturore apo të mirë nën mbrojtje të përkohshme.

(3) Askush nuk guxon të blejë, të pranojë në peng ose në mënyrë tjetër të furnizojë, shmang apo të kontrabandojë një send që paraqet trashëgimi kulturore ose të mirë nën mbrojtje të përkohshme për të cilën e di se është e furnizuar përmes veprës ndëshkuese.

(4) Askush nuk guxon që në mënyrë kundërligjore të përvetësojë send të huaj i cili paraqet trashëgimi kulturore apo të mirë nën mbrojtje të përkohshme që i është besuar në ruajtje.

(5) Askush nuk guxon të uzurpojë trashëgimi kulturore të patundshme që nuk është e tij ose patundshmëri tjetër që është e mbrojtur sipas dispozitave të këtij Ligji.

Ndalim për tjetërsim të trashëgimisë kulturore shtetërore të rëndësisë së veçantë

Neni 51

Trashëgimia kulturore e rëndësisë së veçantë në pronësi shtetërore nuk mund të tjetërsohet.

Ndalim për eksportin e trashëgimisë kulturore të rëndësisë së veçantë

Neni 52

Trashëgimia kulturore e rëndësisë së veçantë nuk guxon të eksportohet.

Ndalim për import të trashëgimisë kulturore të vjedhur

Neni 53

Trashëgimia kulturore e vjedhur nga muzetë, objektet fetare dhe nga objekte dhe institucione të ngjashme publike në territorin e shtetit tjetër nuk guxon të importohet.

Ndalim për rekuizim, represion, sulm dhe shfrytëzim të trashëgimisë kulturore për qëllime lufte

Neni 54

(1) Trashëgimia kulturore dhe të mirat nën mbrojtje të përkohshme nuk guxon të rekuizohen e as të ndërmerren kundër tyre çfarëdo lloj masash represive.

(2) Trashëgimia kulturore dhe të mirat nën mbrojtje të përkohshme nuk guxon të shfrytëzohen për qëllime lufte dhe as të jenë cak i sulmit.

Seksioni 2

KËRKIME ARKEOLOGJIKE DHE ZBULIME TË RASTIT

2.1. Kërkime arkeologjike

Leje për kërkime arkeologjike

Neni 55

(1) Gërmimet arkeologjike, rikognoskimet dhe kërkimet e ngjashme, duke i përfshirë edhe ato nën ujë (në tekstin e mëtejshëm: kërkime arkeologjike), bëhen vetëm në bazë të lejes nga Drejtoria.

(2) Me lejen nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet: bartësi i lejes, rajoni në të cilin mund të kryhen kërkimet arkeologjike, kahja, lloji dhe vëllimi i punëve, koha brenda së cilës duhet të kryhen punët dhe kushtet nën të cilat mund të kryhen kërkimet arkeologjike.

(3) Leja nga paragrafi 1 i këtij neni, lëshohet vetëm për një bartës të lejes.

(4) Drejtoria me vendim do ta refuzojë kërkesën për lëshimin e lejes nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse nuk janë përmbushur kushtet nga neni 58 i këtij Ligji.

(5) Lejes nga paragrafi 1, përkatësisht vendimit nga paragrafi 5 i këtij neni, mund t'i paraqitet ankesë.

Bartësi i lejes për kërkime arkeologjike dhe udhëheqja me kërkimet

Neni 56

(1) Bartësi i lejes për kërkime arkeologjike mund të jetë person juridik ose fizik që ka kualifikime shkencore përkatëse ose kualifikime profesionale për aso lloj kërkimesh dhe i përmbush kushtet tjera për marrjen e lejes.

(2) Bartës i lejes sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të jetë:

1. Institucioni shkencor i regjistruar për kryerjen e punëve nga sfera e arkeologjisë;
2. Institucioni publik për mbrojtje nga sfera e veprimtarisë muzeore dhe monumentale;
3. Personi tjetër juridik i cili në marrëdhënie të përhershme pune ose në anëtarësi të rregullt ka më së paku një gjurmues të autorizuar;

4. Punëtori shkencor ose gjurmues i pavarur me status të kërkuesit të autorizuar

(3) Me gërmime arkeologjike dhe me metoda tjera potencialisht destruktive hulumtuese si edhe me kërkimet arkeologjike nën ujë, mund të udhëheqë vetëm personi me status të kërkuesit të autorizuar.

(4) Kërkues i autorizuar sipas paragrafit (2) pikat 3 dhe 4 dhe paragrafit (3) të këtij neni, konsiderohet:

1. Punëtori shkencor nga sfera e arkeologjisë;
2. Arkeolog me titull profesional të zgjedhur në veprimtarinë muzeore dhe monumentale;
3. Arkeolog me licencë për kërkime arkeologjike.

(5) Licencë për kërkime arkeologjike lëshon Ministria e Kulturës në bazë të provimit të dhënë para komisionit që e cakton Ministria e Kulturës.

(6) Ministria e Kulturës do t'ia marrë licencën, nëse bartësi i licencës:

1. I realizon gërmimet arkeologjike në kundërshtim me lejen e lëshuar;
2. Gjatë kërkimeve arkeologjike nuk aplikon metodologji përkatëse;

3. Dëmtton ose shkakton rrezik të drejtpërdrejtë për dëmtimin ose shkatërrimin e gjermimeve;
 4. Vepron në kundërshtim me normat etike në fushën e mbrojtjes.
- (7) Ministri i Kulturës e përcakton formularin e licencës, mënyrën dhe programin e provimit nga paragrafi (5) i këtij neni.

Kërkuesit e huaj

Neni 57

(1) Institucionet e huaja shkencore dhe punonjësit e huaj shkencor nga fusha e arkeologjisë mund të jenë bartës të lejes për kërkime arkeologjike vetëm nëse punët i realizojnë në bashkëpunim me personat juridik nga neni 56 paragrafi (2) pikat 1 dhe 2 të këtij Ligji dhe nën kushte të përcaktuara me marrëveshjen e lidhur ndërmjet tyre.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, në raste të veçanta, institucionit të huaj shkencor nga fusha e arkeologjisë apo organizatës ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes mund t'u lëshohet leje për kërkime arkeologjike që realizohen si mision i pavarur arkeologjik.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni:

1. Raportet e ndërsjella në lidhje me punën e misionit të huaj arkeologjik, përkatësisht misionit arkeologjik ndërkombëtar, rregullohen me marrëveshje të veçantë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe personit të huaj juridik;

2. Qeveria cakton bashkërenditës nacional për misionin e huaj arkeologjik, përkatësisht për misionin arkeologjik ndërkombëtar.

(4) Marrëveshjet nga paragrafët (1) dhe (3) pika 1 të këtij neni, nuk mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji.

(5) Arkeologë të huaj dhe punonjës tjerë shkencor dhe profesional nga sfera e mbrojtjes, mund të marrin pjesë në kërkimet arkeologjike që i kryejnë personat juridik dhe fizik vendor, me pëlqimin e udhëheqësit të kërkimit.

Kushtet për lëshimin e lejes për kërkime arkeologjike

Neni 58

(1) Leje për kërkime arkeologjike mund të lëshohet vetëm nëse aplikuesi i kërkesës ka dorëzuar:

1. Dëshmi se mund të jetë bartës i lejes, sipas nenit 56 ose nenit 57 të këtij Ligji;

2. Planin bazë për kërkime arkeologjike, me masa mbrojtëse për vendin e gjermimit dhe gjermimet e gjetura;

3. Listën e personave që e përbëjnë ekipin profesional dhe obligimet e tyre në suazat e ekipit, me të dhëna dhe dëshmi elementare për kualifikimet e tyre;

4. Specifikatë për mjetet teknike për kryerjen e kërkimeve;

5. Dëshmi për mjetet financiare të siguruara për kërkimet dhe për zbatimin e masave mbrojtëse.

(2) Nëse kërkimet arkeologjike i kryen subjekti nga neni 56 paragrafi 2 i këtij Ligji i cili nuk e ka statusin e institucionit muzeor publik, kërkesës i bashkangjitet marrëveshja me institucionin muzeor publik në rajonin e të cilit do të realizohen kërkimet.

(3) Nëse kërkimet arkeologjike përfshijnë gjermime apo metoda tjera gjurmuese me të cilat kufizohet shfrytëzimi i rregullt i truallit apo objektit që duhet të gjurmohet, aplikuesi i kërkesës obligohet të paraqesë marrëveshje për rregullimin e raporteve të ndërsjella me pronarin, përkatësisht deklaratë nga pronari për kryerje të papengueshme të punëve.

(4) Nëse kërkimet arkeologjike përfshijnë përdorimin e mjeteve specifike teknike për të cilat është e nevojshme leje e veçantë sipas këtij apo ndonjë ligji tjetër, kërkesës i bashkangjitet edhe dëshmi për përdorim të autorizuar të të njëjtave.

Obligimet e bartësit të lejes

Neni 59

(1) Bartësi i lejes për kërkime arkeologjike obligohet që gjatë realizimit të punëve:

1. Të mbajë dokumentacion dhe evidencë të rregullt për kërkimet arkeologjike dhe për masat mbrojtëse që i ndërmerr;

2. Të sigurojë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vendgërmimeve dhe zbulimeve;

3. Të mos i lë të pambuluara apo të ekspozuar në vend të hapur zbulimet arkeologjike, pa ndërmarrjen e masave paraprake për mbrojtje;

4. Të kryejë ose organizojë realizimin e punëve rreth konservimit të vendzbulimit, përkatësisht zbulimeve;

5. Ta informojë opinionin kohë pas kohe për rrjedhën e kërkimit;

6. Të mundësojë shikim të vendzbulimit dhe zbulimeve nga ana e personave të autorizuar, ndërsa me pëlqimin e udhëheqësit të kërkimeve edhe shikim nga ana e punëtorëve të interesuar shkencor dhe profesional.

(2) Bartësi i lejes për kërkime arkeologjike obligohet që para se të largohet nga terreni:

1. T'i ndërmarrë masat e domosdoshme për sigurimin teknik të vendzbulimit, duke përfshirë edhe rregullimin e vendit rreth e qark tij.

2. Terrenin ta kthejë në gjendjen e mëparshme, aq sa është e mundshme, nëse vendzbulimi nuk konservohet, përkatësisht prezantohet.

(3) Bartësi i lejes për kërkime arkeologjike obligohet që pas përfundimit të punëve:

1. Në afat prej tre muajsh, Drejtorisë t'i paraqesë raport për kërkimet e bëra arkeologjike;

2. Në afat prej një viti, Drejtorisë t'ia dorëzojë dokumentacionin final nga kërkimet arkeologjike;

3. Në afat prej tre vjetësh t'i shpallë rezultatet nga kërkimet arkeologjike;

4. Zbulimet e tundshme t'ia dorëzojë muzeut të caktuar sipas nenit 61 paragrafëve 1, 3 dhe 6 të këtij Ligi.

Ndërprerje e përkohshme e kërkimeve dhe marrja e lejes

Neni 60

(1) Nëse bartësi i lejes i bën kërkimet arkeologjike në kundërshtim me lejen e lëshuar, Drejtoria mundet me vendim përkohësisht t'i ndërpresë punët dhe të caktojë afat për përmbushjen e kushteve për vazhdimin e punëve.

(2) Në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë për vendgërmimet ose nëse gjatë kërkimeve arkeologjike nuk aplikohet metodologji përkatëse e punës, Drejtoria mundet me vendim ta marrë lejen e lëshuar.

(3) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni, nuk e pengon ekzekutimin e vendimit.

Bartësi i së drejtës për shfrytëzimin e zbulimeve të tundshme arkeologjike

Neni 61

(1) Drejtoria me vendim përcakton kujt i takon e drejta për shfrytëzimin e zbulimeve të tundshme arkeologjike, të rrëmihura apo të gjetura gjatë hulumtimeve arkeologjike.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse bartës i lejes për kërkime arkeologjike është institucioni publik muzeor, të drejtën për shfrytëzimin e zbulimeve të tundshme arkeologjike do ta ketë ai institucion.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse zbulimet e tundshme arkeologjike ose një pjesë e tyre kanë rëndësi të veçantë për Republikën e Maqedonisë, ndërsa bartësi i lejes nuk ka status të institucionit nacional, me qëllim të kompletimit të përmbledhjes nacionale muzeore, si bartës i të drejtës për shfrytëzim mund të përcaktohet institucioni amë ose institucion tjetër nacional muzeor.

(4) Nëse, zbulimet e tundshme arkeologjike ose një pjesë e tyre kanë rëndësi të veçantë për Republikën e Maqedonisë, ndërsa bartësi i lejes ka status të institucionit nacional muzeor, me qëllim të kompletimit të përmbledhjes nacionale muzeore, si bartës i të drejtës për shfrytëzim mund të përcaktohet institucioni amë ose institucion tjetër nacional muzeor.

(5) Vendimin nga paragrafët (1), (3) dhe (4) të këtij neni, Drejtoria e miraton sipas mendimit paraprakisht të marrë nga muzeu kompetent amë.

(6) Deri në plotfuqishmërinë e vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, me përjashtim të rasteve nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, në afat prej 30 ditësh nga dita e përmbylljes së kërkimeve, zbulimet e tundshme arkeologjike dorëzohen në ruajtje të përkohshme në muzeun kompetent në rajonin e të cilit janë realizuar kërkimet.

E drejta në pronësi shkencore

Neni 62

(1) Bartësi i lejes për kërkime arkeologjike dhe personat që i kanë realizuar kërkimet kanë të drejtë përparësie për përpunim shkencor të zbulimeve dhe për shpalljen e rezultateve nga kërkimet (në tekstin e mëtejme: e drejtë në pronësi shkencore), në kohëzgjatje tre vjeçare pas mbarimit të kërkimit.

(2) Deri në shpallje të rezultateve nga kërkimet arkeologjike, por jo më gjatë se tre vjet:

1. Personat që i kanë kryer kërkimet kanë të drejtë në qasje të papengueshme në zbulimet e tundshme dhe në dokumentacionin për të njëjtat;

2. Institucioni publik të cilit i janë besuar zbulimet sipas nenit 61 të këtij Ligji, nuk guxon që tërësinë e sendeve dhe dokumentacionin, pa pëlqimin e udhëheqësit të kërkimit, t'ia japë personit tjetër për studime më të plota dhe as të lejojë fotografimin dhe riprodhimin me qëllim të publikimit;

3. Dokumentacioni nga kërkimet arkeologjike, pa pëlqimin e udhëheqësit të kërkimit nuk guxon t'i jepet personit tjetër për hulumtime më të plota dhe publikim.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) pikat 2 dhe 3 të këtij neni, Drejtoria mundet me vendim, nëse është në inters publik, ta kufizojë të drejtën në pronësi shkencore.

(4) Dispozitat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për lloje të tjera të kërkimeve nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Përdorimi i pajisjes për detektim

Neni 63

(1) Metal-detektorë dhe mjete tjera teknike të përshtatshme për detektim të gërmimeve arkeologjike, përkatësisht sendeve që kanë rëndësi arkeologjike, mund të përdoren gjatë kërkimeve arkeologjike vetëm nëse pronari i pajisjes ka marrë pëlqim nga Drejtoria.

(2) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të pronarit të pajisjes.

(3) Pajisja për detektim nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon të përdoret për kryerje dhe as për t'i ndihmuar apo nxitur gërmimet jolegale, zbulimet ose mënjanimin e elementeve të trashëgimisë arkeologjike.

(4) Për lejet e lëshuara nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria mban evidencë të veçantë.

Akti i përgjithshëm për kërkimet arkeologjike

Neni 64

Ministri i Kulturës i përcakton kushtet e kryerjes së kërkimeve arkeologjike, si edhe formularët, llojin, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për kërkimet.

2.2. Zbulime të rastësishme

Obligimet e zbuluesit

Neni 65

(1) Nëse gjatë realizimit të punëve ndërtimore, bujqësore ose punëve tjera zbulohet zbulim arkeologjik, përkatësisht sende të rëndësishme arkeologjike, kryerësi i punëve obligohet :

1. Ta denoncojë zbulimin sipas nenit 129 paragrafi (2) i këtij Ligji;
2. T'i ndërpresë punët dhe ta sigurojë vendzbulimin nga dëmtimet dhe shkatërrimet e mundshme si dhe nga qasjet e pa autorizuara;
3. T'i ruajë sendet e zbuluara në vendin dhe gjendjen në të cilën i kanë gjetur.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse sendet janë rrëmihur, përkatësisht i kanë nxjerrë për shkak të mbrojtjes së tyre më të mirë ose për shkak të rrethanave, realizuesi i punëve është i obliguar:

1. Gjatë denoncimit t'i dorëzojë sendet e zbuluara ose këtë ta bëjë gjatë identifikimit sipas nenit 66 të këtij Ligji, dhe gjer në momentin e dorëzimit t'i ndërmarrë masat e duhura që të mos prishen, dëmtohen apo tjetërsohen.

2. T'i japë të gjitha të dhënat relevante në lidhje me vendin dhe pozitën e sendeve në kohën e zbulimit të tyre dhe për rrethanat në të cilat është bërë ky zbulim.

Identifikimi i zbulimeve të rastësishme

Neni 66

(1) Në rastet nga neni 65 i këtij Ligji, institucioni kompetent publik për mbrojtje obligohet që menjëherë ose më së voni ditën e ardhshme pas pranimi të lajmërimit nga neni 129 paragrafi (2) i këtij Ligji:

1. Të bëjë një inspektim me komision dhe të konfirmojë a bëhet fjalë për zbulim të rastësishëm dhe për të mirë nën mbrojtje të përkohshme nga neni 38 pika 1 e këtij Ligji;
2. Ta ndërmarrë përkujdesjen për ruajtjen e vendzbulimit dhe zbulimeve në gjendjen në të cilën janë zbuluar;
3. T'i dorëzojë sendet e pranuar në ruajtje të përkohshme në muzeun kompetent, bashkë me dokumentacionin për identifikimin e tyre;
4. Ta njoftojë Drejtorinë për gjendjen e konstatuar dhe të propozojë masa që janë në kompetencat e tij.

(2) Nëse institucioni kompetent publik për mbrojtje konstaton se nuk bëhet fjalë për vendzbulim të rastësishëm ose për të mirë të zbuluar nën mbrojtje të përkohshme nga neni 38 pika 1 e këtij Ligji, në procesverbalin për inspektimin e kryer profesional theksohet konstatimi strikt për këtë punë.

(3) Institucioni kompetent sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, është institucioni nacional për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore në rajonin e të cilit gjendet vendzbulimi rastësisht i zbuluar.

Mbikëqyrja arkeologjike dhe ndërprerja e përkohshme e punëve

Neni 67

(1) Drejtoria, duke pasur parasysh karakterin e vendzbulimit të zbuluar dhe punët që kryhen, brenda tre ditësh nga dita e marrjes së propozimit nga institucioni kompetent publik për mbrojtje mundet:

1. Me vendim të përcaktojë që realizimi i punëve të vazhdojë nën mbikëqyrje arkeologjike të institucionit kompetent publik për mbrojtje, ose

2. Të marrë vendim për ndërprerje të përkohshme të punëve dhe ta përcaktojë realizimin e gërmimeve dhe kërkimeve mbrojtëse, si dhe ndërmarrja e masave tjera mbrojtëse.

(2) Vendimi nga paragrafi (1) pika 2 e këtij neni mund të merret edhe gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes arkeologjike, nëse paraqitet nevoja që ai të zëvendësohet me gërmime dhe hulumtime mbrojtëse.

(3) Ndërprerja e përkohshme e punëve sipas paragrafit (1) pika 2, përkatësisht paragrafit 2 të këtij neni, zgjat më së shumti 30 ditë.

(4) Brenda afatit nga paragrafi (3) i këtij neni, Drejtoria mund të marrë vendim nga neni 39 i këtij Ligji.

(5) Nëse Drejtoria nuk reagon sipas paragrafit (4) të këtij neni, pas mbarimit të gërmimeve dhe hulumtimeve mbrojtëse vendzbulimi trajtohet si hapësirë e lirë.

(6) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk e pengon ekzekutimin e vendimit.

(7) Shpenzimet në lidhje me mbikëqyrjen arkeologjike, gërmimet dhe kërkimet arkeologjike, konservimin dhe masat tjera mbrojtëse janë barrë e Drejtorisë.

Shpërblim për zbulim të rastësishëm

Neni 68

(1) Personi i cili do të zbulojë të mirë të tundshme ose të patundshme nën mbrojtje të përkohëshme, ka të drejtë në shpërblim dhe kompensim në shpenzimet për zbulimin, nën kushte të përcaktuara me ligj.

(2) Lartësinë e shpërblimit dhe kompensimit të shpenzimeve nga zbulimi i rastësishëm e përcakton Ministria e Kulturës.

(3) Ministria e Kulturës mund të heq dorë nga e mira e zbuluar nëse sipas mendimit profesional të institucionit kompetent amë, ajo e mirë nuk i përmbush kriteret për fitimin e statusit trashëgimi kulturore.

Seksioni 3

MBROJTJA E INTEGRUAR

Mbrojtja e trashëgimisë së patundshme kulturore si njëra nga qëllimet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik

Neni 69

(1) Me qëllim të krijimit të kushteve të përhershme dhe kushteve tjera shoqërore për ekzistencë, jetësim dhe shfrytëzim funksional të trashëgimisë së patundshme kulturore, mbrojtja e saj është njëra nga qëllimet kryesore të planifikimit hapësinor dhe urbanistik.

(2) Në realizimin e qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, varësisht nga lloji dhe rajoni i përfshirjes së planit, sigurohet:

1. Përfshirje dhe respektim i detyrueshëm i të mirave të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji;
2. Përpunimi i regjimit për mbrojtje që është i rëndësishëm për planifikimin, rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirës, sipas bazës përkatëse të konservimit-mbrojtës;
3. Vlerësimi i ndikimeve mbi të mirat e mbrojtura që mund të priten nga realizimi i planeve;
4. Kushtëzimi i interesit publik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social;
5. Ndryshimi i planeve, përkatësisht zgjidhjeve sipas planit që do të mund të kishin efekte të padëshirueshme potenciale mbi trashëgiminë kulturore;
6. Nxitja e zhvillimit dhe aplikimi i teknikave dhe materialeve tradicionale, të domosdoshme për ardhmërinë e trashëgimisë kulturore;
7. Bashkëpunimi ndërmjet organeve dhe shërbimeve publike kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore dhe për planifikimin hapësinor dhe urbanistik, në të gjitha fazat përgatitore, hartimin dhe procedurat për miratimin ose ndryshimin dhe plotësimin e planeve.

Raporti ndërmjet planeve dhe akteve për mbrojtje

Neni 70

(1) Me planin hapësinor dhe urbanistik nuk mund të ndryshohet statusi juridiko-mbrojtës dhe regjimi i mbrojtjes, e as kufiri i së mirës së mbrojtur dhe i kontakt zonës së saj, të caktuara me aktin për mbrojtje.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, me planin hapësinor që e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë mund të hiqet dorë nga kufijt e përcaktuar dhe regjimi i mbrojtjes, nëse kjo është në interes publik për rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirës.

(3) Në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni, plani paraqet bazë për harmonizimin e aktit për mbrojtje. Harmonizimi kryhet brenda tre muajsh pas miratimit të planit hapësinor.

(4) Nëse me mbrojtjen e të mirës së patundshme e cila me planin hapësinor urbanistik është paraparë të fitojë status të së mirës së mbrojtur, mund të miratohet nëse regjimi i mbrojtjes së kufijve të kontakt zonës të së mirës nuk është në kundërshtim me planin. Nëse akti për mbrojtje nuk miratohet brenda një viti nga dita e miratimit të planit, paraqitësi i planit mund të bëjë ndryshime të planit dhe të caktojë regjim tjetër të rregullimit dhe shfrytëzimit të hapësirës në të cilën gjendet ajo e mirë.

(5) Akti për mbrojtjen e të mirës së patundshme e cila nuk është lëndë e përfshirjes së planit hapësinor dhe urbanistik, me përjashtim të zbulimeve arkeologjike, mund të miratohet vetëm nëse me këtë nuk pengohet realizimi i planit.

Bazat e mbrojtjes-konservatorike

Neni 71

(1) Instalimi i regjimit përkatës për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore në planin hapësinor dhe urbanistik bëhet sipas bazave të mbrojtjes-konservatorike për trashëgiminë kulturore.

(2) Baza e mbrojtjes-konservatorike sipas këtij Ligji është baza e dokumentacionit për trajtimin e trashëgimisë së patundshme kulturore në planet hapësinoe dhe urbanistike.

(3) Bazat e mbrojtjes-konservatore përmbajnë përshkrim tekstual, grafik dhe dokumentar për të mira të mbrojtura dhe të patundshme të parapara për mbrojtje në rajonin e përfshirjes së planit, me të dhëna për të mirat, rrethin e drejpërdrejtë, qasjet dhe rajonin më të gjerë të ndikimit, relevant për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës dhe përmbajtjes së planit.

(4) Bazat e mbrojtjes-konservatorike hartohen sipas llojit të planit, me prioritete dhe mjete financiare të përcaktuara me programe vjetore dhe me programe shumëvjeçare për hartimin e bazave të konservimit-mbrojtës që i miraton ministri i Kulturës. Prioritet gjatë programimit kanë bazat e mbrojtjes-konservatorike, për planet e rajonit të përfshirë ku gjendet trashëgimia e patundshme kulturore e një rëndësie të veçantë, zona e rezervuar arkeologjike ose trashëgimia e patundshme kulturore në rrezik.

(5) Bazat e mbrojtjes-konservatorike i hartojnë institucionet kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore, nëse në raste të arsyeshme, Drejtoria nuk përcakton person tjetër juridik për hartimin e tyre, konform ligjit.

(6) Bazat e mbrojtjes-konservatorike i lejon dhe i vërteton Drejtoria.

(7) Për përpilimin e projektit të planit hapësinor dhe urbanistik mund të shfrytëzohen vetëm bazat e mbrojtjes-konservatorike për të cilat ka pëlqim dhe janë të vërtetuara.

(8) Ministria e Kulturës i përcakton përmbajtjen dhe metodologjinë e hartimit të bazave të mbrojtjes-konservatorike sipas mendimit paraprakisht të pranuar nga ministritë kompetente për punët e planifikimit hapësinor dhe rregullimit të hapësirës.

Harmonizimi i zgjidhjeve sipas planit

Neni 72

(1) Gjatë hartimit të projektit të planit hapësinor dhe urbanistik, hartuesi i planit detyrohet t'i repspektojë bazat e mbrojtjes-konservatore nga neni 71 i këtij Ligji.

(2) Nëse projekt-plani përmban zgjidhje sipas planit me të cilat hiqet dorë nga bazat e mbrojtjes-konservatorike, organi kompetent për këtë çështje detyrohet ta njoftojë paraqitësin e planit përmes pjesëmarrjes në debat publik përkatësisht përmes konsultimit profesional në lidhje me Projekt-planin.

(3) Pëlqim për propozim-planin hapësinor dhe urbanistik, në rastet kur pëlqimi i këtillë është i nevojshëm konform ligjit, mund të lëshohet nëse në propozim-planin është instaluar regjim përkatës për mbrojtje i caktuar sipas bazës së mbrojtjes-konservatorike paraprakisht të paraqitur, konform nenit 71 të këtij Ligji.

Projekte të veçanta urbanistike për të mirat e mbrojtura

Neni 73

(1) Për trashëgiminë e patundshme kulturore që ka rëndësi të veçantë hartohen projekte urbanistike, konform ligjit.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, projekt urbanistik mund të hartohet edhe për të mirë tjetër të patundshme e mbrojtur sipas dispozitave të këtij Ligji, nëse kjo është e përcaktuar me planin ose me kushtet e mbrojtjes-konservatore nga neni 74 i këtij Ligji.

(3) Pëlqim për projektet urbanistike nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij nen, jep ministria kompetente për punët rreth rregullimit të hapësirës, sipas mendimit paraprak të Drejtorisë.

Kushtet e mbrojtjes-konservatorike

Neni 74

(1) Kur nuk është i miratuar plani urbanistik, gjegjësisht akti i përgjithshëm konform ligjit, kushtet për ndërtimin e objektit me të cilin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë rrënohet integriteti i të mirës së mbrojtur, detyrimisht i përmbajnë kushtet e mbrojtjes-konservatorike.

(2) Me kushte të mbrojtjes-konservatorike sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të përcaktohet edhe:

1. Hartimi i projektit urbanistik;

2. Realizimi i gërmimeve dhe kërkimeve mbrojtëse arkeologjike;
3. Realizimi i konservimeve hulumtuese ;
4. Hartimi i studimeve të veçanta;
5. Ndërmarrja e masave tjera për mbrojtje.

(3) Kushtet e mbrojtjes-konservatorike i përcakton organi kompetent për kumtimin e kushteve për ndërtim, në afat të caktuar me ligj, sipas mendimit paraprakisht të pranuar nga Drejtoria.

(4) Shpenzimet për realizimin e kushteve të caktuara të mbrojtjes-konservatorike, përkatësisht masat për mbrojtje bien mbi barrë të investitorit.

(5) Dispozitat nga paragrafi (2) dhe (4) të këtij neni aplikohen edhe në rastet kur kushtet e mbrojtjes-konservatorike përcaktohen sipas planit urbanistik ekzistues.

Pëlqim dhe mendim mbrojtës-konservatorik

Neni 75

(1) Për shkak të vlerësimit të aplikueshmërisë konsekuente të kushteve të mbrojtjes-konservatorike, Drejtoria jep pëlqim për mbrojtje-konservatorike konform dokumentacionit të projektit dhe dokumentacionit tjetër teknik për trashëgiminë e patundshme kulturore të rëndësisë së veçantë.

(2) Për shkak të vlerësimit të aplikueshmërisë konsekuente të kushteve të mbrojtjes-konservatorike, Drejtoria jep mendim për mbrojtje-konservatorike të dokumentacionit të projektit dhe dokumentacionit tjetër teknik për të mira të patundshme të mbrojtura me status të ndryshueshëm nga ai në paragrafin 1 të këtij neni.

(3) Pëlqimi nga paragrafi (1) dhe mendimi nga paragrafi (2) i këtij neni lëshohet në bazë të kërkesës së investitorit, brenda 15 ditësh pas pranimit të kërkesës.

(4) Në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, Drejtoria mundet me vendim ta refuzojë kërkesën për dhënie e pëlqimit:

1. Nëse nuk janë kryer gërmimet mbrojtëse , hulumtimet e konservimit ose masat tjera mbrojtëse të përcaktuara konform nenit 74 paragrafi (2) të këtij Ligji;
2. Nëse dokumentacioni i dorëzuar nuk është i hartuar sipas kushteve të përcaktuara për mbrojtje-konservatorike.

Zhvendosja

Neni 76

(1) Trashëgimia e patundshme kulturore dhe të mirat tjera të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji, sikurse edhe pjesë të tyre, nuk guxojnë të zhvendosen në lokacion tjetër.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, zhvendosja mund të kryhet si masë për shpëtim, vetëm nëse për shkak të ndërtimit të objektit me interes publik nuk është e mundshme ruajtja e të mirës së rrezikuar në vendin në të cilin ndodhet.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, e mira e rrezikuar duhet të demontohet, të zhvendoset dhe përsëri të vendoset në një vend apo mjedis që përkujton në lokacionin burimor, përkatësisht në kontekst të ngjashëm natyror, historik ose artistik.

(4) Vendimin për zhvendosjen e trashëgimisë së patundshme kulturore që ka rëndësi të veçantë e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, sipas mendimit paraprakisht të marrë nga Këshilli nacional për trashëgimi kulturore.

(5) Zhvendosja e të mirave tjera të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji, mund të kryhet vetëm në bazë të pëlqimit paraprak nga Drejtoria.

Braktisja

Neni 77

(1) Trashëgimia e patundshme kulturore dhe të mirat tjera të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji, mund të braktisen tërësisht ose pjesërisht vetëm me përjashtime.

(2) Përjashtim, sipas paragrafit (1) të këtij neni llogaritet braktisja për shkak të ndërtimit të objektit me interes publik, nëse e mira e rrezikuar nuk zhvendoset konform nenit 76 të këtij Ligji, ndërkah në mënyrë tjetër nuk mund të ruhet në vendin ku ndodhet ose të ruhet pa e rrënuar integritetin e tij.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, e mira e rrezikuar mund të braktiset vetëm pas një hulumtimi dhe dokumentimi të plotë, dhe pas ndërmarrjes së masave të domosdoshme për shpëtim.

(4) Pëlqim për braktisje në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, jep organi që e ka miratuar aktin për mbrojtje.

(5) Pëlqimi nga paragrafi (4) i këtij neni, paraqet bazë për miratimin e aktit për ndryshimin ose për ndërprerjen e mbrojtjes.

Rrënimi

Neni 78

(1) Nëse trashëgimia e patundshme kulturore ose të mirat tjera të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji, apo një pjesë të tyre, janë të drobitura për shkak të vjetërsisë apo nga dëmtimet më të mëdha me të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikohet stabiliteti i tyre dhe për këtë shkak paraqesin rrezik për objektet në afërsi dhe për jetën e njerëzve, ndërkah, nëse ky rrezik nuk mund të shmanget në mënyrë tjetër, organi që e ka miratuar aktin për mbrojtje mund të japë pëlqim për rrënimin dhe largimin e kësaj të mire ose të ndonjë pjese të saj.

(2) Pëlqimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, lëshohet sipas kërkesës të organit kompetent për miratimin e vendimit për rrënimin e objekteve të drobitura.

(3) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, pëlqimi i lëshuar dhe vendimi për rrënimin e të mirës së mbrojtur nuk mund të paraqesë bazë për miratimin e aktit për ndërprerjen e mbrojtjes.

Kërkimi dhe eksploatimi i lëndëve të para minerale

Neni 79

(1) Në hapësirat në të cilat gjenden të mira të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji, nuk lejohet të bëhen hulumtime gjeologjike dhe eksploatim i lëndëve të para minerale.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse lënda e parë minerale ka rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të shtetit, dhe me këtë nuk rrezikohet ekzistenca e të mirës së mbrojtur ose nuk pengohet ruajtja, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i saj:

1. Kërkime gjeologjike mund të kryhen vetëm sipas pëlqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;

2. Eksploatimi i lëndës së parë minerale mund të kryhet vetëm sipas pëlqimit paraprak të Drejtorisë.

(3) Drejtoria lëshon pëlqim paraprak edhe:

1. Për ndërtimin e objekteve të xeheroreve në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni;

2. Për kërkime gjeologjike dhe eksploatimin e lëndëve të para minerale jasht kufijve të rajonit të mbrojtur, në largësi prej 500 metrash, nëse realizimi i punëve e inkuadron edhe shfrytëzimin e eksplozivit.

(4) Pëlqimi për hulumtime gjeologjike, pëlqimi për ndërtimin e objekteve të xeheroreve dhe pëlqimi për eksploatimin e lëndëve të para minerale, nuk mund të lëshohet pa harmonizim adekuat me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

Vendosja e firmave, reklamave, tabelave, afisheve dhe lajmërimeve tjera

Neni 80

(1) Në trashëgiminë e patundshme kulturore dhe në të mira tjera të patundshme, të mbrojtura sipas dispozitave të këtij Ligji, nuk lejohet të vendosen firma, reklama, tabela, afishe dhe lajmërime të tjera.

(2) Në raste të arsyeshme, veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni mund të kryhen vetëm me pëlqim paraprak të Drejtorisë.

Masa urgjente

Neni 81

(1) Nëse investuesi, realizimin e punëve e kryen në kundërshtim me projektin dhe dokumentacionin tjetër teknik për të cilin është lëshuar pëlqim për mbrojtje-konservatorike ose gjatë realizimit të punëve nuk iu përmbahet kushteve të mbrojtjes-konservatorike, Drejtoria mundet:

1. Ta njoftojë organin që e ka lëshuar lejen për ndërtim dhe të kërkojë nga inspeksioni i ndërtimtarisë ndërprerje të përkohshme të punëve, gjer në sigurimin e kushteve për realizimin e tyre të drejtë;

2. Në rast të rrezikimit të të mirës së mbrojtur mund të marrë vendim me të cilin do ta tërheq pëlqimin e lëshuar.

(2) Masa sipas paragrafit (1) të këtij neni, Drejtoria mund të ndërmarrë edhe në rastet nga neni 79 të këtij Ligji.

Seksioni 4

MBROJTJA E DREJTPËRDREJTË

Kërkime konservatorike

Neni 82

(1) Për përcaktimin dhe ekzekutimin e drejtë të masave të mbrojtjes të drejtpërdrejtë, për të mirat e tundshme dhe të patundshme të mbrojtura sipas dispozitave të këtij ligji, bëhen kërkime të domosdoshme konservatorike.

(2) Kërkime konservatorike, sipas paragrafit (1) të këtij neni, konsiderohen punët klërkimore lidhur me masat e mbrojtjes të drejtpërdrejtë dhe ekzistimin e mëtejshëm të të mirave të mbrojtura, të tundshme dhe të patundshme.

(3) Kërkimet konservatorike, që përfshijnë veprime cenimi të integritetit të të mirave të mbrojtura, me përjashtim të lëndëve arkivore, bëhen në bazë të lejes paraprake të Drejtorisë.

(4) Leje nga paragrafi (3) i këtij neni, mund të lëshohet nëse kërkesës i bashkangjitet:

1. Programi për kërkime konservatorike;
2. Dëshmi për mjetet e siguruar, financiare dhe teknike;
3. Deklaratë nga pronari ose, marrëveshje për rregullim të raporteve të ndërsjella, për kryerje të papenguar të kërkimeve, dhe

4. Dëshmi, se paraqitësi i kërkesës, i plotëson kushtet për kryerje të kërkimeve konservatorike.

(5) Me lejen nga paragrafi (3) i këtij neni, përcaktohen: bartësi, lloji, madhësia, afati dhe kushtet e posaçme për kryerjen e kërkimeve konservatorike.

(6) Kërkime konservatorike, kryejnë institucionet publike kompetente për mbrojtje, por mund të kryejnë edhe persona tjerë juridikë dhe fizikë, nëse i përmbushin kushtet e përcaktuara në aspekt të përgatitjes profesionale, përvojës së punës dhe, pajisjes teknike për kryerje të llojit përkatës të kërkimeve konservatorike.

(7) Ministri i Kulturës, i përcakton llojet e kërkimeve konservatorike, të cilat konsiderohen të domosdoshme sipas paragrafit (1) të këtij neni, llojin dhe përmbajtjen e dokumentacionit për kërkimet konservatorike dhe, i rregullon çështjet specifike në lidhje me metodologjinë e kërkimeve të llojet e veçanta, të disa lloje të trashigimisë kulturore të tundshme dhe të patundshme.

Masa juridike gjatë kërkimeve konservatorike

Neni 83

(1) Drejtoria, mundet që me Vendim:

1. Ta ndalojë çdo veprim, me të cilin bëhet e pamundur ose vështirësohet kryerja e kërkimeve të lejuara konservatorike;

2. Ta ndalojë përkohësisht kryerjen e kërkimeve konservatorike, nëse punët janë filluar pa leje ose, kryhen në kundërshtim me lejen e lëshuar, dhe të përcaktojë afatin për mënjanimin e mangësive;

3. Ta tërheqë lejen e lëshuar, nëse me kërkimet konservatorike dëmtohet ose rrezikohet e mira e mbrojtur.

Ankesa kundër Vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e ndalon ekzekutimin e Vendimit.

Paraqitja e raportit dhe dorëzimi i dokumentacionit për kërkimet konservatorike;

Neni 84

(1) Nëse kërkimet konservatorike, kryhen në suazat e projektit konservatorik, bartësi i lejes nga neni 82 paragrafi (3) i këtij ligji, është i obliguar të paraqesë raport dhe t'ia dorëzojë Drejtorisë dokumentacionin final për kërkimet konservatorike, në afat prej një muaji pas hartimit të projektit.

(2) Nëse kërkimet konservatorike nuk kryhen në suazat e projektit konservatorik, bartësi i lejes nga neni 82 paragrafi (3) i këtij ligji, është i obliguar:

1. Drejtorisë t'ia paraqesë raport, për kërkimet konservatorike, të kryera në afat prej tre muajsh, pas përfundimit të punëve kërkimore;

2. Drejtorisë, t'ia dorëzojë dokumentacionin final për kërkimet e kryera konservatorike, në afat prej gjashtë muajsh, pas përfundimit të punëve kërkimore;

(3) Raporti dhe dokumentacioni nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të shfrytëzohen gjatë hartimit të projekteve konservatorike.

Projekte konservatorike

Neni 85

(1) Projekt konservatorik, sipas këtij ligji, konsiderohet projekti për konservim, restaurim, rikonstruim, sanim, adaptim ose, masa tjera të mbrojtjes të drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore, të tundshme dhe të patundshme, ose pjesa përbërëse e tij.

(2) Gjatë hartimit të projektit konservatorik, për masën e mbrojtjes të drejtpërdrejtë, për të cilën nevojitet leje për ndërtim, zbatohen rregullat e përgjithshme për projektim të objekteve, nëse me këtë ligj ose dispozitë tjetër, nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Projekte konservatorike, hartohen në formë të projektit kryesor, nëse me këtë ligj ose dispozitë tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Projekti ideor hartohet doemos, nëse ripërtirja e të mirës të patundshme, e mbrojtur sipas dispozitave të këtij ligji, mbështetet në analogji ose supozime tjera.

(5) Ministria e Kulturës, mund të shpallë konkurs publik, për hartim të projekteve ideale për masa të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore të patundshme, me interes të posaçëm.

(6) Projekte konservatorike, hartojnë institucionet publike, kompetente për mbrojtje dhe Arkivi, por mund të hartojnë edhe persona tjerë juridikë dhe fizikë, nëse i përmbushin kushtet e përcaktuara për projektim konservatorik, për llojin përkatës të trashëgimisë kulturore.

(7) Ministri i Kulturës, i përcakton llojet dhe përmbajtjen e projekteve konservatorike, duke i përfshirë lëshimet e lejuara, kushtet për kryerje të projekteve konservatorike, dhe për kontroll profesional të projekteve konservatorike, standardet dhe normativet e posaçme për projektim konservatorik dhe i rregullon çështjet specifike në lidhje me metodologjinë e projektimit konservatorik.

Kontrolli profesional i projekteve konservatorike

Neni 86

(1) Çdo projekti konservatorik, i bëhet kontroll i domosdoshëm profesional.

(2) Kontrollin profesional nga paragrafi (1) i këtij neni, e bëjnë:

1. Enti kompetent nacional për mbrojtje, sipas llojit të trashëgimisë kulturore, nëse projekti konservatorik është hartuar nga person tjetër juridik ose fizik;

2. Enti amë kompetent për mbrojtje, nëse projekti konservatorik është hartuar nga institucion tjetër publik për mbrojtje;

3. Enti shkencor ose komisioni profesional, i përcaktuar me Vendim të Drejtorisë, nëse projekti konservatorik është hartuar nga institucioni kompetent amë, respektivisht institucioni nacional kompetent në veprimtarinë e mbrojtjes, ku nuk ka institucion kompetent.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, kontrollin profesional të projektit konservatorik për materialin arkivor, e bënë Arkivi.

(4) Për kontrollin e bërë profesional të projektit konservatorik, hartohet raport, me vlerësim për zgjidhjet projektuese dhe kompletimin e projektit.

(5) Bartësi i projektit konservatorik, është i obliguar të veprojë sipas vërejtjeve të përfshira në raportin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Shpenzimet për kontrollin profesional të projektit konservatorik, i paguan bartësi i projektit.

Leja konservatorike

Neni 87

(1) Masa për mbrojtje të drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore, të tundshme dhe të patundshme, me përjashtim të materialit arkivor, mund të merren vetëm në bazë të lejes paraprake nga Drejtoria (në tekstin e mëtejme: leje konservatorike), në qoftë se, me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Leje konservatorike, mund të lëshohet vetëm nëse kërkesës për lëshimin e saj i bashkangjitet:

1. Projekti konservatorik;

2. Raport për kontrollin e kryer profesional të projektit konservatorik;
3. Dëshmi për mjetet e siguruara financiare;
4. Dëshmi për kryerje të autorizuar të punëve të mbrojtjes të drejtpërdrejtë;
5. Deklaratë nga pronari ose marrëveshje me pronarin për rregullim të raporteve të ndërsjella, për kryerje të papenguar të punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë;

(3) Me lejen konservatorike, përcaktohet bartësi, lloji, madhësia, afati dhe kushtet e posaçme për kryerje të punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë.

(4) Leja konservatorike, lëshohet në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kërkesës për lëshimin e saj;

(5) Në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, Drejtoria mundet ta refuzojë kërkesën për lëshimin e lejes konservatorike;

1. Nëse projekti konservatorik, nuk është hartuar sipas përmbajtjes ose, standardeve dhe normativeve të përcaktuara, për llojin përkatës të trashëgimisë kulturore;

2. Nëse nuk është vepruar, sipas vërejtjeve nga raporti për kontrollin e kryer profesional të projektit konservatorik;

3. Nëse nuk janë përmbushur kushtet për kryerje të autorizuar të punëve të mbrojtjes të drejtpërdrejtë;

(6) Nëse për punët e parapara me projektin konservatorik, nevojitet leje për ndërtim, leja e tillë mund të lëshohet vetëm nëse paraprakisht është lëshuar leja konservatorike.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, për çdo leje të lëshuar për ndërtim, njoftohet Drejtoria.

Kryerja dhe manipulimi me punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë

Neni 88

(1) Punë të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të të mirave të tundshme dhe të patundshme, sipas dispozitave të këtij ligji, kryejnë institucionet publike kompetente për mbrojtje dhe Arkivi, por mund të kryej edhe:

1. Personi tjetër juridik, nga neni 153 i këtij ligji;

2. Personi fizik me status të konservatorit të autorizuar, për llojin përkatës të trashëgimisë kulturore, respektivisht specializim.

(2) Me kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë, mund të udhëheqë vetëm personi me status të konservatorit të autorizuar, për llojin përkatës të trashëgimisë kulturore, respektivisht specializim.

(3) Konservator i autorizuar sipas paragrafit (1), pika 2 dhe paragrafi (2) i këtij neni, konsiderohet:

1. Personi, i cili ka së paku arsimim sipëror nga profesioni përkatës, dhe posedon licencë për kryerje të punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë nga lëmia e arkitekturës, teknikave figurative ose llojit përkatës të trashëgimisë kulturore të tundshme (në tekstin e mëtejme: licencë konservatorike);

2. Personi me titull profesional shkencor ose, të zgjedhur, që është kompetent për kryerje të punëve të mbrojtjes të drejtpërdrejtë të llojit përkatës të trashëgimisë kulturore, respektivisht specializim.

(4) Licencë konservatorike nga paragrafi (3), pika 1 e këtij neni, lëshon Ministria e Kulturës, pas dhënies së provimit, para komisionit që e formon Ministria e Kulturës.

(5) Licencën konservatorike nga paragrafi (4) i këtij neni, Ministria e Kulturës do ta marrë, nëse bartësi i licencës:

1. I kryen punët në kundërshtim me lejen e lëshuar konservatorike ;

2. Nuk vepron sipas urdhërave të personit të autorizuar, për kryerje të mbikëqyrjes konservatorike;

3. Krijon dëme,ose shkakton rrezik për të mirat e mbrojtura;
4. I kryen punët në kundërshtim me metodologjinë e përcaktuar për punë; dhe
5. Vepron në kundërshtim me normat etike në lëminë e mbrojtjes.

(6) Institucioni kompetent publik për mbrojtje dhe Arkivi, munden tërësisht ose pjesërisht,që kryerjen e punëve të parashikuara me projektin konservatorik, t'ia lëshojnë kryerësit tjetër të autorizuar, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

(7) Persona të huaj, juridik dhe fizik, mund të marrin pjesë në realizimin e projektit konservatorik, në pajtim me marrëveshje ndërshtetërore ose, programin për bashkëpunim kulturor, si edhe konform marrëveshjes për bashkëpunim të drejtpërdrejtë, me institucion publik kompetent për mbrojtje, respektivisht Arkivin.

(8) Ministria e Kulturës, në raste posaçërisht të arsyeshme,mundet që realizimin e projektit konservatorik për trashëgimi kulturore me rëndësi të posaçme, t'ia besojë misionit ndërkombëtar ose, tjetër misioni të huaj të pavarur konservatorik.

(9) Gjatë kryerjes së punëve të mbrojtjes të drejtpërdrejtë, hartohet dokumentacion kryerës konservatorik.

(10) Ministri i Kulturës, i përcakton profesionet dhe titujt përkatës për konservator të autorizuar, sipas paragrafit (3) të këtij neni, mënyrën dhe programin e dhënies së provimit për marrjen e licencës konservatorike, formularin e licencës, punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë që mund t'i kryejnë persona tjerë profesional dhe kushtet për atë, llojin dhe përmbajtjen e dokumentacionit kryerës konservatorik, dhe punët tjera specifike lidhur me kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë.

Mbikëqyrje konservatorike

Neni 89

(1) Gjatë kryerjes së punëve të mbrojtjes të drejtpërdrejtë, bëhet mbikëqyrje profesionale e përhershme e domosdoshme (në tekstin e mëtejme: mbikëqyrje konservatorike).

(2) Mbikëqyrje konservatorike kryen;

1. Institucioni kompetent nacional, nëse punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë i kryen institucion tjetër për mbrojtje ose kryerës tjetër i autorizuar;

2. Institucioni amë kompetent për mbrojtje, nëse punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë i kryen institucioni publik kompetent për mbrojtje;

3. Komision profesional ose, persona të përcaktuar me Vendim të organit që e ka lëshuar lejen konservatorike, nëse punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë i kryen institucioni amë, respektivisht institucioni tjetër kompetent nacional për mbrojtje, në veprimtarinë për mbrojtje, ku nuk ekziston institucioni amë.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni,mbikëqyrjen konservatorike për materialin arkivor e bën Arkivi.

(4) Për kryerjen e mbikëqyrjes konservatorike, mund të përcaktohet vetëm personi me status të konservatorit të autorizuar për llojin përkatës të trashëgimisë kulturore, respektivisht specializimin.

(5) Shpenzimet për mbikëqyrjen konservatorike, i paguan bartësi i lejes konservatorike.

Ndalim i punëve realizuese dhe marrja e lejes konservatorike

Neni 90

(1) Drejtoria, me Vendim, mundet:

1. Të ndalojë përkohësisht, kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë, deri në sigurimin e kushteve për kryerjen e tyre të drejtë, nëse kryesi i punëve vepron në kundërshtim me lejen e lëshuar konservatorike, respektivisht projektin konservatorik, ose nuk i kryen urdhërat profesionale të komisionit, gjegjësisht personit të autorizuar për kryerje të mbikëqyrjes konservatorike;

2. Ta marrë lejen e lëshuar konservatorike, nëse me kryerjen e punëve dëmtohet ose shkaktohet rrezik për të mirën e mbrojtur.

(2) Me vendimet nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të urdhërohet marrja e masave përkatëse, për mbrojtje nga dëmtimi i mundshëm ose, shkatërrimi i të mirës së mbrojtur, për shkak të ndalimit të përkohshëm të punëve të filluara, respektivisht marrja e lejes konservatorike.

(3) Nëse punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë kanë filluar pa leje konservatorike, Drejtoria me Vendim, do ta ndërpresë ose ndalojë kryerjen e mëtejshme të punëve dhe, do të urdhërojë mënjanimin e mangësive, ose kthimin në gjendjen e mëparshme, në afat të përcaktuar.

(4) Nëse për punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë, është lëshuar leje për ndërtim, për Vendimin e marrur nga paragrafi (1), pika 1 dhe 2 të këtij neni, njoftohet organi që e ka lëshuar lejen për ndërtim dhe, inspekcioni kompetent ndërtimor. Inspeksioni ndërtimor njoftohet, edhe në rastin kur punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë kryhen pa lejen e duhur për ndërtim.

(5) Ankesa kundër Vendimit nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni, nuk e ndalon ekzekutimin e Vendimit.

Pranim i punëve të kryera

Neni 91

(1) Për shkak të kryerjes së kontrollit profesional përfundimtar, të punëve të kryera të mbrojtjes së drejtpërdrejtë (në tekstin e mëtejshëm: pranim i punëve të kryera), bartësi i lejes konservatorike është i obliguar, që në afat prej 30 ditësh nga mbarimi i punëve, ta njoftojë Drejtorinë dhe të dorëzojë:

1. Raport për punët e kryera të mbrojtjes të drejtpërdrejtë ;
2. Raport për mbikëqyrjen konservatorike;
3. Dokumentacion final konservatorik i realizuar.

(2) Pranimin e punëve të realizuara, e kryen komisioni profesional i formuar nga Drejtoria.

(3) Organi nga paragrafi (2) i këtij neni, mundet me Vendim, të përcaktojë, që pranimin e punëve të realizuara, ta kryejë institucion nacional për mbrojtje ose, institucion shkencor i cili nuk ka qenë i inkuadruar në hartimin dhe kontrollin profesional të projektit konservatorik, kryerjen e punëve dhe kryerjen e mbikëqyrjes konservatorike.

(4) Në komision profesional për pranimin e punëve të kryera, nuk mund të marrë pjesë personi, i cili ka qenë i inkuadruar në hartimin ose kontrollin profesional të projektit konservatorik, si edhe personi, i cili ka kryer punë të mbrojtjes së drejtpërdrejtë, ose ka kryer mbikëqyrje konservatorike.

(5) Me përjashtim, Drejtoria mundet me Vendim, të përcaktojë që pranimin e punëve të kryera, të llojeve të posaçme të trashëgimisë kulturore të tundshme, ose punët me vëllim më të vogël të trashëgimisë kulturore të patundshme, t'i kryejnë personat që kanë kryer mbikëqyrje konservatorike.

(6) Në procesverbalin për pranimin e kryer të punëve të realizuara, konstatohet nëse punët janë kryer sipas projektit konservatorik, me vlerësim profesional të cilësisë së punëve të kryera dhe, konstatimi i përpiktë për pranimin ose mospranimin e tyre.

(7) Nëse në procesverbalin për pranimin e punëve të kryera, janë konstatuar lëshime të caktuara nga projekti konservatorik, lëshime ose parregullëshmëri tjera gjatë kryerjes së punëve, ose janë dhënë vërejtje tjera për përmbajtjen profesionale dhe pranueshmërinë e punëve të kryera, Drejtoria, me Vendim do ta ngarkojë bartësin e lejes konservatorike, që në afat të caktuar, të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna dhe, t'i evitojë mangësitë e konstatuara, në llogari të vet.

(8) Nëse për punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë, është lëshuar leje për ndërtim, kontrolli teknik i së mirës të patundshme, sipas rregullave për ndërtim të objekteve, nuk mund të kryhet, nëse paraprakisht nuk është kryer pranimi i punëve të realizuara, konform këtij ligji.

(9) Në rastet nga paragrafi (8) i këtij neni, organit kompetent për kontroll teknik, i dorëzohet kopje e procesverbalit për pranim të punëve të kryera dhe, njoftim për Vendimin e marrur nga paragrafi (7) i këtij neni.

(10) Shpenzimet për pranimin e punëve të kryera, i paguan bartësi i lejes konservatorike.

Seksioni 5

MASA KONTROLLUESE DHE TË TJERA PËR TRASHËGIMINË E TUNDSHME KULTURORE

Kontrolli i prejardhjes

Neni 92

(1) Gjatë grumbullimit, ose kur në mënyrë tjetër nga personi i tretë sigurojnë trashëgimi kulturore të tundshme dhe, të mira tjera të mbrojtura, ose të tundshme, që meritojnë të jenë të mbrojtura sipas dispozitave të këtij ligji, institucionet për mbrojtje dhe poseduesit e tjerë të përmbledhjeve publike dhe private, janë të obliguar ta kontrollojnë prejardhjen e të mirave.

(2) Për çdo ofertë të dyshimtë për grumbullim, subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar që menjëherë ta njoftojnë Drejtorinë dhe organet e punëve të brendshme.

(3) Në libra të inventarit dhe libra tjera publike, për trashëgiminë e tundshme kulturore, mund të shënohen vetëm të mira, prejardhja e të cilave është kontrolluar, dhe për të cilat nuk ekziston dyshim se kanë prejardhje nga gjermime të palejuara ose të pakontrolluara, vjedhje, eksport dhe import i palejuar, ose nga veprime tjera kundërligjore.

Koleksione private

Neni 93

(1) Koleksionet private të trashëgimisë të tundshme kulturore, mbrohen sipas vëllimit dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(2) Lëndë e koleksionimit të koleksioneve nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk mund të jenë të mirat e mbrojtura, të cilat:

1. Janë me prejardhje vendore dhe të huaj, të fituara në mënyrën që është në kundërshtim me ligjin;

2. Janë përfshirë në koleksione publike, përveç atyre, ku këmbimi ose dhënia e përhershme e të cilave, është e lejuar sipas këtij ose, ligji tjetër;

3. Janë pjesë integrale e patundshmërisë së mbrojtur.

(3) Lëndë e koleksionimit të përmbledhjeve nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk mund të jenë lëndët arkeologjike, përveç atyre:

1. Që paraqesin zbulim të rastësishëm, nga të cilat Ministria e Kulturës ka hequr dorë, sipas nenit 68, paragrafi (3) i këtij ligji;

2. Për të cilat, e drejta pronësore është konstatuar në procedurë para gjyqit kompetent, të ngritur në afatet në të cilat, ekzistimi i të drejtës së tillë të sendeve arkeologjike në pronësi shoqërore, ka mundur të dëshmohet sipas rregullave të mëparshme.

(4) Drejtoria, mban evidencë të posaçme për koleksionarët dhe koleksionet e mbrojtura private.

Kontrolli i tregtisë me antikitet

Neni 94

(1) Çdo tregtar me antikitet, sende artistike ose sende tjera koleksionare, është i obliguar të mbajë regjistër për prejardhjen e sendeve, me të dhëna themelore për personin nga i cili është blerë sendi, përshkrimin dhe çmimin e shitjes, si edhe të dhëna për blerësin.

(2) Tregtari nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar:

1. Ta njoftojë institucionin publik kompetent për mbrojtje, për çdo send të siguruar, para lëshimit të tij në shitje, dhe të dorëzojë raporte mujore për shitjen e realizuar të antikiteteve, sendeve artistike dhe sendeve të tjera koleksionare;

2. Të sigurojë dokument për heqje dorë nga e drejta e blerjes me përparësi, nëse e mira e tundshme është e mbrojtur sipas dispozitave të këtij ligji;

3. Të tregojë dhe lëshojë dokument të rregullt për pronësinë e të mirës së mbrojtur;

4. Ta njoftojë blerësin për mundësinë e ndalimit të eksportit të së mirës së mbrojtur;

5. T'i njoftojë organet kompetente të Drejtorisë shtetërore dhe institucionet publike për mbrojtje, si dhe koleksionarët e interesuar, galeristët, auksionarët dhe antikuarët, për bërjen dhe qarkullimin e kopjeve të të mirave të mbrojtura.

(3) Ministri i Kulturës, i përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni, mënyrën e kryerjes së kontrollit mbi mbajtjen e regjistrit, formularët që përdoren sipas paragrafit (2) të këtij neni, dhe përafërsisht i rregullon çështjet specifike në lidhje me kontrollin e tregtisë me trashëgiminë kulturore të tundshme, dhe antikitetet tjera, sende artistike dhe sende koleksionesh. Akti i përgjithshëm miratohet pas mendimit të marrur paraprakisht nga ministria, kompetente për punët e tregtisë.

Këmbimi dhe heqja dorë

Neni 95

(1) Me qëllim të plotësimit të koleksioneve, ose realizimit të mbrojtjes efikase dhe prezentimit më të mirë, trashëgimia kulturore e tundshme dhe e mira tjetër e tundshme e mbrojtur, mund të këmbëhet, dhe përkohësisht ose përgjithmonë t'u jepet institucioneve publike për mbrojtje, dhe poseduesve tjerë të koleksioneve publike dhe private, në vend dhe jashtë, në qoftë se, me këtë ose me ligj tjetër, nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Këmbimi dhe dhënia, sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të kryhet në ekzemplarë të posaçme të të mirave të mbrojtura:

1. Nëse nuk janë shpallur ose, nuk janë përfshirë në koleksionet që janë shpallur si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë;

2. Që janë të serisë së njëjtë, tipit të njëjtë ose të ngjashëm, dhe janë në numër më të madh;

3. Për të cilat nuk ekziston interesim për inkuadrim në paraqitje të përhershme të poseduesit, ose për të kanë vetëm vlerë të dorës së dytë, respektivisht sekondare;

4. Për të cilat nuk ekzistojnë kufizime tjera të përcaktuara me ligj.

(3) Këmbimi dhe heqja dorë, sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, me përjashtim të materialit arkivor, mund të bëhet vetëm në bazë të lejes nga Drejtoria, pas pëlqimit paraprakisht të marrë nga institucioni amë kompetent për mbrojtje, respektivisht institucioni nacional në veprimtari për mbrojtje, ku nuk ka institucion amë.

(4) Këmbimi dhe dhënia e materialit arkivor bëhet sipas rregullave për material arkivor.

(5) Për këmbimin dhe dhënien të trashëgimisë kulturore të tundshme, në vend dhe jashtë, institucionet për mbrojtje nga paragrafi (3) i këtij neni, mbajnë kartotekë të kërkesave dhe ofertave.

(6) Në kartotekën nga paragrafi (5) i këtij neni, mund të futet edhe ofertë për këmbim ose dhënie, vetëm nëse e mira e mbrojtur është siguruar në pajtim me ligjin.

(7) Ofertës për këmbim ose dhënie i bashkëngjitet dokumentacioni i tërë, profesional dhe juridik, për të mirën e ofruar.

Çuarja në vend të huaj

Neni 96

(1) Trashëgimia e tundshme kulturore dhe e mira tjetër e tundshme e mbrojtur, mundet përkohësisht, të çohet në vend të huaj për ekspozim, konservim, ekspertizë dhe, në raste tjera të arsyeshme, në bazë të lejes, në qoftë se me këtë ose me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Leje, sipas paragrafit (1) të këtij neni, përveç për materialin arkivor, lëshon Drejtoria, pas pëlqimit paraprakisht, të marrur nga institucioni amë kompetent për mbrojtje, respektivisht institucioni nacional në veprimtari për mbrojtje, ku nuk ka institucion amë. Leja nga paragrafi (1) e këtij neni lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim, në të cilën do të theksohen shkaqet e arsyeshme për nxjerrjen e përkohshme të së mirës në botën e jashtme.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqitësi i kërkesës është i obliguar të sigurojë depozit bankar, në lartësi të vlerës të së mirës së mbrojtur, sigurim komercial, garanci ose lloj tjetër dorëzanie të qeverisë së huaj, nëse kjo kërkohet nga Drejtoria.

(4) Me Vërtetimin nga paragrafi (2) i këtij neni, përcaktohet afati i fundit për kthimin e të mirës së mbrojtur në vend, dhe mund të përcaktohen edhe kushte më të afërta për manipulim, paketim, transport, shoqërim, vendosje, ruajtje dhe prezentim i të mirës së mbrojtur.

(5) Bartësi i lejes për çuarje në vend të huaj, është i obliguar ta njoftojë Drejtorinë, nëse e mira e çuar është kthyer në vend në afatin e caktuar, dhe në çfarë gjendje ndodhet, më së voni tre ditë pas kthimit të të mirës në vend.

(6) Nëse e mira e çuar nuk është kthyer në vend në afatin e caktuar, sipas këtij ligji, konsiderohet se është eksportuar jolegalisht.

Eksporti

Neni 97

(1) Trashëgimia e tundshme kulturore, që nuk është nën regjimin e ndalesës së përgjithshme për eksport, sipas nenit 52 të këtij ligji, si edhe e mira tjetër e mbrojtur, mund të eksportohet vetëm në bazë të lejes nga Drejtoria, pas pëlqimit paraprakisht të marrur nga institucioni amë kompetent për mbrojtje, respektivisht institucioni nacional për mbrojtje në veprimtari për mbrojtje, ku nuk ka institucion amë.

(2) Leje për eksport, sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të lëshohet për të mirën e mbrojtur:

1. Që është lëndë e këmbimit ndërkombëtar, ose, që përgjithmonë i jepet poseduesit të koleksionit publik në vend të huaj;

2. Që nuk është futur në Inventarin nacional për të mira të mbrojtura, eksporti i të cilave do të paraqiste varfërim të konsiderueshëm të trashëgimisë kulturore në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: 3. Inventar nacional).

(3) Drejtoria, pas pëlqimit të marrur paraprakisht nga institucioni kompetent për mbrojtje, nga paragrafi 1 i këtij neni mundet:

1. Të marrë Vendim për ndalim të eksportit të të mirës së mbrojtur, e cila nuk është futur në Inventarin nacional nga paragrafi (2), pika 2 e këtij neni;

2. Të lëshojë vërtetim për eksport të të mirës të mbrojtur nga Inventari nacional, nga paragrafi (2) pika 2 e këtij neni, nëse e mira përkatëse është lëndë e kërkesës restituese, ose eksporti i saj është me interes publik, në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare.

(4) Antikitete dhe sende artistike dhe sende tjera koleksionesh, që nuk kanë status të të mirave të mbrojtura, sipas dispozitave të këtij ligji, eksportimi i të cilave nuk është nën regjimin e eksportit të lirë sipas rregullave për veprimtari të jashtme tregtare, mund të eksportohen në bazë të vërtetimit që e lëshon Drejtoria, pas pëlqimit paraprakisht të marrur nga institucioni publik, kompetent për mbrojtje.

(5) Me vërtetimin nga paragrafi (4) i këtij neni, verifikohet se e mira e tundshme që është lëndë e eksportit, nuk është e shënuar në Regjistrin nacional për trashëgimi kulturore, dhe se mund të eksportohet pa kufizime, në bazë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

(6) Nëse e mira e mbrojtur nga paragrafi (4) i këtij neni, meriton të jetë e mbrojtur, Drejtoria mund të marrë Vendim për ndalim të eksportit, në qoftë se para kësaj merr Vendim për mbrojtje të përkohshme.

(7) Dispozitat nga paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e çuarjes në vend të huaj.

(8) Drejtoria, është e obliguar që ta njoftojë opinionin për trashëgiminë e tundshme kulturore:

1. Eksporti i së cilës, është i ndaluar sipas nenit 52 të këtij Ligji,
2. Për të mirat e mbrojtura nga Inventari nacional, nga paragrafi (2) pika 2 e këtij neni,
3. Për çdo Vendim të marrur për ndalim të eksportit të të mirës së mbrojtur.

Njoftimi i organit doganor

Neni 98

(1) Për çdo Vendim të marrur për ndalim të eksportit ose, lejes të lëshuar, respektivisht vërtetimin për nxjerrje ose eksport, Drejtoria është e obliguar që pa shtyrje ta njoftojë organin kompetent për punët e kontrollit doganor.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, bashkë me aktin e lëshuar, te organi doganor dorëzohet edhe dosja complete me fotodokumentacion për të mirën e tundshme, nxjerrja ose eksporti i së cilës lejohet, gjegjësisht ndalohet.

(3) Te organi nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohen edhe lista të azhuruara për trashëgiminë e tundshme kulturore, eksporti i së cilave është i ndaluar sipas nenit 52 të këtij ligji, dhe për të mirat e mbrojtura nga Inventari nacional nga neni 97, paragrafi (2), pika 2 e këtij ligji.

Importi

Neni 99

(1) Trashëgimia e tundshme kulturore, që nuk është nën regjimin e ndalesës së përgjithshme për import, sipas nenit 53 të këtij ligji, mund të importohet në formë importi, konform rregullave për veprimtari të jashtme tregtare.

(2) Nëse, sipas rregullave të vendit nga i cili importohet trashëgimia e tundshme kulturore, nevojitet leje eksportuese, gjatë importit është e domosdoshme që ajo leje të tregohet.

(3) Importuesi është i obliguar t'ia paraqesë të mirën e importuar, institucionit kompetent për mbrojtje, në afat prej 8 ditësh nga dita e importit të realizuar.

Restituimi

Neni 100

(1) Konform marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, Ministria e Kulturës caktohet si organ qendror për koordinimin e kthimit të trashëgimisë kulturore të tundshme.

1. Që është vjedhur dhe/ose, eksportuar jolegalisht nga territori i Republikës;
2. Që është vjedhur dhe/ose, eksportuar jolegalisht nga territori i shtetit tjetër, e që ndodhet në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Në rastet nga paragrafi (1), pika 1 e këtij neni, Ministria e Kulturës:

1. Ndërmerr aktivitete për kompletimin e të dhënave, evidentimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të dispersuar në vend të huaj, që mund të jetë lëndë e restitimit.
2. Paraqet kërkesa restituese te organet kompetente të shteteve tjera, konform rregullave të tyre dhe marrëveshjeve ndërkombëtare;
3. Realizon bashkëpunim me organet qendrore të shteteve tjera, për koordinim të restitimit.

(3) Në rastijn nga paragrafi (1), pika 2 e këtij neni, Ministria e Kulturës:

1. E njofton organin qendror për koordinim të restituimit të shtetit të prejdardhjes, se e mira e mbrojtur ndodhet në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe ndërmerr aktivitete plotësuese, me kërkesë të tij, për identifikim më preciz të vendit ku ndodhet e mira, dhe për pronarin e saj, gjegjësisht mbajtësin;

2. Mundëson kontrollime të domosdoshme për të mirën e kërkuar, nga ana e personave të autorizuar të vendit kërkuar, në afat prej dy muajsh, pas paraqitjes së kërkesës për restituim;

3. Ndërmerr masa, për mbrojtje fizike të të mirës së kërkuar, në bashkëpunim me vendin kërkuar;

4. Ndërmerr masa, për ndalim të veprimeve me të cilat evitohet ose pengohet procedura për restituim, respektivisht kthim;

5. Ndërmjetëson ndërmjet paraqitësit të kërkesës për restituim dhe pronarit, gjegjësisht mbajtësit të të mirës së kërkuar;

6. E lehtëson ekzekutimin e Vendimit gjyqësor, për kthimin e të mirës së kërkuar.

(4) Kërkesë për restituim, në rastet nga paragrafi (1), pika 2 e këtij neni, mund të paraqitet në mënyrë diplomatike, ose drejtëpërdrejt në Gjyqin kompetent, nëse me ligj ose marrëveshje ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe.

(5) Kërkesa restituuese, sipas paragrafit (4) të këtij neni, mund të paraqitet në afat prej një viti, llogaritur nga dita kur vendi kërkuar ka kuptuar, gjegjësisht ka qenë i njoftuar për vendin ku gjendet e mira në fjalë dhe për identitetin e pronarit të saj, por jo më gjatë se:

1. 30 vjet nga dita kur e mira e kërkuar ka qenë e vjedhur, gjegjësisht eksportuar jolegalisht nga territori i shtetit prej nga e ka prejdardhjen;

2. 75 vjet, nëse bëhet fjalë për të mirë të tundshme, që është pjesë e koleksionit publik, ose është nën mbrojtje të posaçme të shtetit, prej nga e ka prejdardhjen.

(6) Nëse organi kompetent i shtetit të prejdardhjes të së mirës, me ankesë kundër poseduesit, para gjyqit kompetent të Republikës së Maqedonisë ka ngritur procedurë për restituim, gjegjësisht kthim të të mirës, është i obliguar që për atë, ta njoftojë menjëherë Ministrinë e Kulturës.

(7) Procedurë, sipas paragrafit 6 të këtij neni, mund të ngritet, nëse ekzistojnë dëshmi se e mira në fjalë, ka status të të mirës së mbrojtur, sipas rregullave të shtetit, i cili e kërkon kthimin e saj, dhe se ka qenë e vjedhur dhe/ose eksportuar jolegalisht nga territori i tij.

(8) Procedurë për restituim, gjegjësisht kthim, nuk mund të ngritet nëse, eksporti nuk është më jolegal, në kohën kur është kërkuar kthimi i të mirës.

(9) Pronari i ndërgjegjshëm, i cili të mirën e kërkuar e ka fituar pasi ajo të ketë qenë e vjedhur, dhe/ose eksportuar jolegalisht, ka të drejtë në kompensim të drejtë, në bazë dhe në lartësi të përcaktuar me Vendim të gjyqit kompetent, dhe pasi e mira të jetë kthyer në territorin e shtetit të prejdardhjes.

(10) Kompensimin, nga paragrafi 9 i këtij neni, dhe të gjitha shpenzimet në lidhje me kërkesën dhe procedurën për restituim, i paguan shteti kërkuar.

(11) Kompensimi dhe shpenzimet nga paragrafi (10) i këtij neni, të paguara nga llogaria e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, kompensohen nga personat të cilat e kanë vjedhur të mirën, respektivisht e kanë eksportuar ilegalisht nga territori i Republikës.

Seksioni 6

MBROJTJA E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE KULTURORE

Shënime (Regjistra), kujdesje dhe përdorim

Neni 101

(1) Mbrojtja e trashëgimisë kulturore shpirtërore, sipas këtij ligji, përveç bërjes dhe ruajtjes të shënimeve (regjistrave) për të, përfshin edhe kujdesje dhe përdorim të rregullt, konform me ligjin dhe regjimin për mbrojtje, të përcaktuar me aktin për mbrojtje.

(2) Bërjen dhe ruajtjen e shënimeve (regjistrave), për trashëgiminë kulturore shpirtërore me interes publik, e kryejnë subjektet e autorizuar nga neni 154 i këtij ligji.

(3) Përkujdesja dhe përdorimi i rregullt i trashëgimisë kulturore shpirtërore, nxiten përmes projekteve dhe programeve të posaçme, nga lëmi i kulturës, arsimit, shkencës dhe informimit.

(4) Drejtoria, me Vendim mundet:

1. Të përcaktojë masa të posaçme për përkujdesje dhe përdorim të rregullt të të mirës jomateriale të mbrojtur;

2. Ta ndërpresë ose ndalojë përkohësisht përdorimin joadekuat të të mirës jomateriale të mbrojtur.

Seksioni 7

MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NGA VEPRIME JOLIGJORE

Masa të sigurimit

Neni 102

(1) Për realizimin e mbrojtjes efikase nga gërmimet e palejuara, dëmtimet dhe shkatërrimit me qëllim, vjedhjet, përvetësimet, fshehjet, tregtitë e palejueshme, kontrabandat dhe veprimet tjera joligjore kundër trashëgimisë kulturore, organet dhe institucionet publike për mbrojtje, si edhe poseduesit e të mirave të mbrojtura, janë të obliguar të ndërmarrin:

1. Masa preventuese, me të cilat do të zvogëlohen mundësitë për paraqitje të rrezikut nga veprimet joligjore;

2. Masa kundërveprimi, me të cilat do të zvogëlohen humbjet ose pasojat e dëmshme nga veprimet joligjore, nëse rreziku realizohet.

(2) Drejtoria, sipas paragrafit (1) të këtij neni:

1. E përcjell gjendjen e mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore;

2. Bën vlerësim sigurues të rreziqeve, nga veprimet joligjore kundër trashëgimisë kulturore;

3. E koordinon përpilimin dhe harmonizimin e planeve nga neni 104 të këtij ligji dhe e kontrollon zbatimin e tyre;

4. Përcakton masa urgjente, të mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore në rrezik dhe masa të posaçme të mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore, me rëndësi të posaçme;

5. Jep udhëzime profesionale për zbatimin e mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore;

6. Propozon marrje të masave të mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore;

7. Kryen punë tjera, të përcaktuara me këtë ose me ligj tjetër.

(3) Drejtoria, dhe subjektet tjera nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar të bashkëpunojnë me organet tjera kompetente, nga lëmia e sigurisë dhe të mundësojnë veprim të tyre të papenguar, posaçërisht ta lehtësojnë veprimin e organeve kompetente për pengimin e kryerjes të akteve penale, zbulimin dhe kapjen e kryerësve, dhe dorëzimin e tyre te organet kompetente, konfiskimin e të mirave të mbrojtura, dhe kthimin e tyre te poseduesi.

Plani aksional nacional për prevencën e kriminalitetit kundër trashëgimisë kulturore

Neni 103

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, miraton Plan aksional nacional, për prevencë të kriminalitetit kundër trashëgimisë kulturore, me propozim të Këshillit Nacional për trashëgimi kulturore.

(2) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni, veçanërisht përmban:

1. Vlerësim, për rreziqet ekzistuese nga veprimet joligjore dhe gjendjen me kriminalitetin kundër trashëgimisë kulturore;

2. Prioritete të politikës për mbrojtje siguruese të trashëgimisë kulturore;
 3. Masa të përgjithshme dhe të posaçme, për prevencë të kriminalitetit kundër trashëgimisë kulturore;
 4. Periudhën, për të cilën miratohet Planit dhe, dinamikën e realizimit të tij;
 5. Kushtet për realizimin e Planit;
 6. Subjektet përgjegjëse për zbatimin e Planit.
- (3) Realizimin e Planit nga paragrafi (1) i këtij neni, e koordinon Këshilli Nacional për trashëgimi kulturore.
- (4) Këshilli Nacional për trashëgimi kulturore, i paraqet Qeverisë raporte vjetore për realizimin e Planit, si dhe raport përfundimtar.

Plane për mbrojtje siguruese të trashëgimisë kulturore

Neni 104

- (1) Institucionet publike për mbrojtje, dhe poseduesit e të mirave të mbrojtura, për të cilat ajo është përcaktuar me aktin për mbrojtje, janë të obliguar të miratojnë:
1. Plan për mbrojtje preventuese, të trashëgimisë kulturore nga veprimet joligjore;
 2. Plan për aksion urgjent, në rast të veprimeve joligjore.
- (2) Planit, për mbrojtje preventuese nga paragrafi (1), pika 1 e këtij neni, përmban masa të organizimit dhe të sigurimit teknik, ndërsa për trashëgiminë kulturore me rëndësi të posaçme, edhe masa të mbikëqyrjes elektronike.
- (3) Planit për aksion urgjent, nga paragrafi (1), pika 2 e këtij neni, përmban pjesë operative dhe organizative, me masa kundërveprimi.
- (4) Planet, nga paragrafi (1) i këtij neni, përpilohen në bazë të analizave të kryera paraprakisht, të rreziqeve nga veprimet kundërligjore.
- (5) Me qëllim që të vlerësohet, nëse niveli i sigurisë është përkatës për shkallën e rrezikut ekzistues dhe, të përcaktohet nëse rreziku është i pranueshëm, persona zyrtarë të autorizuar të Drejtorisë, kryejnë kontroll të efikasitetit të masave të mbrojtjes siguruese, të përfshira në planet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Persona zyrtarë të autorizuar për siguri të trashëgimisë kulturore

Neni 105

- (1) Punët e mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore, nga neni 102, paragrafi (2) i këtij ligji, i kryejnë persona zyrtarë të autorizuar, për siguri të trashëgimisë kulturore, të cilët i emëron ministri i Kulturës.
- (2) Personat zyrtarë të autorizuar, nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë të drejtë dhe obligim:
1. Të mbledhin të dhëna, njoftime dhe informata, me rëndësi për mbrojtjen siguruese të trashëgimisë kulturore;
 2. Ta kontrollojnë zbatimin e masave të përcaktuara të mbrojtjes siguruese të trashëgimisë kulturore;
 3. Të bëjnë shikime për mbrojtjen siguruese të trashëgimisë kulturore;
 4. Të bashkëpunojnë me policinë kriminalistike, organet doganore, prokuroritë publike, organet dhe shërbimet kompetente inspektuese dhe tjera.
- (3) Personat zyrtarë të autorizuar, nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë legjitimacion:
- (4) Ministri i Kulturës, e rregullon realizimin e punëve nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni, gjegjësisht neni 102, paragrafi (2) i këtij ligji, dhe e përcakton formularin e legjitimacionit dhe mënyrën e lëshimit të tij.

Seksioni 8

**MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË RASTET E KONFLIKTIT TË
ARMATOSUR DHE FATKEQËSIVE NATYRORE**

**Identifikimi i të mirave dhe personave zyrtarë për mbrojtje në rastet e konfliktit të
armatosur**

Neni 106

(1) Për lehtësimin e identifikimit, të të mirave të tundshme dhe të patundshme, të cilat gëzojnë imunitet të mbrojtjes së përgjithshme, në rast të konfliktit të armatosur, konform Marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, Drejtoria mban Inventar nacional për të mirat e mbrojtura, në rast të konfliktit të armatosur.

(2) Personat zyrtarë, të angazhuar për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, në rast të konfliktit të armatosur dhe personat e ngarkuar për kontroll, sipas Marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, kanë legjitimacion dhe të drejtë të mbajnë pëlhurë të lidhur në mëngë, me aplikim të shenjës ndërkombëtare për njohje, të lëshuara nga Ministria e Kulturës.

(3) Ministri i Kulturës, i përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së inventarit nga paragrafi (1) i këtij neni, formularin e legjitimacionit, dukjen e pëlhurës lidhëse nga paragrafi (2) i këtij neni, dhe mënyrën e lëshimit të tyre.

**Masa përgatitore për mbrojtje në rast të konfliktit
të armatosur dhe, fatkeqësive natyrore**

Neni 107

(1) Organet dhe institucionet publike për mbrojtje, si dhe poseduesit e të mirave të mbrojtura, janë të obliguar, të ndërmarrin masa të domosdoshme përgatitore, për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, nga pasoja të parashikuara të konflikteve të armatosura dhe fatkeqësive natyrore.

(2) Masa të domosdoshme përgatitore, sipas paragrafit (1) të këtij neni, konsiderohen sidomos:

1. Sigurimi i dokumentacionit të të mirave të mbrojtura dhe ruajtja e tyre në vende të ndryshme dhe të sigurta;
2. Përgatitje për evakuim, të të mirave të mbrojtura të tundshme, duke i përfshirë edhe pjesët përbërëse të të mirave të mbrojtura të patundshme, të parapara për çmontim;
3. Planifikimi i masave urgjente për mbrojtje nga zjarri;
4. Planifikimi i masave urgjente për mbrojtje nga rrënimi;
5. Sigurimi i materialeve dhe pajisjeve për zbatimin e mbrojtjes përkatëse IN CITY.
6. Përcaktimi i personelit për mbrojtje, posaçërisht të ekipeve profesionale dhe ekipeve tjera operative.
7. Planifikimi i masave të mbrojtjes siguruese, në rast të konfliktit të armatosur dhe, fatkeqësive natyrore.

(3) Masa të domosdoshme përgatitore, sipas paragrafit (1) të këtij neni, konsiderohen edhe përgatitjet për kohë paqeje:

1. Për shënimin e të mirave të mbrojtura me shenjën ndërkombëtare për njohje;
2. Për organizimin e transportit të posaçëm ose urgjent, të të mirave të mbrojtura, nën kontrollin ndërkombëtar, në territorin e Republikës së Maqedonisë, ose në shtet tjetër.

(4) Drejtoria, sipas paragrafit (1) të këtij neni:

1. E përcjell, drejton dhe kontrollon zbatimin e masave të domosdoshme përgatitore, nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni;
2. Ndërmerr dhe përcakton masa përgatitëse urgjente dhe të tjera për mbrojtje;
3. Jepë udhëzime profesionale për zbatimin e masave përgatitore për mbrojtje;

4. Kryen punë të tjera, të përcaktuara me ligj.

(5) Masat e domosdoshme përgatitore për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, në rast të konfliktit të armatosur dhe fatkeqësive natyrore, ndërmerren në pajtim me rregullat dhe dokumentet për mbrojtje, respektivisht ruajtje nga fatkeqësitë elementare, me këtë ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të tij.

Masa të posaçme mbrojtëse në gjendje ushtarake dhe gjendje të jashtëzakonshme

Neni 108

(1) Institucionet publike për mbrojtje, të përcaktuara konform rregullave për mbrojtje, dhe poseduesit e të mirave të mbrojtura, janë të obliguar, që në gjendje ushtarake dhe të jashtëzakonshme, të shpallura për shkak të ndodhjes së fatkeqësive të mëdha natyrore, të ndërmarrin masa të posaçme për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

(2) Masat e posaçme të mbrojtjes, sipas paragrafit (1) të këtij neni, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me Rregullore.

Vlerësimi i dëmit

Neni 109

Vlerësimi i dëmit të trashëgimisë kulturore, i shkaktuar gjatë kohës dhe si pasojë e konfliktit ushtarak ose fatkeqësisë natyrore, bëhet sipas metodologjisë së posaçme, që e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Lista prioritare

Neni 110

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përcakton Listë prioritare të trashëgimisë kulturore, që ka pësuar në konflikt të armatosur, gjegjësisht fatkeqësi natyrore, me propozim të Këshillit Nacional për trashëgimi kulturore.

(2) Lista prioritare nga paragrafi (1) i këtij neni, është bazë e domosdoshme për:

1. Përcaktimin dhe zbatimin e masave urgjente për mënjanimin ose zvogëlimin e pasojave nga dëmi i shkaktuar;

2. Programimin e aktiviteteve për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, pas ndërprerjes së armiqësive, gjegjësisht fatkeqësisë natyrore;

3. Aprovimin e mjeteve financiare, dhe ndihmë tjetër në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Seksioni 9

MBROJTJA NGA DËMTIMI FIZIK, E PËRSHPEJTUAR NGA NDOTJA DHE PËRPARIM I CILËSISË TË MJEDISIT JETËSOR NË RAJONET E MBROJTURA

Mbrojtja nga pasojat e ndotjes

Neni 111

(1) Për zvogëlimin e rreziqeve nga dëmtimet fizike dhe pasojat tjera të dëmshme ndaj trashëgimisë kulturore të patundshme dhe ambientit të saj të drejtpërdrejtë, të përshpejtuara nga ndotja e mjedisit jetësor dhe natyrës:

1. Subjektet, të cilat bëjnë monitoring sipas rregullave të mbrojtjes të mjedisit jetësor dhe natyrës, janë të obliguar ta përcjellin ndikimin e ndotjes në trashëgiminë kulturore të patundshme dhe ambientit të saj të drejtpërdrejtë, si dhe t'i dorëzojnë të dhënat relevante te ministrinë kompetente për kryerje të monitoringut të posaçëm konservatorik dhe monitoringut qendror ekologjik;

2. Ministrinë, kompetente për punët e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës, të Shkencës dhe Kulturës, si dhe organet kompetente të njësive të vetadministrimit lokal, janë të obliguara të inicojnë dhe mbështesin realizimin e programeve dhe projekteve për kërkime interdisiplinare dhe kërkime tjera shkencore profesionale, qëllimi i të cilave është identifikimi dhe studimi i pasojave të dëmshme nga ndotja, definimi i mjeteve dhe metodave për zvogëlimin ose eliminimin e pasojave të tilla;

3. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë burime që bëjnë ndotje me pasoja të dëmshme në trashëgiminë kulturore të patundshme dhe në ambientin e saj të drejtpërdrejtë, janë të obliguar që në studimin e tyre për vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor, të përcaktojnë masa përkatëse për zvogëlim të pasojave të tilla, por edhe t'i zbatojnë ato masa në afatin ligjor për realizimin e projekteve.

4. Vendim, për ndalim dhe kontroll të integruar të ndotjes, sipas rregullave për mbrojtje të mjedisit jetësor, natyrës dhe planifikimit hapësinor, në bazë të studimit nga pika 3 e këtij paragrafi, mund të merret pas pëlqimit, të marrur paraprakisht nga Drejtoria.

(2) Drejtoria :

1. Kryen dhe organizon kryerjen e monitoringut konservatorik, për ndikimin e ndotjes në trashëgiminë kulturore të patundshme dhe ambientin e saj të drejtpërdrejtë;

2. Ndërmerr masa urgjente për mbrojtje, nëse akti për shpalljen e trashëgimisë kulturore në rrezik, është miratuar për shkak të ndotjes.

(3) Metodologjinë dhe mënyrën e kryerjes së monitoringut të posaçëm konservatorik, e përcakton Ministria e Kulturës, me pëlqim të ministrisë kompetente për punët e mbrojtjes së mjedisit jetësor, natyrës dhe planifikimit hapësinor.

Avancimi i cilësisë të mjedisit jetësor në zonat e mbrojtura

Neni 112

(1) Njësitë e vetadministrimit lokal, institucionet publike kompetente për mbrojtjen dhe poseduesit e të mirave të mbrojtura janë të detyruar të ndërmarrin masa për mbrojtjen dhe avancimin e cilësisë të mjedisit jetësor në zonat e trashëgimisë të patundshme kulturore, si dhe në kufijtë e tërësive të monumenteve dhe rajoneve kulturore.

(2) Njësitë e vetadministrimit lokal ndërmarrin masa, sipas paragrafit (1) të këtij neni, për lokalet e hapura publike të qytetit, ato rurale dhe lokaleve tjera publike në zonat e mbrojtura, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Për trashëgiminë kulturore të patundshme që gjendet në kufijtë e parkut nacional ose territor tjetër të shpallur si trashëgimi natyror, si dhe në zona me dedikim të veçantë, të përcaktuara ose të mbrojtura sipas ndonjë ligjit tjetër, masat nga paragrafi (1) të këtij neni merren në pajtim me regjimin e përcaktuar për mbrojtje dhe planet për administrim me rajone të tilla, gjegjësisht zona.

(4) Institucionet kompetente publike për mbrojtje marrin masa sipas paragrafit 1 të këtij neni, në kuadër të programeve për revitalizimin dhe projekteve të konservimit që i realizojnë.

(5) Pranimi i punëve konservatorike sipas nenit 91 të këtij ligji dhe kontrollit teknik sipas rregullave për ndërtimin e objekteve nuk mund të bëhet, nëse realizuesi i punëve, gjegjësisht investuesi nuk i ka kryer në tërësi masat sipas paragrafit (1) të këtij neni të përcaktuara me kushtet mbrojtëse–konservatorike dhe kushteve tjera për ndërtim në territorin e mbrojtur.

(6) Drejtoria mundet me vendim të caktojë masa të veçanta sipas paragarfit (1) të këtij neni sipas mendimit paraprak të siguruar nga ministrinë kompetente për çështjet e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit jetësor si dhe për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës:

1. Për shkak të sigurimit të qasjes më të mirë, joshjes dhe humanizimit të hapësirës, stimulimit të niveleve adekuatë të shfrytëzimit dhe zmadhimit të integritetit social të territoreve të mbrojtura;

2. Nëse për shkak të mospërkujdesit është prishur integriteti i territorit të mbrojtur.

Seksioni 10

ZHVILLIMI I VETËDIJËS MBROJTËSE DHE MASA TJERA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Zhvillimi i vetëdijes së opinionit

Neni 113

(1) Institucionet publike në lëmin e edukimit, arsimit, shkencës, kulturës dhe informimit janë të detyruara, në planet dhe programet e tyre për punë, të parashohin përmbajtje për përfitim të njohurive dhe ndërtimin e marrëdhënies së drejtë dhe aktive ndaj trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjes së saj, veçanërisht:

1. Për vlerat, veçanësinë dhe domethënien e trashëgimisë kulturore si pjesë përbërëse e identitetit kulturor dhe burim i inspirimit dhe kreativitetit për gjeneratat e tanishme dhe të ardhme;

2. Për rreziqet në të cilat nënshtrohet, qoftë për shkak të veprimeve joligjore, konfliktit të armatosur, fatkeqësive natyrore dhe shkatërrimit fizik të përshpejtuar nga ndotja e natyrës dhe mjedisit jetësor, qoftë për shkak ndërtimit investues, shfrytëzimit joadekuat ose përdorimit dhe sjelljes së pandërgjegjshme;

3. Për nevojën e ruajtjes së saj, respektit, mirëmbajtjes së rregullt, konservimit, mbrojtjes integruese dhe shfrytëzimit funksional si faktor i zhvillimit të mirëmbajtjes.

(2) Drejtoria është e obliguar:

1. Ta zgjerojë dhe nxit njohjen e rregullave nacionale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

2. Ta informojë opinionin për ndihmën ndërkombëtare dhe për rolin që atë ndihmë e ka luajtur në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

3. Të përkujdeset për dhënien e publicitetit të secilit rast të dëmtimit, shkatërrimit ose formë tjetër të veprimit joligjor kundër trashëgimisë kulturore.

(3) Institucionet publike për mbrojtje janë të detyruar ta informojnë opinionin:

1. Për aktivitetet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore që i ndërmarrin;

2. Për mundësitë e inkuadrimit të subjekteve tjera në realizimin e programeve dhe projekteve nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore që i udhëheqin ato.

Qasja e trashëgimisë kulturore në opinion

Neni 114

(1) Trashëgimia kulturore dhe dokumentacioni për mbrojtjen e saj kanë qasje për opinionin.

(2) Qasja për opinion mund të kufizohet në pajtim me këtë ligj, dispozitë dhe akt tjetër të përgjithshëm, varësisht nga lloji, rëndësia, gjendja dhe natyra e trashëgimisë kulturore, si dhe nga qëllimet dhe mënyra e shfrytëzimit.

(3) Drejtoria me vendim mund të ofrojë marrjen e masave të veçanta për sigurimin e qasjes së trashëgimisë kulturore për personat e hendikepuar.

Sistemi informativ

Neni 115

(1) Përcjellja e gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe e aktiviteteve për mbrojtjen e saj i bën Drejtoria në kuadër të Sistemit informativ për trashëgimi kulturore të Republikës së Maqedonisë.

(2) Me sistemin informativ nga paragrafi (1) i këtij neni sigurohet veçanërisht:

1. Vendosja e bazës së të dhënave relevante;
2. Lidhje qendrore informative të institucioneve publike për mbrojtje, Arkivit dhe personat juridik të autorizuar për kryerjen e çështjeve të mbrojtjes së këtij lloji të trashëgimisë kulturore;
3. Informata publike, të kapshme, të përgjithshme dhe të sakta për trashëgiminë kulturore dhe mbrojtja e saj;

Ruajtja dhe shfrytëzimi i dokumentacionit

Neni 116

(1) Dokumentacioni për trashëgiminë kulturore dhe të mirat tjera të mbrojtura ruhen në tri vende të ndryshme, që i përcakton Drejtoria.

(2) Dokumentacioni nga paragrafi (1) i këtij neni jepet në shfrytëzim për qëllime zyrtare, shkencore, edukative, publikim dhe për shkaqe tjera të arsyeshme.

(3) Sipas regullit, për shfrytëzim jepen kopje të dokumentacionit që përpunohen në shpenzim të kërkuarit.

(4) Organeve shtetërore edhe për qëllime shkencore, në shfrytëzim të përkohshëm mund të jepet edhe dokumentacioni burimor, me obligim të ruajtjes së tij, përpunim të incizimit mbrojtës në shpenzim të kërkuarit dhe me kushte tjera të përcaktuara me aktin e neni 36 paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Për shfrytëzimin e dokumentacionit, subjekti kompetent që e ruan dokumentacionin mban evidencë të veçantë.

Seksioni 11

SHFRYTËZIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE

11.1. Shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore nëpërmjet koncesionit

Lënda e koncesionit

Neni 117

(1) Lëndë e shfrytëzimit nëpërmjet koncesionit, sipas këtij ligji, mund të jetë trashëgimia e patundshme kulturore me rëndësi të veçantë në pronë shtetërore, me përjashtim të të mirave nga paragrafi (2) të këtij neni, e cila është ose mund të jetë e dedikuar për:

1. Banim;
2. Kryerje të veprimtarisë turistike, hotelierike, tregtare, artizanatit dhe veprimtari tjetër shërbyese;
3. Kryerje të veprimtarisë burimore ose veprimtarisë së ngjashme prodhuese.
4. Kryerje të veprimtarive nga lëmi i arsimit, shkencës, informimit, shëndetësisë, sportit, rekreimit, si dhe kulturës me përjashtim të veprimtarive të mbrojtjes.

(2) Lëndë e koncesionit nuk mund të jenë:

1. Zonat e rezervuara arkeologjike dhe vendzbulime tjera arkeologjike plotësisht jo të kërkuara ose të pakërkuara;
2. Objekte memoriale, shënime dhe vende të lidhura me ngjarje dhe personalitete të dalluar;

3. Vendet e kultit ose vende dhe objekte tjera të lidhura me tradita, besime ose tradita të veçanta;

4. Të mira të patundshme nga neni 12 paragrafi (2) dhe neni 13 paragrafi (2) i këtij neni.

(3) Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë ligj zbatohet Ligji për koncesione.

Koncesioneri

Neni 118

(1) Koncesion mund t'i jepet personit fizik dhe juridik të vendit ose të huaj (koncesioneri) i cili i plotëson këto kushte:

1. Të jetë i regjistruar për kryerje të veprimtarisë nga neni 117 paragrafi (1) i këtij ligji;

2. Të ketë mundësi materiale-teknike për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është i regjistruar dhe për mbrojtjen e të mirës së patundshme e cila është lëndë e koncesionit;

3. Të ofrojë program për revitalizim dhe plan për administrim me të mirën materiale e cila është lëndë e koncesionit.

(2) Koncesioneri ka statusin e poseduesit të trashëgimisë kulturore, me të drejta dhe obligime të përcaktuara me këtë ligj dhe marrëveshjes për koncesion.

Kohëzgjatja e koncesionit dhe kompensimi për koncesion

Neni 119

(1) Periudha për të cilën jepet koncesioni është:

1. Gjer më 10 vjet për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit;

2. Gjer më 15 vjet për kryerjen e veprimtarive tjera të nenit 117 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Koncesioni mund të vazhdohet më së shumti për 5 vjet.

(3) Për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore që është lëndë e koncesionit paguhet kompensim vjetor, lartësia e të cilit përcaktohet me marrëveshjen për koncesion.

(4) Kompensimi nga paragrafi (3) i këtij neni paguhet gjer më 30 qershor për vitin në vijim.

Mbikëqyrja në realizimin e marrëveshjes

Neni 120

(1) Mbikëqyrjen në realizimin e marrëveshjes për koncesion e bën Ministria e Kulturës.

(2) Ministria e Kulturës me vendim përcakton këshillin e veçantë për mbikëqyrjen e realizimit të marrëveshjes për koncesion.

(3) Si anëtarë të këshillit emërohen së paku nga një përfaqësues të komunës në territorin e të cilës gjendet e mira koncesionuese dhe të organizatave joqeveritare nga lëmi i sigurimit i trashëgimisë kulturore.

11.2 Dispozitat e veçanta

Kryerja e veprimtarisë ekonomike në të mira të mbrojtura

Neni 121

(1) Veprimtaria ekonomike në trashëgiminë e patundshme kulturore dhe të mirë tjetër të patundshme të mbrojtur sipas dispozitave të këtij ligji mund të bëhet vetëm sipas lejes paraprake nga Drejtoria.

(2) Leje nga paragrafi (1) i këtij neni është e nevojshme për secilin ndryshim të veprimtarisë, gjegjësisht ndryshim të lokalit afarist.

Shfrytëzimi i emrit dhe formës së trashëgimisë kulturore për qëllime komerciale

Neni 122

Emri, forma ose pjesë tjetër e njohjes së të mirës së mbrojtur mund të përdoret për reklamë, si element i firmës dhe për përpunimin e suvenireve ose lëndë tjera për qëllime komerciale, në mënyrë adekuate të dedikimit ose rëndësisë të të mirave, në bazë të lejes paraprake nga Drejtoria.

Kapitulli V

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E POSEDUESVE
TË TË MIRAVE TË MBROJTURA

Seksioni 1

TË DREJTAT E POSEDUESVE

E drejta për ndihmë profesionale

Neni 123

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur ka të drejtë në ndihmë profesionale pa kompensim, sipas madhësisë dhe llojit të caktuar me këtë ligj.

(2) E drejta nga paragrafi (1) e këtij neni nënkupton veçanërisht:

1. Kontrollin dhe sqarime profesionale për veçoritë, rëndësinë dhe gjendjen e të mirës;
2. Këshilla profesionale dhe udhëzime në drejtim të respektit, ruajtjes, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të të mirës;
3. Udhëzim për nevojën e ndërmarrjes së masave të veçanta për ruajtje dhe mirëmbajtje të të mirës ose masave të veçanta teknike-mbrojtëse;
4. Ndihmë për realizimin e të drejtave dhe obligimeve tjera të caktuara me këtë ligj.

(3) Koleksioneri ose poseduesi tjetër i koleksionit të mbrojtur ose poseduesi i përmendores sarkale ose përmendores tjetër me të mira të tundshme që janë pjesë e saj përbërëse ka të drejtë në ndihmë profesionale:

1. Në drejtim të vendosjes dhe udhëheqjes së inventarit (kartotekë) të të mirave tjera të mbrojtura.
2. Për konservimin e lëndëve të regjistruara në inventarin nga pika 1 e këtij paragrafi.

(4) Të drejtën në ndihmë profesionale sipas paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni, poseduesi i të mirës së mbrojtur me kërkesë të tij me shkrim, e realizon në institucionin e tyre publik kompetent për mbrojtje, gjegjësisht Arkivin.

(5) Në rastet urgjente, veçanërisht kur kërcënohet rrezik i drejtpërdrejtë nga dëmtimi i të mirës së mbrojtur, subjektet nga paragrafi (4) të këtij neni janë të obliguar ta ofrojnë ndihmën e kërkuar profesionale menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga paraqitja e kërkesës me shkrim të poseduesit.

E drejta e kompensimit të harxhimeve plotësuese

Neni 124

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur nuk është i detyruar t'i bartë harxhimet plotësuese për ruajtje dhe mirëmbajtje të të mirës, as për ekzekutimin e masës së paraparë për mbrojtje.

(2) Shpenzime plotësuese konsiderohen të dalat mbi harxhimet e rëndomta për ruajtje dhe mirëmbajtje të të mirës si dhe të dalat më shumë se të hyrat dhe interesat tjera materiale nga e mira.

(3) Poseduesi i të mirës së mbrojtur ka të drejtë në kompensimin e harxhimeve plotësuese nëse paraprakisht ka marrë pajtim nga Drejtoria, harxhimet e tilla të bëhen, në lartësi për të cilën është dhënë pajtimi me shkrim.

(4) Në rast të mospajtit me kompensimin e caktuar, poseduesi i të mirës së mbrojtur mund të kërkojë që lartësinë e kompensimit ta përcaktojë gjyqi kompetent, jashtë procesit ndërgjyqësor.

(5) Ministri i Kulturës do t'i përpilojë kriteret e përkufizimit të harxhimeve të rregullta dhe plotësuese, sipas llojit të trashëgimisë kulturore, si dhe mënyrën e realizimit të së drejtës së harxhimeve plotësuese.

E drejta e kompensimit të drejtë për shkak të kufizimeve nga regjimi i mbrojtjes

Neni 125

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur ka të drejtë në kompensim të drejtë për shkak të përkufizimeve që dalin nga regjimi mbrojtës, në rastet e caktuara me këtë ligj, nëse masa mbrojtëse nuk është e rregulluar me fajin e tij subjektiv.

(2) Kompensimi sipas paragarfit (1) të këtij neni mund të aprovohet në shumë të njëherëshme ose vjetore, nëse kushtet e prishura për shfrytëzim ekonomik të së mirës nuk mund të kompensohen me kryerjen e veprimtarisë tjetër në suazat e regjimit mbrojtës.

(3) Për shkak të sigurimit nga dëmet eventuale, në rastet e përcaktuara me këtë ligj, poseduesi i të mirës së mbrojtur ka të drejtë në garanci të caktuara.

(4) Nëse poseduesi i të mirës së mbrojtur dhe Drejtoria nuk mund të merren vesh për lartësinë e kompensimit ose garancinë, atë e cakton gjyqi kompetent në procedurë jashtëndërgjyqësore.

E drejta e prezentimit publik të koleksioneve private

Neni 126

(1) Koleksioneri dhe poseduesi tjetër i përmbledhjes private të mbrojtur si trashëgimi kulturore të tundshme ka të drejtën e prezentimit të kohëpaskohëshme publike të koleksionit në salonet e ekspozitës të institucioneve publike për mbrojtje, pa kompensim për hapësirën ekspozuese të liruar dhe për organizimin e ekspozitës.

(2) Marrëdhëniet midis poseduesit të koleksionit të mbrojtur dhe institucionit për mbrojtje rregullohen me marrëveshje.

E drejta e privilegjeve

Neni 127

Poseduesi i të mirës së mbrojtur ka të drejtën e privilegjit në tatime, dogana dhe privilegje tjera të përcaktuara me këtë ligj.

E drejta e depozitimit

Neni 128

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur të tundshme i cili objektivisht nuk ka mundësi të sigurojë ruajtjen e drejtë të së mirës ose përkohësisht është i penguar nga shkaqet e arsyeshme, ta ruajë të mirën, ka të drejtë ta dorëzojë (depozitojë) atë të mirë për ruajtje në institucionin kompetent publik për mbrojtje, gjegjësisht në Arkiv.

(2) Marrëdhëniet lidhur me ruajtjen dhe shfrytëzimin të së mirës së besuar rregullohen me marrëveshje midis poseduesit dhe institucionit, gjegjësisht Arkivit.

Seksioni 2

OBLIGIMET E POSEDUESVE

Paraqitja

Neni 129

(1) Secili posedues i të mirës së mbrojtur ose i të mirës për të cilën supozohet se paraqet trashëgimi kulturore është i obliguar ta paraqesë në institucionin kompetent publik për mbrojtje, gjegjësisht Arkiv në afat prej 30 ditësh nga dita kur është bërë posedues.

(2) Përfundim nga paragrafi (1) i këtij neni, zbulimi i rastit paraqitet menjëherë dhe konsiderohet se është bërë nëse paraqitja është dërguar në mënyrë indirekte në institucionin kompetent publik për mbrojtje ose në Ministrinë e punëve të brendshme. Nëse fletëparaqitja është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ajo e dërgon fletëparaqitjen në institucionin publik kompetent.

(3) Poseduesi i të mirës së mbrojtur është i obliguar të veprojë sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe në raport me të gjitha ndryshimet faktike dhe juridike që do të paraqiten në atë të mirë pas paraqitjes së saj, përveç në rastet e dëmtimit, shkatërrimit, vjedhjes ose zhdukjes, kur denoncimi bëhet menjëherë ose së paku ditën e ardhshme.

Ruajtja, mirëmbajtja dhe realizimi i masave të parapara

Neni 130

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur është i obliguar me të mirën të sillet me vëmendje të duhur, gjegjësisht si tutor i mirë, ta respektojë, ruajë dhe mirëmbajë, si dhe me kohë t'i ndërmarrë masat e parapara teknike-mbrojtëse dhe masa tjera.

(2) Nëse poseduesi i të mirës së mbrojtur nuk i ndërmerr masat e parapara nga paragrafi (1) i këtij neni, harxhimet e së cilës nuk i tejkalojnë të hyrat dhe dobive tjera materiale të cilat ai i ka nga e mira, Drejtoria me vendim do t'i caktojë afat gjatë të cilit është i obliguar ta realizojë atë masë, me paralajmërim se në të kundërtën masa do të realizohet në shpenzim të tij.

(3) Nëse poseduesi i të mirës së mbrojtur as pas paralajmërimit nuk e realizon masën e paraparë në afatin e caktuar, Drejtoria do të ofrojë ekzekutimin e asaj mase nga ana e institucionit kompetent për mbrojtje, në shpenzim të poseduesit.

(4) Në rastin e paragrafit (3) të këtij neni, Drejtoria me vendim do të caktojë obligimin e poseduesit për kompensimin e shpenzimeve dhe lartësinë e shpenzimeve për zbatimin e masës së tillë.

(5) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi (2) dhe (4) të këtij neni, nuk e pengon ekzekutimin e vendimit.

Kthimi i mjeteve të depozituara publike

Neni 131

(1) Në rast të tjetërsimit të së mirës së mbrojtur, për mirëmbajtje, konservim, restaurim ose masa tjera për mbrojtje të drejtpërdrejtë janë depozituar mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë ose buxhetet e njësisve të vetadministrimit lokal dhe fondeve publike (në tekstin e mëtejshëm: mjete publike) me të cilat është zmadhuar vlera e saj, pronari i të mirës së mbrojtur është i obliguar t'i kompensojë mjetet e depozituara publike

(2) Lartësia e kompensimit përcaktohet varësisht prej rethanave gjatë kohës së tjetërsimit të së mirës së mbrojtur.

(3) Nëse për lartësinë e kompensimit nuk arrihet pajtim midis pronarit dhe depozituesit, lartësia e kompensimit, me propozim të pronarit ose Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht njësisë së vetadministrimit lokal ose fondit publik, do ta përcaktojë gjyqi kompetent gjatë procedurës jashtëdërgjyqësore, i cili me vendim do të shqiptojë edhe vendosjen e të drejtës së pengut të së mirës së mbrojtur për shumën e caktuar në dobi të depozituesit.

Lejimi i hulumtimit dhe zbatimi i masave mbrojtëse

Neni 132

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur është i obliguar të lejojë dokumentimin, studimin, hulumtimin dhe zbatimin e masave teknike-mbrojtëse dhe masave tjera mbrojtëse të institucionit publik për mbrojtje dhe të personit tjetër juridik, si dhe të personit fizik që për atë ka leje nga Drejtoria.

(2) Poseduesi i të mirës për të cilën supozohet se paraqet trashëgimi kulturore, është i obliguar, institucionit kompetent publik për mbrojtje t'i lejojë të mirën ta kontrollojë, t'i bëjë hulumtimet e duhura ose studime ta incizojë teknikisht, në fotografi ose ta filmojë. Në rast të kundërshtimit të poseduesit, Drejtoria mund me vendim t'i ofrojë ta lejojë kryerjen e punëve të domosdoshme.

(3) Koleksioneri dhe poseduesi tjetër i koleksionit të mbrojtur, është i obliguar, institucionit kompetent publik për mbrojtje t'i sigurojë qasje në inventarin nga neni 123 paragrafi 3 pika 1 të këtij ligji.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, poseduesi ka të drejtë në kompensim sipas nenit 125 të këtij ligji:

1. Nëse është shkaktuar dëm i vërtetë si rezultat i pavëmendjes së lartë, punës joprofesionale ose mënjanimit nga lloji i caktuar dhe madhësisë së aktiviteteve mbrojtëse konkrete;

2. Nëse punët janë më të mëdha ose zgjasin në periudhë më të gjatë, në kontinuitet ose me ndërprerje, për shkak të së cilës e mira nuk mundet normalisht të përdoret, gjegjësisht shfrytëzohet për dedikimin e vet, në tërësi ose pjesë të rëndësishme;

3. Nëse punët janë të asaj natyre që prezenca e saj personale është e domosdoshme në periudhë më të gjatë (djerraditë);

Lejimi i të mirave të mbrojtura për manifestime kulturore

Neni 133

(1) Gjatë organizimit të manifestimeve të rëndësishme kulturore, veçanërisht ekspozitave, poseduesi i të mirës së mbrojtur është i obliguar, me kërkesë të institucionit kompetent publik për mbrojtje, ta lejojë të mirën e caktuar të përdoret për atë qëllim.

(2) Institucioni kompetent nga paragrafi (1) i këtij neni dhe poseduesi i të mirës së mbrojtur në atë rast lidhin marrëveshje me të cilën, përveç obligimeve tjera në marrëveshje, parashihet dhënja e garancive në rast të dëmtimit, shkatërrimit, vjedhjes ose zhdukjes të së mirës (garanci bankare, sigurimit në shoqatë për sigurim etj.) dhe afati i kthimit i së mirës. Me kërkesë të poseduesit, me marrëveshje përcaktohet edhe lartësia e kompensimit për përkufizimin e tillë, si dhe mënyra e kompensimit.

(3) Poseduesi i të mirës së mbrojtur mund të kërkojë, për vlerësimin e vlerës, për nevojën e shfrytëzimit të së mirës, për masat e sigurimit të së mirës dhe për lartësinë e kompensimit për lirim të vendos Drejtoria.

(4) Të gjitha shpenzimet lidhur me shfrytëzimin e këtyre të mirës i bart organizuesi i manifestimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse poseduesi i të mirës së mbrojtur refuzon ta japë të mirën për qëllimin e paragrafit (1) të këtij neni, me kërkesë të organizatorit të manifestimit, Drejtoria me vendim mund ta detyrojë poseduesin përkohësisht t'ia japë të mirën institucionit kompetent për mbrojtje.

(6) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk e pengon të drejtën e ekzekutimit të vendimit.

(7) Obligimi i poseduesit të të mirës së mbrojtur të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni nuk e vë në rrezik trashëgiminë kulturore.

Mundësimi i qasjes të së mirës së mbrojtur opinionit në mënyrë të veçantë

Neni 134

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur është i obliguar, në bazë të vendimit të Drejtorisë, të mundësojë qasje të së mirës së mbrojtur opinionit në mënyrë të veçantë, nëse ajo, varësisht nga natyra dhe dedikimi i të mirës, është e nevojshme për shkak të plotësimit të nevojave kulturore të qytetarëve ose për arritjen e qëllimeve tjera të interesit publik.

(2) Qasja në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni nënkupton, veçanërisht: shikimin e të mirës së patundëshme në kohë të caktuar dhe në mënyrë të caktuar të vizitës, mënyrën e veçantë të eksponimit të të mirave të tundshme aty për aty ose bartjen e tyre në vend tjetër adekuat etj.

(3) Nëse për shkak masës së përcaktuar në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni poseduesi i të mirës së mbrojtur pëson dëm, ai ka të drejtë në kompensim nga neni 125 i këtij ligji.

(4) Trashëgimia kulturore në rrezik nuk mund të jetë lëndë e masës nga paragrafi (1) i këtij neni.

Informimi i poseduesit të ri për statusin dhe regjimin e të mirës së mbrojtur

Neni 135

(1) Poseduesi i të mirës së mbrojtur është i obliguar ta informojë poseduesin e ri se e mira e tillë është nën regjimin juridik të mbrojtjes, si dhe për masat që nuk janë kryer ose që duhet të kryhen në afat të caktuar.

(2) Obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni e përfshin edhe njoftimin e poseduesit të ri me ekzistimin e obligimeve eventuale në bazë të të drejtës së pengut ose dëmshpërblimit, ekspropriimit, restitucionit, dhe kërkesave tjera të ngjashme ose procedura lidhur me të mirën e mbrojtur.

Seksioni 3

PËRKUFIZIMET E VEÇANTA

Caktimi i tutorit të së mirës së mbrojtur

Neni 136

(1) Nëse poseduesi i të mirës së mbrojtur nuk vepron sipas dispozitave të këtij ligji, gjegjësisht me neglizhencë e ruan ose e mirëmban në mënyrë joprofesionale të mirën e mbrojtur, ashtu që ekziston rreziku që e mira të dëmtohet ose zhduket, dhe as pas paralajmërimit nuk e ndërron qëndrimin e vet ndaj të mirës së mbrojtur, Drejtoria mundet, me propozim të institucionit kompetent publik për mbrojtje, me vendim të caktojë që ajo e mirë t'i jepet në administrim tutorit të caktuar për atë qëllim.

(2) Tutori është i detyruar t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtje dhe mirëmbajtje të asaj të mire të mbrojtur. Masat që e tejkalojnë mirëmbajtjen e rregullt, tutori mund t'i ndërmerr vetëm me leje paraprake të Drejtorisë.

(3) Në rastin e paragrafit (2) të këtij neni, harxhimet për mirëmbajtjen e të mirës së mbrojtur që nuk i takalojnë të hyrat ose dobitë tjera materiale, bien në barrë të poseduesit të tij, ndërsa përkohësisht i përmbush Drejtoria, me të drejtë të kthimit të mjeteve nga poseduesi. Harxhimet plotësuese janë në barrë të Drejtorisë.

(4) Drejtoria do ta shkarkojë tutorin nëse poseduesi i të mirës së mbrojtur dëshmon se ka siguruar kushte për ruajtje dhe mirëmbajtje të drejtë.

(5) Masa nga paragrafi (1) e këtij neni ndërmirret edhe kur poseduesi i të mirës së mbrojtur nuk është i njohur ose kur përkohësisht e ka braktisur të mirën materiale.

(6) Konsiderohet se poseduesi përkohësisht e ka braktisur të mirën e mbrojtur në rast kur vendqëndrimi i tij nuk është i njohur, dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar, për shkak të së cilës Drejtoria nuk është në gjendje ta informojë për obligimet e tij, më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e tentimit për dërgimin e parë të informatës. Nëse poseduesi ngel i panjohur tri vjet për të mirën e tundshme, gjegjësisht dhjetë vjet për të mirën e patundshme, konsiderohet se e mira e mbrojtur është braktisur përgjithmonë.

Bartja e të mirës së tundshme për shkak të mbrojtjes

Neni 137

(1) Nëse e mira e tundshme nuk është e mbrojtur sa duhet në vendin ku gjendet, ndërsa poseduesi i saj objektivisht nuk është në gjendje ta sigurojë mbrojtjen e duhur, Drejtoria mund, me propozim të institucionit kompetent publik për mbrojtje, me vendim ta caktojë që e mira të dorëzohet në ruajtje dhe shfrytëzim të përkohëshëm në institucionin kompetent publik për mbrojtje ose të bartet në vend tjetër ku do të jetë më mirë e mbrojtur nga sigurimi i kushteve të nevojshme për ruajtjen e saj.

(2) Me vendimin e paragrafit (1) të këtij neni përcaktohet dhe në barrë të kujt janë harxhimet për bartjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të mirës së mbrojtur.

(3) Masa nga paragrafi (1) e këtij neni mund të përcaktohet edhe në rastet kur në mënyrë tjetër nuk mund opinionit t'i sigurohet qasje në të mirën e mbrojtur (neni 134).

(4) Nëse për shkak të masës në kuptim të paragrafit (1) dhe (3) të këtij neni poseduesi pëson dëm, ai ka të drejtë në kompensim nga neni 125 i këtij ligji.

Përcaktimi i mënyrës dhe qëllimit të shfrytëzimit të së mirës së mbrojtur

Neni 138

(1) Nëse me përdorim ose shfrytëzim të rregullt të së mirës së mbrojtur i shkaktohen dëme, Drejtoria mundet me vendim ta obligojë poseduesin e vet që përdorimin, gjegjësisht shfrytëzimin e të mirës ta bëjë në mënyrë të përcaktuar ose për qëllime të caktuara.

(2) Nëse për shkak të masës nga paragrafi (1) të këtij neni poseduesi i të mirës së mbrojtur pëson dëm, ai ka të drejtë në kompensim në kuptim të nenit 125 të këtij ligji, përveç në rast kur dëmi është në formë të dobisë së liruar për shkak të mbrojtjes të dedikimit burimor të së mirës.

Kthimi në gjendjen e mëhershme

Neni 139

(1) Nëse poseduesi shkakton dëm ndaj të mirës së mbrojtur nga përdorimi që është në kundërshtim të dedikimit të caktuar ose nga veprimi që është në kundërshtim të regjimit të paraparë të mbrojtjes ose nëse dëmi është shkaktuar për shkak të moszbatimit ose zbatimit në

kohë jo të duhur dhe të pandërgjegjshme të masës së ofruar mbrojtëse, Drejtoria mund, me vendim ta obligojë poseduesin në afat të caktuar ta vendosë gjendjen e mëparshme ose t'i kompensojë harxhimet për atë.

(2) Nëse poseduesi nuk vepron sipas vendimit në afatin e paraparë, kthimin në gjendjen e mëparshme do ta zbatojë institucioni i caktuar për mbrojtje, në bazë të vendimit të Drejtorisë, në barrë të poseduesit.

(3) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi (1) dhe (2) e këtij neni, nuk e pengon ekzekutimin e vendimit.

Përparësia e blerjes së parë

Neni 140

(1) Të drejtën për blerje me përparësi të së mirës së mbrojtur e ka Republika e Maqedonisë, nëpërmjet Drejtorisë.

(2) Pronari i cila ka për qëllim ta shesë të mirën e mbrojtur është i obliguar, së pari t'ia ofrojë Drejtorisë. Pronari është i obliguar në ofertë ta shënojë çmimin dhe kushtet tjera të shitjes.

(3) Drejtoria është e obliguar në afat prej 30 ditësh nga dita e dërgimit të ofertës, me shkrim ta informojë pronarin a e pranon ofertën ose nuk do ta realizojë të drejtën e parë për blerje.

(4) Nëse Drejtoria e pranon ofertën, është e obliguar shumën e çmimit, e cila sipas ofertës duhet ta paguajë me para në dorë, në afat prej 30 ditësh nga dita e dërgimit të ofertës, ta depozitojë në gjyqin themelor ose në noter, edhe atë sipas vendit ku gjendet patundëshmëria, gjegjësisht sipas vendit të banimit të ofertuesit nëse bëhet fjalë për të mirë të tundshme.

(5) Pas kalimit të afatit për pranimin e ofertës, gjegjësisht për depozitim të shumës së çmimit, pronari mund t'ia shesë të mirën e mbrojtur personit tjetër sipas çmimit që nuk është më vogël nga ajo e praqitura në ofertë dhe me kushte të cilat për blerësin nuk janë më të volitshme nga ato të paraqitura në ofertë.

(6) Republika e Maqedonisë ka të drejtën e përparësisë në blerje dhe në rast të shitjes me dhunë të së mirës së mbrojtur, edhe atë sipas ofertës së dhënë në procedurën e shitjes së dhunshme që është më e volitshme për pronarin e të mirës.

(7) Gjyqi kompetent që e realizon procedurën e shitjes me dhunë është i obliguar për atë ta informojë Drejtorinë, gjegjësisht për ditën e shitjes publike më së paku tetë ditë para se të fillojë shitjen e dhunshme të së mirës së mbrojtur.

Realizimi i të drejtës së blerjes me përparësi

Neni 141

(1) Nëse pronari e shet të mirën e mbrojtur, ndërsa paraparakisht nuk ia ka ofruar në shitje Republikës së Maqedonisë ose nëse e shet me çmim më të lirë nga ajo në ofertën e dërguar në Drejtori ose me kushte që për blerësin janë më të volitshme nga ato në ofertë, ose nëse e mira është shitur në procedurën e shitjes së dhunshme, ndërsa për atë Drejtoria nuk është e informuar, Republika e Maqedonisë ka të drejtë me ankesë kundër shitësit dhe blerësit të kërkojë prishjen e kontratës për shitje dhe pronari të veprojë sipas dispozitave nga neni 140 të këtij ligji, gjegjësisht Republika e Maqedonisë të konsiderohet për blerës i të mirës së shitur në procedurën e shitjes me dhunë.

(2) Ankesa nga paragrafi (2) i këtij neni mund të paraqitet në afat prej 90 ditësh nga dita kur Drejtoria ka marrë njohuri për shitjen e bërë, e më së voni në afat prej 5 vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës për shitje.

(3) Republika e Maqedonisë mund të kërkojë në afatet nga paragrafi (2) i këtij neni, që marrëveshja për shitje të prishet edhe kur ajo marrëveshje gjoja është lidhur në formë të dhuratës ose kur shumta e çmimit ose kushtet tjera të shitjes janë sa për dukje, ndërsa çmimi real dhe kushtet tjera të marrëveshjes janë më të volitshme për blerësin nga ato të përbëra në ofertë të dërguar në Drejtori.

(4) Republika e Maqedonisë ka të drejtë të kërkojë prishjen e marrëveshjes për shitje nëse në ankesë thekson se e blen të mirën e mbrojtur sipas çmimit dhe me kushte tjera sipas të cilave ajo është shitur dhe nëse më së voni në afat prej 7 ditësh pas dërgimit të ankesës, depoziton shumë në lartësinë e çmimit real të marrëveshjes për shitje të së mirës, gjegjësisht shumë e çmimit që sipas marrëveshjes së lidhur ka arritur për pagesë pas ditës së dërgimit të ankesës.

(5) Në rast të prishjes së marrëveshjes për shitje përfundojnë të drejtat e blerësit dhe personave të tretë të përfituar nga marrëveshja e prishur e të mirës së mbrojtur, pa marrë parasysh se poseduesi a ka qenë i vetëdishëm.

Seksioni 4

E DREJATA E PENGUT DHE EKSPROPRIIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE

E drejta e pengut

Neni 142

(1) Për shkak të sigurimit të pagesës së mjeteve të depozituara në të mirën e mbrojtur, të cilat paraqesin të dala nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në rastet e nenit 130 paragrafët (3) dhe (4), neni 136 paragrafi (3) dhe neni 139 paragrafi (2) i këtij neni, themelohet e drejta ligjore e pengut në dobi të Republikës së Maqedonisë.

(2) Për shkak të sigurimit të kërkesës së kompensimit për mjetet e depozituara në kuptim të nenit 131 të këtij ligji, lidhet marrëveshje të themelimit të së drejtës së pengut (peng ose hipoteke) midis depozituesit dhe poseduesit të së mirës së mbrojtur.

Ekspropriimi

Neni 143

(1) Konsiderohet se ekziston interesi publik dhe për shkak të asaj mund të bëhet ekspropriimi i patundshmërisë e cila paraqet të mirë të mbrojtur, duke inkorporuar edhe patundshmëri tjetër në zonë të mbrojtur, nëse:

1. Pronari i patundshmërisë nuk ka mundësi ose interes të sigurojë zbatimin e masave të parapara, dhe për këtë shkak ekziston rrezik që e mira e mbrojtur të dëmtohet ose shkatërrohet;

2. Në mënyrë tjetër nuk mund të bëhen gjurmime arkeologjike, dhe gjurmime ose të zbatohen masat mbrojtëse;

3. Është e duhur patundshmëria të revitalizohet dhe të inkorporohet me dedikim të ri në fusha urbane, rurale ose natyrore të përcaktuar me plan hapësinor, gjegjësisht urbanistik ose të bëhet ripërtëritja dhe rregullimi i territorit të mbrojtur, ndërsa ajo nuk mund të arrihet përmes depozitimit të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë me atë rregull të paraparë sipas këtij ligji;

4. Është e nevojshme e mira e mbrojtur të aftësohet dhe shfrytëzohet për veprimtari kulturore, ndërsa pronari nuk ka mundësi atë ta zbatojë;

5. Në mënyrë tjetër nuk mund të mundësohet ose të lehtësohet hulumtimi i së mirës së mbrojtur ose të mundësohet qasja e saj opinionit më të gjërë.

(2) Procedura për ekspropriim zhvillohet sipas propozimit të Ministrisë së Kulturës.

(3) Për të drejtën e kompensimit të drejtë për patundshmërinë e ekspropriuar, për supozimet për ekspropriim të plotë ose të pjesërishtë, procedura dhe çështjet tjera që nuk janë të rregulluara me këtë ligj zbatohen rregullat për ekspropriim.

Kapitulli VI

ORGANIZIMI I MBROJTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE

Seksioni 1

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Themelimi dhe statusi i Drejtorisë

Neni 144

(1) Për kryerjen e çështjeve drejtuese, profesionale dhe çështjeve tjera nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore themelohet Drejtoria për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si organ në suazat e Ministrisë së Kulturës.

- (2) Drejtoria ka cilësinë e personit juridik.

Kompetenca e Drejtorisë

Neni 145

(1) Drejtoria për ruajtjen e trashëgimisë kulturore:

1. Mban procedurë administrative lidhur me lëndët nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe miraton akte administrative në pajtim me këtë ligj.

2. I përgatit aktet nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore që i miraton Ministria e Kulturës;

3. Merr pjesë në procedura administrative dhe procedura të tjera, lidhur me trashëgiminë kulturore dhe mbrojtjen e saj, që i udhëheqin organet tjera kompetente, në rastet e përcaktuara me këtë dhe ligjet tjera;

4. Ngre iniciativa dhe ndërmerr procedura para organeve kompetente, për punë që janë të interesit publik për trashëgimi kulturore dhe mbrojtjen e saj;

5. E përcjell dhe e analizon gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe propozon akte dhe masa për realizimin, zhvillimin dhe përparimin e mbrojtjes së saj;

6. Mban evidencën qendrore dhe inventarët e veçantë nacional të trashëgimisë kulturore, në kuptim të këtij ligji dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare;

7. Bën klasifikimin sipas Klasifikimit nacional të trashëgimisë kulturore;

8. E mban Regjistrin nacional të trashëgimisë kulturore;

9. I bën punët lidhur me vendosjen dhe zhvillimin e Sistemit informativ për trashëgiminë kulturore në Republikën e Maqedonisë;

10. Bën punë të sigurisë së mbrojtjes dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rast të konfliktit të armatosur dhe fatkeqësive natyrore;

11. Bën punë të mbrojtjes nga dëmtimi fizik i përshpejtuar nga ndotja dhe përparimit të kualitetit të mjedisit jetësor në zonat e mbrojtura;

12. Administron me trashëgiminë kulturore në pronë shtetërore, për të cilën e drejta për shfrytëzim nuk i është dhënë ndonjë bartësit të asaj të drejte ose për të cilën nuk është dhënë koncesion;

13. I bën punët lidhur me realizimin e të drejtës dhe përparësisë në blerje, përcaktimin e kompensimeve të drejta, lartësinë e shpërblimit për zbulim të rastësishëm, sigurimin përmes hipotekës dhe çështje tjera të natyrës juridiko-pronësore nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

14. Përgatit plane dhe programe për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në pajtim me këtë ligj;

15. E përcjell zbatimin e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, propozon dhe ndëmerr aktivitete për realizimin e të drejtave dhe obligimeve që dalin nga ato dhe përgatit raporte nacionale për zbatimin e tyre;

16. I bën punët e mbikëqyrjes inspektuese lidhur me zbatimin e rregullave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në pajtim me këtë ligj;

17. I bën punët lidhur me bashkëpunimin dhe ndihmën ndërkombëtare në lëmin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

18. Bën punë tjera nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga kompetencat e Minisistrit të Kulturës, të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër.

(2) Për kryerjen e punëve nga kompetencat e veta, Drejtoria mund të themelojë komisione dhe trupa tjerë këshilldhënës dhe profesional, si dhe të angazhojë ekspertë për çështje të caktuara.

(3) Për aktet që i miraton Drejtoria sipas ankesës vendos Ministria e Kulturës.

Seksioni 2

INSTITUCIONET PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

2.1. Institucionet për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore

Qendra nacionale konservatorike

Neni 146

(1) Qendra nacionale konservatorike është institucion amë nacional qëndrorë për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore.

(2) Qendra nacionale konservatorike në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni i bën këto funksione amë:

1. Mban evidencën amë për të mirat e mbrojtura dhe të tundshme për të cilat me arsye supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore;

2. Bën kontroll profesional në projektet konservatorike të punuara nga institucionet kompetente nacionale për mbrojtje në veprimtari;

3. Bën mbikëqyrje konservatorike mbi kryerjen e punëve për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga ana e institucioneve nacionale kompetente për mbrojtje në veprimtari;

4. E koordinon punën e institucioneve për mbrojtje në veprimtari dhe u ofron ndihmën e nevojshme profesionale;

5. Kujdeset për përparimin e veprimtarisë;

6. Kujdeset për përparimin e kuadrit profesional në veprimtari;

7. Paraqet propozime dhe jep mendime profesionale në rastet e caktuara me këtë ligj dhe me kërkesë të organeve shtetërore;

8. Bën punën e laboratorit qendror për hulumtime fiziko-kimike dhe bio-kimike;

9. Bën punën e shërbimit informativo-dokumentar qendror për trashëgiminë kulturore të patundshme;

10. Kryen funksione tjera amë të përcaktuara me ligj.

(3) Qendra nacionale konservatorike bën punë profesionale të mbrojtjes për trashëgiminë kulturore të patundshme të rëndësisë së veçantë.

(4) Qendra nacionale konservatorike, përveç punëve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, i bën edhe këta punë:

1. I studion, hulumton dhe me metoda shkencore i përpunon çështjet nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të patundshme;

2. Përpunon elaborate profesionale për valorizimin dhe revalorizimin e të mirave të patundshme;

3. Përpunon baza mbrojtëse-konservatorike për nevojat e planeve hapësinore dhe urbanistike;

4. Bën kërkime arkeologjike të objekteve që janë lëndë e konservimit;

5. Bën hulumtime konservatorike dhe punë tjera hulumtuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme;

6. Përpunon projekte konservatorike;

7. Bën kontroll profesional të projekteve konservatorike të përpunuara nga personat tjerë të autorizuar juridik dhe fizik;

8. Bën dhe organizon zbatimin e punëve konservatoriko-restauruese dhe punë tjera të mbrojtjes së drejtpërdrejtë, rregullimit dhe prezentimit të të mirave të mbrojtura të patundshme;

9. Bën mbikëqyrjen konservatorike dhe mbikëqyrje tjera mbi zbatimin e masave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme në pajtim me këtë ligj;

10. Bën ekspertiza profesionale dhe vlerësim të dëmit të të mirave të mbrojtura të patundshme;

11. U jep ndihmë profesionale poseduesve të të mirave të mbrojtura;

12. Jep publikime dhe bën popullarizimin e trashëgimisë kulturore të patundshmërisë dhe mbrojtjen e saj;

13. Bën punë tjera që iu kanë lënë në kompetencë me këtë dhe ligj tjetër.

(5) Punët nga paragrafi (4) pikat 2, 3, 4, 5, 6, 8, 10 dhe 11 të këtij neni, kur ato nuk kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore të rëndësisë së veçantë, si dhe nga pikat 7 dhe 9 të paragrafit (4) të këtij neni, Qendra nacionale konservatorike, nëse për fushën në të cilën gjendet e mira e patundshme nuk është themeluar qendra konservatorike.

(6) Qendra nacionale konservatorike bën mbrojtjen e drejtpërdrejtë edhe të trashëgimisë kulturore të patundshme e cila iu ka besuar nga institucioni kompetent publik për mbrojtje ose nga ndonjë posedues tjetër të së mirës.

(7) Qendra nacionale konservatorike administron me trashëgiminë kulturore të patundshme në pronë shtetërore, për të cilën iu ka bartur e drejta e shfrytëzimit.

Qendrat konservatorike

Neni 147

(1) Qendra konservatorike është institucion nacional për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore.

(2) Qendra konservatorike themelohet për territor me numër më të madh të të mirave materiale me rëndësi të lartë ose me koncentrim të rëndësishëm me patundshmëri tjetër të trashëgimisë kulturore.

(3) Qendra konservatorike në pajtim me ligjin mund të themelohet nëse janë plotësuar këto kushte:

1. Të jenë të siguruar mjete themelore për punë;

2. Të jenë të siguruar mjete financiare për kryerjen e përhershme të veprimtarisë;

3. Të ketë së paku nga një person profesional me arsim të lartë nga lëmi e arkitekturës, arkeologjisë, teknikat figurative, historia e artit, historisë dhe etnologjisë, prej të cilëve më së paku 1 person me status kërkuesi të autorizuar dhe 2 persona me status të konservatorit të autorizuar.

(4) Qendra konservatorike, për territorin për të cilin është themeluar, i bën punët nga neni 146 paragrafi (4) i këtij ligji.

(5) Qendra konservatorike i bën edhe punët nga neni 146 paragrafi (6) dhe (7) i këtij ligji.

Institucionet për administrim me territoret e mbrojtura

Neni 148

(1) Republika mundet, në pajtim me ligjin dhe nën kushtet e përcaktuara në nenin 147 paragrafi (3) të këtij ligji, të themelojë institucione të veçanta për administrim dhe zbatimin e masave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore të patundshme në pronë shtetërore, veçanërisht për territore më të mëdha ose më të rëndësishme.

(2) Institucionet nga paragrafi (1) i këtij neni, për qëllimin dhe trashëgiminë kulturore të patundshme për të cilën janë themeluar:

1. Bëjnë punë profesionale për mirëmbajtje, rregulim dhe shfrytëzim;
 2. Zbatojnë masa të mbrojtjes së drejtëpërdrejtë;
 3. Bëjnë prezentimin dhe popullarizimin;
 4. Miratojnë plane për administrim dhe mbrojtje;
 5. Sigurojnë dokumentacion për gjendjen dhe ndryshimet e të mirës së mbrojtur;
 6. Përpunon projekte konservatorike;
 7. Propozojnë masa nga kompetencat e organeve dhe institucioneve tjera për mbrojtje;
- Kryejnë punë tjera si posedues, në pajtim me këtë ligj dhe aktit për themelim.

2.2. Entet për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore

Institucionet muzeore

Neni 149

(1) Mbrojtjen e sendeve arkelologjike, etnologjike, historike, artistike dhe teknike sipas llojit dhe rajonit për të cilin janë themeluar, e kryejnë institucionet muzeore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të tundshme.

(2) Për rajonin dhe llojin e trashëgimisë kulturore të tundshme, për të cilën nuk është themeluar institucioni nga paragrafi (1) i këtij neni, punët e mbrojtjes sipas këtij ligji i kryen institucioni kompetent amë për mbrojtje nga paragrafi (3) i këtij neni.

(3) Komision kompetent amë për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore nga paragrafi (1) i këtij neni është Muzeu i Maqedonisë-Shkup.

(4) Për institucionet muzeore, të cilat nuk kanë statusin e institucionit publik për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore zbatohen dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me poseduesit e të mirave të mbrojtura, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.

(5) Institucionet muzeore nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, sipas llojit të të mirave, dhe rajonit për të cilin janë kompetent, i kryejnë punët si vijon:

1. I studiojnë, kërkojnë dhe me metoda shkencore i përpunojnë çështjet nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të tundshme;

2. Përpunojnë elabore profesionale për valorizimin dhe rivalorizimin e të mirave të tundshme;

3. Bëjnë kërkime arkeologjike

4. Bëjnë klërkime konservatorike dhe punë të tjera kërkimore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të tundshme;

5. Hartojnë projekte konservatorike;

6. Bëjnë kontroll profesional të projekteve konservatorike, të hartuara nga persona të tjerë të autorizuar, juridikë dhe fizikë;

7. Bëjnë dhe organizojnë kryerjen e punëve konservatoriko-restauruese dhe punë të tjera të mbrojtjes së drejtëpërdrejtë, si dhe prezentim të të mirave të mbrojtura të tundshme;

8. Bëjnë mbikëqyrjen konservatorike dhe mbikëqyrje tjera profesionale mbi zbatimin e masave të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të tundshme;

9. Bëjnë ekspertiza profesionale dhe vlerësim të dëmit të të mirave të mbrojtura të tundshme;
10. U japin ndihmë profesionale poseduesve të të mirave të mbrojtura;
11. Botojnë publikime dhe bëjnë popullarizimin e trashëgimisë kulturore të tundshme dhe mbrojtjen e saj;
12. Bëjnë edhe punë të tjera, që u janë lënë në kompetencë me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Enti amë muzeor

Neni 150

Muzeu i Maqedonisë – Shkup, si ent amë i kryen këto punë:

1. Kryen punë profesionale të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të tundshme, me rëndësi të jashtëzakonshme;
2. Mban evidencën amë për të mirat e mbrojtura dhe të mirat e tundshme, për të cilat me arsye supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore;
3. Bën kontroll profesional në projektet konservatorike të hartuara nga institucionet kompetente nacionale për mbrojtje në veprimtari;
4. Bën mbikëqyrje konservatorike për kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë nga ana e institucioneve kompetente nacionale për mbrojtje në veprimtari;
5. E koordinon punën e institucioneve për mbrojtje në veprimtari dhe u ofron ndihmën e nevojshme profesionale;
6. Kujdeset për përparimin e veprimtarisë;
7. Kujdeset për përsosjen e kuadrit profesional në veprimtari;
8. Paraqet propozime dhe jep mendime profesionale në rastet e caktuara me këtë ligj dhe me kërkesë të organeve shtetërore;
9. Bën punë të laboratorit qendror për kërkime fiziko-kimike dhe bio-kimike;
10. Bën punë të shërbimit qendror informativo-dokumentar për trashëgiminë kulturore të tundshme;
11. Kryen funksione të tjera amë të përcaktuara me ligj.

Entet bibliotekare

Neni 151

(1) Mbrojtjen e të mirave bibliotekare, sipas rajonit, për të cilin janë themeluar, e kryejnë entet publike bibliotekare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të tundshme.

(2) Për rajonin, për të cilin nuk është themeluar institucioni nga paragrafi (1) i këtij neni, punët e mbrojtjes sipas këtij ligji i kryen institucioni kompetent amë për mbrojtje nga paragrafi (3) i këtij neni.

(3) Institucion kompetent amë për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore nga paragrafi (1) i këtij neni është Bibilioteka Nacionale dhe Universitare “Shën Kliment Ohridski” – Shkup.

(4) Për institucionet bibliotekare, të cilat nuk kanë statusin e institucionit publik për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore, zbatohen dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me poseduesit e të mirave të mbrojtura, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.

(5) Institucionet bibliotekare, nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, për rajonin, për të cilin janë kompetent i kryejnë punët si vijon:

1. I studiojnë, kërkojnë dhe me metoda shkencore i përpunojnë çështjet nga lëmi i mbrojtjes të të mirave bibliotekare;
2. Hartojnë elaborete profesionale për valorizimin dhe rivalorizimin e të mirave bibliotekare;
3. Bëjnë kërkime konservatorike dhe punë tjera kërkimore për mbrojtjen e të mirave bibliotekare;

4. Hartojnë projekte konservatorike;
 5. Bëjnë kontroll profesional të projekteve konservatorike të hartuara nga personat tjerë të autorizuar, juridikë dhe fizikë;
 6. Bëjnë dhe organizojnë zbatimin e punëve konservatoriko-restauruese dhe punë të tjera të mbrojtjes së drejtpërdrejtë, dhe prezentim të të mirave të mbrojtura bibliotekare
 7. Bëjnë mbikëqyrjen konservatorike dhe mbikëqyrje të tjera profesionale mbi zbatimin e masave të mbrojtjes të të mirave bibliotekare;
 8. Bëjnë ekspertiza profesionale dhe vlerësim të dëmit të të mirave të mbrojtura bibliotekare;
 9. U japin ndihmë profesionale poseduesve të të mirave bibliotekare;
 10. Botojnë publikime dhe bëjnë popullarizimin e të mirave bibliotekare dhe mbrojtjen e tyre;
 11. Bëjnë edhe punë të tjera, që u janë lënë në kompetencë me këtë dhe ligj tjetër.
- (6) Institucioni amë për mbrojtje nga paragrafi (3) i këtij neni, i kryen punët si vijon:
1. Kryen punë profesionale të mbrojtjes të të mirave bibliotekare, me rëndësi të jashtëzakonshme;
 2. Mban evidencën amë të të mirave të mbrojtura dhe bibliotekare, për të cilat me arsye supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore;
 3. Bën kontroll profesional në projektet të hartuara nga institucionet kompetente nacionale për mbrojtje në veprimtari;
 4. Bën mbikëqyrje konservatorike për kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë nga ana e institucioneve kompetente nacionale për mbrojtje në veprimtari;
 5. E koordinon punën e institucioneve për mbrojtje në veprimtari dhe u ofron ndihmën e nevojshme profesionale;
 6. Kujdeset për përparimin e veprimtarisë;
 7. Kujdeset për përparimin e kuadrit profesional në veprimtari;
 8. Paraqet propozime dhe jep mendime profesionale në rastet e caktuara me këtë ligj dhe me kërkesë të organeve shtetërore;
 9. Bën punën e laboratorit qendror për kërkime fiziko-kimike dhe bio-kimike;
 10. Bën punën e shërbimit qendror informativo-dokumentor për të mirat bibliotekare;
 11. Kryen funksione të tjera amë, të përcaktuara me ligj.

Institucioni amë bibliotekar

Neni 152

Biblioteka Nacionale dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski"-Shkup, si ent amë i kryen këto punë:

1. Kryen punë profesionale të mbrojtjes të të mirave bibliotekare me rëndësi të jashtëzakonshme;
2. Mban evidencën amë për të mirat bibliotekare dhe të mbrojtura, për të cilat me të drejtë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore;
3. Bën kontroll profesional të projekteve konservatorike, të hartuara nga entet kompetente nacionale për mbrojtje në veprimtari;
4. Bën mbikëqyrjen konservatorike në kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë nga entet nacionale kompetente për mbrojtjen në veprimtari;
5. E koordinon punën e enteve për mbrojtje në veprimtari dhe ua ofron ndihmën e nevojshme profesionale;
6. Kujdeset për përparimin e veprimtarisë;
7. Kujdeset për aftësimin e kuadrove profesionale në veprimtari;
8. Paraqet propozime dhe jep mendime profesionale në rastet e përcaktuara me këtë ligj, dhe me kërkesë të organeve kompetente shtetërore;

9. Kryen punë të laboratorit qendror për kërkime fizike-kimike dhe biologjike-kimike;
10. Kryen punë të shërbimit qendror informativ-dokumentar për të mirat bibliotekare, dhe
11. Kryen funksione të tjera amë, të përcaktuara me ligj.

Institucioni i kinotekës

Neni 153

(1) Mbrojtjen e të mirave kinotekiste sipas këtij ligji e kryen Kinoteka e Republikës së Maqedonisë, si institucion nacional për mbrojtje.

(2) Kinoteka e Republikës së Maqedonisë i kryen punët si vijon:

1. I studion, kërkon dhe me metoda shkencore i përpunon çështjet nga lëmi i mbrojtjes të të mirave kinotekiste;
 2. Harton elaborate profesionale për valorizimin dhe rivalorizimin e të mirave kinotekiste;
 3. Bën kërkime konservatorike dhe punë të tjera kërkimore për mbrojtjen e të mirave kinotekiste;
 4. Harton projekte konservatorike;
 5. Bën kontroll profesional të projekteve konservatorike të hartuara nga personat të tjerë të autorizuar, juridikë dhe fizikë;
 6. Bën dhe organizon kryerjen e punëve konservatoriko-restauruese, dhe punë të tjera të mbrojtjes së drejtëpërdrejtë, dhe prezentimit të të mirave kinotekiste;
 7. Bën mbikëqyrjen konservatorike dhe mbikëqyrje të tjera profesionale mbi zbatimin e masave të mbrojtjes të të mirave kinotekiste;
 8. Bën ekspertiza profesionale dhe vlerësim të dëmit të të mirave kinotekiste;
 9. U jep ndihmë profesionale poseduesve të të mirave të mbrojtura kinotekiste;
 10. Boton publikime dhe bën popullarizimin e të mirave kinotekiste dhe mbrojtjen e tyre;
 11. Bën edhe punë tjera që u janë lënë në kompetencë me këtë dhe ligj tjetër.
- (3) Kinoteka, përveç punëve nga paragrafi (2) i këtij neni i kryen edhe punët si vijon:
1. Kujdeset për përparimin e veprimtarisë;
 2. Kujdeset për aftësimin e kuadrit profesional në veprimtari;
 3. Bën punën e shërbimit qendror informativo-dokumentar për të mirat kinotekiste;

Seksioni 3

SUBJEKTE TË TJERA TË AUTORIZUARA KOMPETENTE PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

3.1. Ogranizimi administrativ

Arkivi shtetëror

Neni 154

(1) Mbrojtjen e lëndës arkivore si trashëgimi kulturore të tundshme e bën Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm, sipas këtij ligji).

(2) Arkivi sipas këtij ligji kryesisht i kryen punët si vijon:

1. Mban evidencë bazë për lëndën arkivore;
2. Harton elaborate për valorizimin dhe rivalorizimin e lëndës arkivore, me rëndësi të veçantë;
3. Merr Vendim për shpalljen e lëndës arkivore për trashëgimi kulturore në rrezik;
4. Bën kërkime konservatorike;
5. Harton projekte konservatorike;
6. Kryen punë konservatorike mbi lëndën arkivore;

7. Bën mbikëqyrje konservatorike;
8. Merr masa për mbrojtjen e sigurt të lëndës arkivore.
9. Bën punë të tjera që u janë lënë në kompetencë me këtë dhe ligj tjetër.

3.2. Institucione të tjera dhe persona të tjerë juridikë

Atelietë, labororet dhe punëtoritë

Neni 155

(1) Për kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore, të tundshme dhe të patundshme, dhe punë të tjera profesionale të specializimit të ngushtë për një lloj të caktuar të të mirave të mbrojtura, mundet që sipas ligjit të themelohet institucion privat dhe lokal, dhe person tjetër juridik (ateli, laborator, punëtori etj.)

(2) Institucioni ose personi tjetër juridik nga paragrafi (1) i këtij neni mund të themelohet, nëse:

1. Ka të siguruara mjete dhe pajisje për punë;
2. Ka së paku tre persona me arsimim sipëror përkatës, nga të cilët një person me statusin e konservatorit të autorizuar;
3. Të jetë e regjistruar për kryerjen e veprimtarisë së mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore dhe veprimtarinë ta kryejë si veprimtari kryesor;

(3) Institucioni dhe personi tjetër juridik nga paragrafi (1) i këtij neni mund të fillojë me punë kur Ministria e Kulturës me Vendim do të përcaktojë se janë përmbushur kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni.

Subjektet e autorizuar për mbrojtjen e të mirave fonotekiste dhe të trashëgimisë kulturore shpirtërore

Neni 156

Për kryerjen e punëve për evidentimin, dokumentimin, valorizimin, kategorizimin, kultivimin dhe format e tjera të mbrojtjes profesionale të të mirave fonotekiste dhe të trashëgimisë kulturore shpirtërore, sipas këtij ligji, ministri i Kulturës, varësisht nga lloji i të mirave dhe natyra e punëve, ka të drejtë që me Vendim të caktojë subjektet e autorizuar nga radhët e institucioneve publike për mbrojtje, ose radhët e institucioneve shkencore dhe profesionale ose personat e tjerë juridik, të cilët janë të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë ose punëve lidhur me të mirat fonotekiste ose krijimtarinë shpirtërore.

Shoqatat e qytetarëve

Neni 157

(1) Ministria e Kulturës, shoqatave të qytetarëve nga lëmi i mbrojtjes dhe trashëgimisë kulturore, mundet që me Vendim t'ua besojë kryerjen e këtyre autorizimeve publike:

1. Punë të caktuara për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme në pronësi shtetërore, me të cilën administron;
2. Organizimin e tribunave publike gjatë përgatitjes së ligjeve dhe dispozitave të tjera për trashëgiminë kulturore nga kompetenca e saj;
3. Organizimin e debateve publike dhe profesionale për projekt-akte për shpalljen e trashëgimisë kulturore, me rëndësi të veçantë;
4. Shërbime konsultuese gjatë vendosjes për çështje më të rëndësishme nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

5. Përfshirjen në përcjellje dhe analizën e zbatimit të rregullave ndërkombëtare nacionale dhe relevante nga lëmi i mbrojtjes;

6. Zhvillimin e mekanizmave dhe metodologjive të reja për zhvillimin dhe përparimin e sistemit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

7. Realizimin e projekteve me interes nacional për përparimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

8. Punë të tjera, sipas këtij ligji, ose me ligj tjetër.

(2) Dhënia dhe marrja e autorizimeve publike sipas paragrafit (1) të këtij neni bëhet sipas ligjit.

Kapitulli VII

Këshilli nacional për trashëgimi kulturore

Themelimi, statusi përbërja dhe mandati

Neni 158

(1) Për përcjelljen, realizimin dhe përparimin e mbrojtjes dhe shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore, themelohet Këshilli nacional për trashëgiminë kulturore, si trup këshilldhënës dhe koordinues në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme Këshilli nacional; nacional).

(2) Këshilli nacional përbëhet nga kryetari dhe 14 anëtarë, që i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Ministri i Kulturës, sipas detyrës zyrtare është kryetar i Këshillit nacional.

(4) Anëtarët e Këshillit nacional emërohen nga radhët e individëve të dalluar nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe lëmitë e ngjashme të AMSHA dhe universiteteve, si dhe nga bashkësitë fetare dhe shoqatat nga kjo lëmi.

(5) Anëtarët e Këshillit nacional emërohen në periudhë prej katër vjetësh, me mundësi emërimi të sërishëm.

Kompetencat e Këshillit nacional

Neni 159

(1) Këshilli nacional:

1. Shqyrton çështjet e përgjithshme lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe jep mendim dhe propozime për përparimin e mbrojtjes;

2. propozon strategji nacionale për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore

3. Debaton për çështjet kontestuese lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe jep mendimin për zgjidhjen e tyre;

4. Propozon plan nacional aksional për preventivë të kriminalitetit kundër trashëgimisë kulturore dhe e koordinon zbatimin e tij;

5. Propozon listën prioritare nga neni 110 i këtij ligji;

6. Jep mendim për propozimet për shpalljen e zonave të rezervuara arkeologjike dhe trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçanta;

7. Jep mendim për dislokimin, lëshimin dhe rrënimin e trashëgimisë kulturore të patundshme me rëndësi të veçantë ;

8. Jep mendim për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore të patundshme në pronësinë shtetërore, përmes koncesionit;

9. E koordinon punën lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe jep mendim për raportet nacionale që Republika e Maqedonisë i dorëzon në organizatat ndërkombëtare qeveritare;

10. Formon këshill koordinues për mbrojtjen e të mirave kulturore në rast të konfliktit të armatosur dhe trupa të tjerë të përhershëm dhe të përkohshëm;

11. Miraton rregullore për punën e tij;

12. Bën edhe punë të tjera që u janë lënë në kompetencë me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(2) Këshilli Nacional i dërgon raport për punën e vet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, së paku njëherë në vit .

Punët administrative

Neni 160

Punët administrative të Këshillit nacional i kryen Ministria e Kulturës.

Kapitulli VIII

Titujt profesional

Sistemi i titujve profesional në veprimtaritë e mbrojtjes

Neni 161

(1) Punët profesionale në veprimtaritë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore i kryejnë punëtorët me arsimim përkatës, të mesëm të lartë ose sipëror për tituj profesional të përbashkët dhe të veçantë të paemëruar dhe punëtorët me tituj të përbashkët dhe të veçantë profesional të emëruar, të përcaktuar me këtë dhe ligjet e veprimtarisë së mbrojtjes të trashëgimisë së tundshme kulturore.

(2) Me ligjet për veprimtaritë e mbrojtjes së trashëgimisë së tundshme kulturore përcaktohen tituj profesional të emëruar dhe të paemëruar për punët profesionale:

1. Të cilat nuk bëjnë pjesë në punët nga neni 162 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji, dhe

2. Specifiteti i të cilave del nga lloji i trashëgimisë së tundshme kulturore;

(3) Tituj profesional, të përcaktuar sipas paragrafit (2) të këtij neni, sipas rangut të tyre, bashkëveprojnë me ato që janë të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Titujt profesional në veprimtaritë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore janë bazë për:

1. Sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës nëpër vendet e punës dhe shkallët profesionale në kuadër të vendeve të punës;

2. Sistemimi i punëtorëve në vende të punës dhe dhënia e autorizimit për kryerjen e punëve të caktuara;

3. realizimi i të drejtave në patim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

Tituj të përbashkët profesional

Neni 162

(1) Tituj jozgjedhorë të përbashkët profesional në pajtim me nenin 161 paragrafi (1) të këtij neni konsiderohen:

1. Laboranti, teknik-konservator dhe teknik-dokumentar, për punë me shkollë të mesme përkatëse;

2. Laboranti i lartë teknik-konservator i lartë dhe teknik-dokumentar i lartë, për punë me shkollë të mesme përkatëse;

3. Konservator dhe dokumentator, për punë me arsim sipëror përkatës.

(2) Tituj të përbashkët zgjedhor profesional në pajtim me nenin 161 paragrafi (1) të këtij neni konsiderohen:

1. Konservatori i lartë dhe dokumentatori i lartë;

2. Konservatori këshilltar dhe dokumentatori këshilltar.

(3) titujt profesional nga paragrafët (1) dhe (2) me përjashtim të atyre që janë lëndë për punët nga paragrafi (4) i këtij neni kanë të bëjnë me punëtorët profesional në veprimtaritë e monumentale, si dhe ato të cilët në pjesën më të madhe kryejnë punë të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë së tundshme kulturore.

(4) Titujt profesional nga paragrafët (1) dhe (2), me përjashtim të atyre që janë lëndë pune sipas paragrafit (3) të këtij neni, kanë të bëjnë kryesisht me punëtorët profesional, të cilët në tërësi ose kryesisht krijojnë punë të dokumentimit, përpunimit, ruajtjes dhe dhënies së dokumentacionit për të mirat e mbrojtura, respektivisht në shërbimet informative dokumentare të institucioneve publike për mbrojtje.

Tituj të veçantë profesional zgjedhor

Neni 163

Në veprimtaritë e mbrojtjes së trashëgimisë së tundshme kulturore, përveç atyre nga neni 160, mund të caktohen pa kufizim sa i përket titullit, titujve të posaçëm zgjedhor profesional, siç janë:

1. Kustosi, kustosi i lartë, dhe kustosi këshilltar, në veprimtarinë muzeore;

2. Bibliotekar, bibliotekar i lartë dhe bibliotekar –këshilltar në veprimtarinë bibliotekare;

3. Filmolog, filmolog i lartë dhe filmolog –këshilltar në veprimtarinë kinotekiste;

Kushtet për zgjedhje dhe rizgjedhje në tituj profesional

Neni 164

(1) Në titullin konservator i lartë dhe dokumentator i lartë mund të zgjedhet personi i cili:

1. Ka kryer studime magjistrature të lëmisë përkatëse ose ka së paku dhjetë vjet punë si konservator, respektivisht dokumentator; dhe

2. Ka botuar ose ka publikuar punime të njohura profesionale për përparimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga rajoni më i ngushtë për të cilin zgjedhet; dhe

3. Ka aftësi për organizimin e pavarur të punës profesionale.

(2) Në titullin konservator këshilltar dhe dokumentator këshilltar mund të emërohet personi, i cili:

1. Ka doktoraturë shkencore të lëmisë përkatëse ose ka së paku dhjetë vjet punë si konservator, respektivisht dokumentator; dhe

2. ka botuar punime të njohura profesionale me rëndësi të veçantë për përparimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga lëmi më i ngushtë, për të cilin zgjedhet;

(3) Personat e zgjedhur nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni rizgjedhen pas skadimit të çdo viti të pestë.

(4) Me përjashtim, personi i zgjedhur në titullin nga paragrafi (2) i këtij neni, pas rizgjedhjes së parë nuk rizgjedhet.

Kompetencat dhe procedura për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e titujve profesional

Neni 165

(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen e titujve profesional nga neni 164 i këtij ligji e kryen Ministria e Kulturës në bazë të vlerësimit të komisionit recensues.

(2) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titullin profesional bëhet me kërkesë të punëtorit profesional të interesuar. Procedura për rizgjedhje mund të ngritet edhe me iniciativën e drejtorit të institucionit publik për mbrojtje, ose nga ana e organit të administrimit me institucioni publik për mbrojtje, më së voni në afat prej tre muajve para skadimit të afatit për rizgjedhje.

(3) Komisioni recensues nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga së paku tre anëtarë, të zgjedhur nga radhët e personave, të cilët kanë së paku të njëjtin titull, për të cilin bëhet zgjedhja, respektivisht rizgjedhja, ose kanë titull përkatës profesional. Më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit e përbëjnë personat nga sfera e njëjtë profesionale e veprimtarisë për mbrojtje, në të cilën zgjidhet kandidati.

(4) Komisioni recensues paraqet raport me shkrim, në afatin e përcaktuar me aktin për formimin e tij.

(5) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni përmban të dhëna biografike për kandidatin, pasqyrën dhe vlerësimin për punën e tij profesionale dhe vlerësimin për përmbushjen e kushteve për zgjedhje, gjegjësisht rizgjedhje.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titullin profesional zgjat më së shumti tre muaj.

(7) Dispozitat nga paragrafi (1), (2), (3), (4), (5), dhe (6) të këtij neni kanë të bëjnë edhe me zgjedhjen, gjegjësisht rizgjedhjen në titujt përkatës zgjedhor profesional, në veprimtaritë për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore, nëse me ligjin përkatës për veprimtarinë nuk është caktuar ndryshe.

Përshtatshmëria dhe përshkrimi

Neni 166

Ministri i Kulturës me akt të përgjithshëm e konfirmon përshtatshmërinë e llojit të arsimit dhe përshkrimin e titujve të veçantë dhe të përbashkët profesional nga nenet 162 dhe 163 të këtij ligji.

Kapitulli IX

MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Inspektorët e trashëgimisë kulturore

Neni 167

(1) Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të tjera nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, me përjashtim të mbikëqyrjes inspektuese në kompetencë të Arkivit, e bën Drejtoria, përmes inspektorëve të trashëgimisë kulturore, në tekstin e mëtejme inspektori).

(2) Inspektor mund të jetë person me arsimim sipëror përkatës dhe me përvojë pune nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore prej së paku katër vitesh.

(3) Inspektori ka legjitimacion

(4) Formularin e legjitimacionit dhe mënyrën e lëshimit të tij e përcakton ministri i Kulturës

Autorizimet e inspektorit

Neni 168

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori autorizohet:

1. Të bëjë shikimin në gjendjen e të mirave të mbrojtura dhe ruajtjeve të tyre, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin, si dhe në kryerjen e kërkimeve arkeologjike konservatorike dhe të tjera, kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë dhe zbatimin e masave të tjera të mbrojtjes, si dhe në zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera, dhe të kërkojë të dhëna të nevojshme për këtë;

2. të bëjë kontrollin në mbajtjen e evidencave, librave të inventarit dhe librave tjera publike për mbrojtjen dhe ruajtjen e të mirave, qasjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit, duke përfshirë edhe regjistrat dhe dokumentet për prejardhjen e të mirave.

3. Të urdhërojë zbatimin e ligjeve dhe dispozitave ,si dhe masës së caktuar dhe evitimin e mangësive dhe parregullshmërive të tjera të konstatuara;

4. Të ndalojë zbatimin e masave të paligjshme ose veprimeve të tjera që kryhen pa pëlqim ose leje paraprake, respektivisht leje, apo në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me ato;

5. Të paraqesë kallzime penale dhe kundërvajtëse.

Të urdhërojë sigurimin fizik teknik dhe sigurimin tjetër të të mirave të mbrojtura, nëse ekziston rrezik për dëmtimin ose shkatërimin e tyre;

6. Të paraqesë propozim për marrjen e licencës ose lejes tjetër të lëshuar, respektivisht lejes, ose propozim për tërheqjen e pëlqimit dhe lejes paraprake,të lëshuara sipas dispozitave të këtij ligji;

7. Përkohësisht ta konfiskojë të mirën e tundshme të mbrojtur, që është fituar me kryerjen e veprave penale ose kundërvajtëse;

8. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.’’

(2) Inspektori është i autorizuar,që pa paralajmërim paraprak, në çdo kohë të hyjë në lokalet dhe në vendet ku kryhet veprimtaria e institucionit publik për mbrojtjen ose punët e personit tjetër të autorizuar juridik.

Obligimet e inspektorit

Neni 169

Në kryerjen e punëve nga kompetencat e tij inspektori është i obliguar:

1. Menjëherë ta njoftojë drejtorin e institucionit publik të mbrojtjes, respektivisht personin përgjegjës të personit tjetër të autorizuar juridik për kryerjen e mbikëqyrjes.

2. Të përpilojë procesverbal për inspektimin e kryer, në të cilin do të përfshihet gjendja e konstatuar dhe masat që i merr, respektivisht zbatimin e të cilave e urdhëron.

3. Procesverbalin ta dorëzojë te organi i administrimit dhe organi udhëheqës i personit juridik, respektivisht te poseduesi i të mirës së mbrojtur;

4. Ta njoftojë pa shtyrje inspeksionin kompetent respektivisht organin kompetent, nëse konstaton shkeljen e ligjit ose dispozitës tjetër ,zbatimin e të cilës është në kompetencë të tyre;

5. Menjëherë të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose fletparaqitje penale, nëse shkelja e ligjit, respektivisht dispozitës paraqet kundërvajtje ose vepër penale.

Lejimi i mbikëqyrjes inspektuese

Neni 170

Institucioni publik për mbrojtje dhe personi juridik i autorizuar, puna e të cilit është lëndë e mbikëqyrjes, si dhe poseduesi i të mirës së mbrojtur, janë të obliguar që inspektorit:

1. T’i mundësojë kryerje të papengueshme të shikimit të gjendjes, punës dhe akteve;

2. T’ia japin për shikim dokumentacionin e duhur;

3. T’ia japin të dhënat dhe informatat e kërkuara.

Vendimi i inspektorit

Neni 171

(1) Nëse konstaton parregullësi, mangësi ose shkelje të tjera të ligjit, respektivisht dispozitës, inspektori merr Vendim, me të cilin caktohen masat dhe afati për zbatimin e tyre si dhe afati në të cilin personi përgjegjës është i obliguar ta njoftojë inspektorin për evitimin e parregullsive, respektivisht mangësive.

(2) Kundër Vendimit të inspektorit mund të paraqitet ankesë në Ministrinë e kulturës, në afat prej 8 ditëve nga dita e dorëzimit të Vendimit.

(3) Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e Vendimit.

(4) Në kryerjen e punëve të mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët veprojnë sipas rregullave të procedurës juridike.

Kapitulli X

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 172

(1) Me dënim në para, prej 200.000 denarë gjer më 300.000 denarë, do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:

1. Bënë kërkime arkeologjike pa lejen e Drejtorisë (neni 55 paragrafi 1).

2. Menjëherë nuk i ndërpret punët dhe nuk ndërmerr masa për sigurimin e vendzbulimit arkeologjik ose nuk i ruan sendet e siguruara në vendin dhe në gjendjen në të cilin janë gjetur gjatë zbulimit të rastësishëm (neni 65 paragrafi 1 pika 2 dhe 3);

3. Nuk siguron pëlqim për dokumentacionin projektues për trashëgiminë kulturore të patundshme, me rëndësi të veçantë (neni 75 paragrafi 1);

4. Bën zhvendosjen e trashëgimisë kulturore të patundshme pa Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ose pa lejen e Drejtorisë (neni 76 paragrafi 4 dhe 5);

5. E braktisë trashëgiminë kulturore të rrezikuar, pa pajtimin e organit kompetent, ose pa e bërë kërkimin e plotë, dokumentimin dhe marrjen e masave të domosdoshme për shpëtim (neni 77);

6. Bën rrënimin e trashëgimisë kulturore të vjetëruar, pa pajtimin e organit kompetent (neni 78);

7. Bën kërkime konservatorike pa lejen e Drejtorisë, në rastet kur nevojitet leje e tillë (neni 82 paragrafi 3);

8. Kryen punë të mbrojtjes së drejtpërdrejtë pa leje për konservim (neni 87 paragrafi 1);

9. Nuk e kontrollon prejardhjen e të mirës së tundshme ose nuk e njofton Drejtorinë respektivisht organin e punëve të brendshme për çdo ofertë të dyshimtë për blerje (neni 92 paragrafi 1 dhe 2);

10. Si lëndë për koleksion ka të mirën e mbrojtur me prejardhje të huaj dhe të vendit, e fituar në mënyrë të kundërligjshme (neni 93 paragrafi (2) pika 1);

11. Si lëndë për koleksion ka të mirën e mbrojtur, të përfshirë në koleksionin publik (neni 93 paragrafi (2) pika 2);

12. Si lëndë për koleksion ka të mirën e mbrojtur që është pjesë integrale e patundshmërisë së mbrojtur (neni 93 paragrafi 2 pika 3);

13. Si lëndë koleksioni ka lëndë arkeologjike (neni 93 paragrafi 3);

14. Nuk e realizon masën e sigurimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore (neni 102 paragrafi 1);

15. Nuk merrë masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e trashëgimisë kulturore, në rastin e konfliktit të armatosur ose fatkeqësisë natyrore (neni 107 paragrafi 1);

16. Nuk e bën kthimin e gjendjes së mëparshme, pas dëmit të shkaktuar të trashëgimisë kulturore, në rastet e caktuara me këtë ligj (neni 139 paragrafi 1);

17. Nuk mundëson shikimin e inspektorit (neni 170)

(2) Me dënim në para, në shumë prej 20.000 deri më 50.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personi përgjegjës te personi juridik.

(3) Me dënim me para prej 20.000 deri 50.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 1 2 3 7 8 9 10, 11, 12, 13, 14, 15, dhe 17 tregtari individ.

(4) Me dënim me para prej 20.000 deri 50.000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 të këtij neni do të dënohet personi fizik.

(5) Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 2, 3, 5, 9, 10, 11, 12, dhe 13 të këtij neni personit juridik dhe fizik mund t'i shqiptohet masa e sigurisë konfiskimi i sendeve, të cilat paraqesin të mirën e tundshme të mbrojtur, që është fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

(6) Për kundërvajtje nga paragrafit 1 pika 1, 3, 4, 6, 7, 8, dhe 14 të këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë me kohëzgjatje prej 6 muajsh deri në 2 vjet.

Neni 173

(1) e dënim në para, prej 100.000 denarë gjer më 200.000 denarë, do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1. Nuk mban evidencë dhe dokumentacion të rregullt për kërkimet arkeologjike dhe për masat e mbrojtjes që i ndërmerr (neni 59 paragrafi (1) pika 1);

2. Nuk siguron ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vendzbulimit arkeologjik dhe sendet e gjetura (neni 59 paragrafi (1) pika 2);

3. Nuk ndërmerrë masa përkatëse për mbrojtjen dhe sendet e gjetura i lë të zbuluara, ose të ekspozuara në vend të hapur, gjatë gërmimieve arkeologjike (neni 59 paragrafi (1) pika 3);

4. Nuk kryen ose nuk organizon kryerjen e punëve konservatorike në vendzbulimet, ose të sendeve të gjetura gjatë kërkimeve (neni 59 paragrafi 21 pika 4);

5. Nuk i ndërmerrë masat e domosdoshme për sigurimin teknik të vendzbulimit dhe rregullimin e ambientit, para braktisjes së terrenit (neni 59 paragrafi (2) pika 1);

6. Nuk e kthen gjendjen e mëparshme të terrenit, ku janë bërë kërkimet arkeologjike, para braktisjes së terrenit, nëse vendzbulimi nuk konservohet ose prezentohet (neni 59 paragrafi 2 pika 2).

7. Në afatin e caktuar nuk paraqet raport për kërkimet arkeologjike (neni 59 paragrafi (3) pika 1);

8. Në afatin e caktuar nuk e dorëzon dokumentacionin final për kërkimet arkeologjike (neni 59 paragrafi (3) pika 2);

9. Në afatin e caktuar nuk i shpall rezultatet e kërkimeve arkeologjike (neni 59 paragrafi (3) pika 3);

10. Nuk i dorëzon sendet e tundshme në muzeumin e caktuar, në afatet e caktuara ligjore (neni 59 paragrafi (3) pika 4);

11. Nuk e respekton të drejtën e pronësisë shkencore (neni 62 paragrafi (3) pika 2 dhe 3);

12. Përdor metal, detektor dhe pajisje tjetër për detektim gjatë kërkimeve arkeologjike, pa leje për përdorim, ose pajisjen e tillë e përdor për kryerjen dhe nxitjen e gërmimeve të paligjshme (neni 63 paragrafi (1) dhe 3);

13. Nuk i dorëzon sendet e zbuluara rastësisht, të marrura nga vendi ku janë gjetur ose nuk i ndërmerrë masat e domosdoshme për sigurimin e mbrojtjes së tyre nga shkatërrimi ose tjetërsimi (neni 65 paragrafi (2) pika 1);

14. Nuk i jep të dhënat relevante në lidhje me vendin dhe pozitën e sendeve në kohën e zbulimit të rastësishëm dhe rrethanat në të cilat është bërë ky zbulim (neni 65 paragrafi 2 pika 2);

15. Për hartimin e projektplanit urbanistik dhe hapësinor shfrytëzon baza mbrojtëse konservatorike, që nuk janë lejuar dhe verifikuar si duhet nga Drejtoria (neni 71 paragrafi 6);

16. Nuk paraqet raport për kërkimet e kryera konservatorike dhe nuk e dorëzon dokumentacionin final, në afate të caktuara me ligj (neni 84);

17. Nuk kryen kontroll profesional të projektit konservator (neni 86 paragrafi 1);

18. Nuk vepron sipas vërejtjeve, të bëra në raportin për kontrollin e kryer profesional të projektit konservatorik (neni 86 paragrafi 5);

19. Nuk kryen mbikëqyrje konservatorike në kryerjen e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë (neni 89 paragrafi 1);

20. Nuk i eviton mangësitë e konstatuara sipas vërejtjeve të bëra gjatë pranimit të punëve të kryera (neni 91 paragrafi 7);

21. Nuk e njofton institucionin kompetent për mbrojtje, për çdo send të marrur, para lëshimit të tij në shitje ose nuk dorëzon raport vjetor për shitjen e kryer të antikitetëve, sendeve artistike dhe sendeve tjera të koleksioneve (neni 94 paragrafi 2 pika 1);

22. Nuk siguron dokument për heqje dorë nga e drejta e përparsisë së blerjes të së mirës së mbrojtur (neni 94 paragrafi 2 pika 2);

23. Bën këmbimin dhe dhënien e të mirave të mbrojtura të tundshme, pa lejen e Drejtorisë (neni 95 paragrafi 3);

24. Nuk miraton plan për mbrojtjen peventive dhe aksion urgjent, në rastet e veprimeve të paligjshme (neni 104 paragrafi 1);

25. Nuk e paraqet trashëgiminë kulturore ose të mirat, për të cilat me të drejtë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore, si dhe ndryshimin faktik ose juridik të së mirës së mbrojtur, pas paraqitjes së saj, në afatin e caktuar me këtë ligj (neni 129).

26. Nuk vepron me të mirën e mbrojtur si nikoqir i mirë, respektivisht nuk e ruan, respekton, mirëmban ose me kohë nuk i ndërmerre masat e caktuara për mbrojtje (neni 130 paragrafi 1);

27. Nuk i kompenson mjetet e deponuara publike, në rast të tjetërsimit të të mirës së mbrojtur (neni 131 paragrafi 1);

28. Nuk lejon dokumentimin, studimin, kërkimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes, në rastet kur është lëshuar leja nga Drejtoria (neni 132 paragrafi 1 dhe 2);

29. Nuk lëshon trashëgimi kulturore për shfrytëzim të përkohshëm, për nevojat e manifestimeve kulturore (neni 133 paragrafi 1);

30. Nuk mundëson qasjen e trashëgimisë kulturore për opinionin, në mënyrë të veçantë (neni 134 paragrafi 1 dhe 2);

31. Nuk e respekton të drejtën e përparsisë në blerje (neni 140 paragrafi 1);

(2) Me dënim në para, në shumë prej 10.000 deri më 30.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personi përgjegjës te personi juridik.

(3) Me dënim në para, prej 10.000 deri më 40.000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet tregtari individ.

(4) Me dënim në para, prej 10.000 deri më 30.000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet personi fizik.

(5) Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 3, 13, 21, 23, 25, 26 të këtij neni, personit juridik dhe fizik mund t'i shqiptohet masa e sigurisë konfiskim i sendeve, që paraqesin të mirën e tundshme të mbrojtur, e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

(6) Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 20, 21, 23, 24 të këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 6 muajsh deri më 2 vjet.

Neni 174

(1) Me dënim në para, prej 50.000 denarë gjer më 150.000 denarë, do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1. Nuk i mban evidencat për trashëgiminë kulturore dhe të mirat, për të cilat me të drejtë supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore, të përcaktuar me këtë ligj (neni 34);

2. Nuk paraqet fletëparaqitje për regjistrimin e trashëgimisë së mbrojtur kulturore ex lege (neni 46 paragrafi 1 pika 1);

3. Nuk e bën shënimin e trashëgimisë kulturore të patundshme, me shenjë të mbrojtjes, ose shënimin nuk e bën në afat të caktuar (neni 48 paragrafi 2);

4. Nuk e bënë shënimin e trashëgimisë kulturore të patundshme edhe në transportin special të trashëgimisë kulturore të tundshme, në rastet e caktuara, ose shënimin e bënë pa lejen e Drejtorisë (neni 48 paragrafi 3);

5. Nuk e informon opinionin për ecurinë e kërkimeve arkeologjike (neni 59 paragrafi 1 pika 5);

6. Nuk mundëson shikimin e vendzbulimit dhe sendeve të gjetura, nga ana e personave të autorizuar (neni 59 paragrafi 1 pika 6).

7. Vendos firma, reklama, tabela, pllakate dhe njoftime të tjera të së mirës së mbrojtur të patundshme, pa lejen e Drejtorisë (neni 80);

8. Nuk tregon dhe paraqet dokumentin e rregullt të pronësisë të së mirës së mbrojtur, që e shet (neni 94 paragrafi 2 pika 3);

9. Nuk e njofton blerësin për mundësinë e ndalesës së eksportit të së mirës së blerë (neni 94 paragrafi 2 pika 4);

10. Nuk e njofton Drejtorinë, për kthimin në vend, të së mirës së mbrojtur, që ka qenë jashtë vendit dhe për gjendjen në të cilën gjendet (neni 96 paragrafi 5);

11. Në afatin e caktuar nuk e paraqet importin e trashëgimisë kulturore të tundshme (neni 99).

12. Nuk cakton masa përkatëse për zvogëlimin e pasojave të dëmshme nga ndotja e trashëgimisë kulturore (neni 111 paragrafi 1 pika 3).

13. Nuk ndërmerre masa për përparimin e cilësisë të ambientit jetësorë, në rajonet e mbrojtura (neni 112 paragrafi 1).

14. Kryen veprimtari ekonomike në trashëgiminë kulturore të patundshme, ose në të mirën tjetër të patundshme, të mbrojtur sipas dispozitave të këtij ligji, pa lejen paraprake të Drejtorisë (neni 121 paragrafi 1). (neni 121 paragrafi 1)

15. Shfrytëzon emrin ose formën e trashëgimisë kulturore, për qëllime komerciale; pa lejen e Drejtorisë (neni 122);

16. Nuk i ofron ndihmë profesionale poseduesit të së mirës së mbrojtur në rastet urgjente (neni 123 paragrafi 5);

17. Nuk pranon për ruajtje të përkohshme trashëgiminë kulturore të tundshme, për të cilën poseduesi ka të drejtë deponimin (neni 128 paragrafi 1);

18. Nuk e njofton poseduesin e ri të së mirës së mbrojtur për statusin dhe regjimin e mbrojtjes të kësaj të mire, si dhe për obligimet eventuale, sipas ndonjë baze tjetër juridike (neni 135);

(2) Me dënim në para, në shumë prej 5.000 deri më 20.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës te personi juridik.

(3) Me dënim në para prej 5.000 deri 30.000 për kundërvajtje nga paragrafi 1, pikat 8 9 10 11 dhe 18 të këtij neni do të dënohet tregtari individ.

(4) Me dënim në para prej 5.000 deri 20.000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 8, 9, 10, 11, dhe 18 të këtij neni do të dënohet personi fizik.

(5) Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 8, 9, dhe 11, të këtij neni personit juridik dhe fizik mund t'i shqiptohet masa e sigurisë konfiskimi i sendeve, të cilat paraqesin të mirën e tundshme të mbrojtur, që është fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

Kapitulli XI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Seksioni 1

DISPOZITAT KALIMTARE

Valorizimi dhe rivalorizimi i monumenteve të kulturës

Neni 175

(1) Procedurat për caktimin e cilësisë të monumentit të kulturës për të mirat e tundshme dhe të patundshme, të filluara sipas rregullave që kanë vlejte para zbatimit të këtij ligji, do të kryhen sipas dispozitave të këtij ligji.

(2) Monumentet e kulturës, cilësia e të cilave është caktuar me Vendim të entit kompetent për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, sipas rregullave që kanë vlejte deri në zbatimin e këtij ligji, mbeten në mbrojtje si trashëgimi kulturore, deri në mbarimin e procedurës për rivalorizimin e tyre, sipas këtij ligji.

(3) Rivalorizimi sipas paragrafit (2) të këtij neni kryhet në afat prej tre vjetësh, për të patundshmet, respektivisht një viti për monumentet e tundshme të kulturës, duke llogaritur nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(4) Rivalorizimi i monumenteve të kulturës nga paragrafi (2) i këtij neni kryhet sipas programit të veçantë që e miraton Ministria e Kulturës.

(5) Vendimet nga paragrafi (2) i këtij neni mbeten në fuqi deri në miratimin e aktit përkatës, në procedurën e revalorizimit të monumenteve të kulturës.

Rivalorizimi i disa rariteteve natyrore

Neni 176

(1) Monumentet memoriale të natyrës dhe të mirat tjera integrale, të krijuara nga njeriu dhe natyra, të mbrojtura si raritetet të natyrës, sipas rregullave që kanë vlejtur deri në zbatimin e këtij ligji, mbeten në mbrojtje si trashëgimi natyrore deri në rivalorizimin e tyre si trashëgimi kulturore, respektivisht si vise kulturore, sipas këtij ligji.

(2) Me përjashtim, raritetet natyrore nga paragrafi (1) i këtij neni, për të cilat është marrur Vendim për caktimin e cilësisë si monument i kulturës, mbeten në mbrojtje si trashëgimi kulturore, deri në rivalorizimin sipas nenit 175 të këtij ligji.

(3) Rivalorizimi i të mirave integrale nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në afat prej tre vitesh nga dita e zbatimit të këtij ligji, nëse me ligj nga lëmi i mbrojtjes së trashëgimisë natyrore nuk është caktuar afat tjetër i regjimit kalimtar.

(4) Ministrinë e Kulturës dhe për Mbrojtjen e Ambientit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, i përkufizojnë të mirat nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni dhe përcaktojnë listën e rariteteve të natyrës, për rivalorizim, si vise kulturore.

(5) Elaboratet për rivalorizimin e të mirave në Listën nga paragrafi (4) i këtij neni i hartojnë ekipet e përbashkëta, të formuara me Vendim të ministrive të Kulturës dhe të Mbrojtjes të Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Fillimi me punë i Drejtorisë

Neni 177

- (1) Drejtoria fillon me punë me ditën e emërimit të drejtorit.
- (2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji e emëron drejtorin e Drejtorisë.
- (3) Në afat prej 30 ditëve nga dita e fillimit të punës së Drejtorisë, do të miratohen aktet për organizimin dhe sistematizimin e punëve në Drejtori.
- (4) Drejtoria i merr dhe i shpërndan punëtorët e Enteve për mbrojtjen e monumenteve të kulturës nga neni 178 i këtij ligji dhe në institucione të veçanta për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të tundshme, sipas akteve të paragrafit 3 të këtij neni, në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- (5) Me ditën e zbatimit të këtij ligji, Drejtoria e merr dokumentacionin e nevojshëm, arkivin dhe mjetet tjera, për pjesën nga kompetencat e Drejtorisë, nga entet për mbrojtjen e monumenteve të kulturës nga neni 178 i këtij ligji dhe nga institucionet e veçanta për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të tundshme.

Riorganizimi i enteve për mbrojtjen e monumenteve të kulturës

Neni 178

- (1) Me ditën e zbatimit të këtij ligji:
 1. Enti Republiken për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, vazhdon me punë si Qendër nacionale konservatorike, me kompetencë edhe për komunat për të cilat nuk janë themeluar qendra konservatorike.
 2. Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Qytetit të Shkupit, vazhdon me punë si Qendra konservatorike-Shkup me kompetenca për rajonin e komunave Qendër, Karposh, Gjoçe Petrov, Saraj, Kondovë, Çuçer Sandevo, Çair, Shuto Orizari, Karposh, Haračinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë Studeniçan, Sopishtë dhe Kisella Vodë;
 3. Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeu Popullor në Ohër, vazhdon me punë si Qendra Konservatorike-Ohër, me kompetenca për rajonet e komunave Ohër, Bellçishtë, Kosel, Mesheishtë, Llukovë, Dollogozhdë, Llabunishtë, Veleshtë, Vevčan, dhe Strugë.
 4. Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Rariteteve Natyrore, Muzeut dhe Galerisë në Manastir, vazhdon me punë si Qendra konservatorike – Manastir, me kompetencë për rajonet e komunave Manastir, Bistricë, Novaci, Baç, Staravinë, Mogilë, Kukureçan, Capar, Dobrushevë, Demir Hisar, Sopotnicë, dhe Resnjë;
 5. Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Rariteteve Natyrore dhe Muzeumi në Prilep, vazhdon me punë si Qendra Konservatorike-Prilep, me kompetenca për rajonet e komunave Prilep, Topolçan i poshtëm, Krivogashtan Vitolishtë, Krushevë dhe Zhitoshë;
 6. Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Rariteteve Natyrore dhe Muzeu Popullor në Shtip, vazhdon me punë si Qendra Konservatorike-Shtip, me kompetenca për rajonet e komunave Shtip, Karbincë, Radovish, Konçe, Podarësh, Sveti Nikollë, Llozovë, Koçan, Çeshinovë, Obleshevë, Zërnovc dhe Orizari.
 7. Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Rariteteve Natyrore dhe Muzeu popullor në Shtip, vazhdon me punë si qendra Konservatorike-Shtip me kompetenca për rajonet e komunave Shtip, Karbincë, Radovish, Konçe, Podarësh, Sveti Nikollë, Llozovë, Koçan, Çeshinovë, Obreshevë, Zrnovc dhe Orizari.
- (2) Entet nga paragrafi 1 i këtij neni, me emërtimet e reja dhe kompetencat e përcaktuara me këtë ligj, vazhdojnë të punojnë me punëtorët, të cilët nuk i merr Drejtoria, ndërsa në Ohër, Manastir, Prilep, Shtip dhe Strumicë, pa punëtorët, të cilët mbesin në muzeume si ente të pavarura publike për mbrojtje.

(3) Institucionet nga paragrafi (1) pika 1 dhe 2 të këtij neni do ta harmonizojnë organizimin e tyre në afat prej gjashtë muajsh, ndërsa institucionet nga pika 3, 4, 5, 6, dhe 7 të të njëjtit paragraf, organizimin e tyre e harmonizojnë në afat prej një viti nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(4) Qendra Nacionale Konservatorike dhe qendrat konservatorike, të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni vazhdojnë të punojnë si institucione nacionale për mbrojtje.

(5) Muzeumet nga paragrafi (2) i këtij neni vazhdojnë me punë si institucione nacionale për mbrojtje, deri në përcaktimin e statusit të tyre sipas ligjit.

(6) Sisremimin e punëtorëve dhe rregullimin e çështjeve lidhur me pajisjen, inventarin dhe punë të tjera, arkivin, dokumentacionin, mjetet e punës dhe mjetet e tjera të institucioneve nga paragrafi 1 pika 3, 4, 5, 6, dhe 7 të këtij neni do të kryhet në afat prej gjashtë muajve nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Caktimi i subjekteve të autorizuara për mbrojtjen e të mirave fonotekiste dhe të trashëgimisë shpirtërore kulturore

Neni 179

Ministri i Kulturës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e zbatimit të këtij ligji do t'i përcaktojë personat juridikë nga neni 156 i këtij ligji.

Themelimi i Këshillit nacional

Neni 180

Këshilli nacional do të themelohet në afat prej 30 ditësh, nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Aktet nënligjore

Neni 181

Dispozitat, miratimi i të cilave është paraparë me këtë ligj, do të miratohet më së voni në afat prej tetë muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Titujt profesional

Neni 182

(1) Personave, të cilët deri në ditën e zbatimit të këtij ligji kanë fituar titullin konservator i lartë ose konservator-këshilltar, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e monumenteve të kulturës (“Gazeta Zyrtare e RSM-së” numër 24/73 dhe 42/76 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 12/93) titulli i fituar u njihet.

(2) Procedurat për fitimin e titujve konservator i lartë dhe konservator këshilltar, të filluara sipas dispozitave që kanë vlejë para zbatimit të këtij ligji, do të kryhen sipas dispozitave të këtij ligji.

Seksioni 2

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Pushimi i ligjit ekzistues

Neni 183

Me ditën e zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për mbrojtjen e monumenteve të kulturës (“Gazeta Zyrtare e RSM-së”, numër 24/73 dhe 42/76 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 12/93).

Hyrja në fuqi e ligjit dhe fillimi i zbatimit të ligjit

Neni 184

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2005.